

PARIMET E BESIMIT DHE ILMIHALI ISLAM / Mahmut Toptash

M a h m u t T o p t a s h



**PARIMET E BESIMIT
DHE ILMIHALI
ISLAM**

MUFTINIA E BI-SHKUP, 2003

PARIMET E BESIMIT
DHE ILMIHALI ISLAM

**PARIMET E
BESIMIT
DHE
ILMIHALI
ISLAM**

Mahmut Toptash

*(Ish-imam në Xhaminë Aya Sofia dhe ligjërues
i pensionuar i Xhamisë Qendrore në Stamboll)*

Shkup, 2003

Titulli i origjinalit:
Mahmut Toptaş
İman esalsari ve İslâm İlmihali
İstanbul, 2000

Përktheu nga turqishtja:
mr. Qani Nesimi

Për botuesin:
Zenun ef. Berisha

Redaktor:
Zenun ef. Berisha

Sponsoroi:
Haxhi Mustafa

Copyright©Autori, 2000
©Për botimin shqip - Muftinia e BI - Shkup, 2003

Shënimi i CIP katalogut të këtij libri gjendet
në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare - Shkup

ISBN

9989-57-180-5

KY LIBËR JEPET FALAS

Përmbajtja

Parathënie	10
Besimi në All-llahun	11
Manifestimi i Esmau'l-Husna-së (Emrave të bukur të All-llahut)	25
Specifikat e fjalës ALL-LLAH	26
Cilësitë e All-llahut	39
Cilësitë dhatije	39
Cilësitë thubutije të All-llahut	42
Besimi në melekët	47
Specifikat e melekëve	47
Fuqia e melekëve	48
Detyrat e melekëve	50
Llojet e melekëve	51
Besimi në ekzistimin e xhinnëve	55
Spiritualistët	58
Ëndrra	60
Besimi në librat e shpallur (kitabët)	63
Shpalljet që përmenden në Kur'an:	64
Qëllimi i shpalljes së librave	65
Përkufizimi i Kur'anit	66
Flamurtarët e Islamit	69
Ata që janë kokëlartë dhe ballëlartë (krenarë)	70
Emrat e Kur'anit Kerimi	71
Besimi në peygamberët	72
Cilësitë e peygamberëve	75
Dallimi mes resultatit dhe nebiut	77
Besimi në ahiret	78
Varri	80
Sirati	81
Besimi në kader	83

Shkenca e fikhut	91
Pastërtia.....	94
Abdesti	96
Farzet e abdestit:.....	96
Sunnetet e abdestit:	96
Gjërat që e prishin abdestin.....	97
Gjërat që nuk e prishin abdestin:.....	97
Gusli	98
Farzet e guslit.....	98
Gjërat që e bëjnë të nevojshëm guslin	98
Gjendja specifike e gruas.....	99
Tejemmumi	100
Farzet e tejemmumit.....	100
Sëmundjet e vazhdueshme (arsyet).....	101
Mes’hi mbi meste.....	102
Mes’h mbi mbështjellës të plagës.....	102
Imani dhe Islami.....	103
Hyrje në Islam (Kelim-i shehadeti).....	104
Dëshmia.....	106
Namazi	110
Shartet dhe ruknet e namazit.....	110
Shartet e namazit.....	111
Ruknet e namazit.....	114
Sehvi sexhdeja (Sexhdeja e harresës).....	119
Mbështetja imanit.....	119
Rekatet e kohëve të namazit:.....	119
Namazi i xhumasë.....	120
Namazi i Bajramit.....	121
Namazi për zënien e Diellit dhe të Hënës.....	122
Agjërimi i Ramazanit është lulja e imanit.....	124
Agjërimi që mundëson bashkimin tonë.....	125
Ibadeti universal i fesë universale	128
Guri themeltar i sabrit është agjërimi.....	129
Kushtet e agjëritit të Ramazanit.....	130
Kushtet për të qenë agjërimi i shëndoshë	130
Kushtet e kryerjes së agjëritit	131
Llojet e agjëritit.....	131
Zekati.....	133

Kushtet e zekatit.....	136
Nisabi është shkaku i zekatit	136
Zekati i deleve dhe i dhive	137
Zekati i llojeve të gjedheve (kafshëve)	137
Zekati i deveve.....	138
Zekati në para, senet, çek dhe në transformim	138
Zekati i gjërave tregtare	139
Vendet ku duhet të jepet zekati.....	139
Sklevërit	140
Borxhlinjtë	141
Ata që kanë mbetur në rrugë	141
Sadakatul fitri	142
Haxhi	143
Kushtet e obligueshmërisë (farzet) së Haxhit.....	143
Kushtet për kryerjen e Haxhit.....	144
Mikati	146
Tavafi kudumi (sunnat)	148
Ndalesat duke qenë me Ihram	150
Umre.....	150
Haxhi Temettu.....	151
Haxhi kiran.....	151
Vizitë Pejgamberit a.s.	151

Parathënie

Pjesa “**Parimet e besimit**” e këtij libri që keni në dorë janë ligjëratat e organizuara posaçërisht për studentët e Fakultetit të Mjekësisë në Xherrahpasha. Këto ligjëratat janë të nxjerra prej kasetave dhe janë shndërruar në libër. Këto në Turqi i kanë lexuar me mijëra njerëz. Nën mbikëqyrjen e njërit prej profesorëve të Universitetit Baku ky libër është përkthyer edhe në rusisht. Ai është shtypur në njëzet e pesë mijë (25.000) ekzemplare dhe janë shpërndarë nëpër republikat turke. Pjesa “Islami dhe pesë shtyllat” e këtij libri është përkthyer në gjuhën kazake, është shtypur me alfabet arab dhe është shpërndarë falas në Turkistanin Lindor.

Falënderimi i takon All-llahut, i cili më mundësoi të lindem nga prindër që nuk dinin shkrim e lexim në një fshat të Karamanit, ku nuk kalon askush dhe i cili është shumë larg botës së qytetëruar, i cili më bëri shërbyes të Kur’anit dhe më mundësoi ta shkruaj veprën tetëvëllimeshe të titulluar “**Shifa Tefsiri**” (Tefsiri shërues).

Këtë vepër e kam përgatitur posaçërisht për muslimanët e Ballkanit. I zgjodha dhe i përfundova “**Tridhjetë e dy farze**”, që thelbin e tyre ta mësojnë përmendsh nëpër ligjëratat që do t’i mbajnë në xhami, kurse, shkolla dhe në shtëpi. Në përmbajtjen e librit krahas pjesës kemi përmendur edhe numrin e faqes .

“Asnjë e drejtë e këtij libri” nuk është e rezervuar. Kush të dojë mund ta botojë, në cilën gjuhë dëshiron dhe sa dëshiron ai. Gjithashtu edhe mund të fotokopjojë. Dëshirë e vetme imja është: të kenë kujdes në përkthimin, radhitjen, botimin dhe në vëllimin e librit .

Ta bëjmë atë që është më e mirë, që All-llahu (xh.sh.) të na shohë si të denjë për xhennetin e tij. Amin.

Mahmut Toptash

Besimi në All-llahun

Pejgamberi ynë kur e dërgoi Muadh b Xhebelin si misionar në Jemen e porositi që jemenasit, që ishin të krishterë së pari t'i ftojë të besojnë njësinë e All-llahut, e nëse e pranojnë t'i thërrasë në namaz, e nëse edhe këtë e pranojnë, pastaj t'i thërrasë në dhënien e zekatit/ të marrë nga të pasurit e t'u ndajë të varfërve (Buhariu, Kitabu et-Tevhid, Kapitulli I, Hadithi 7372).

Ne e dimë që askë nuk mund ta udhëzojmë, por udhëzimi vjen vetëm prej All-llahut. Ne e dimë që dritën e syrit e ka dhënë All-llahu, por e dimë se edhe mjekët (okulistët) me anë të operacionit ia heqin perdet që i pengojnë në sy Ne e dimë që ujin e jep All-llahu, por e dimë edhe atë se me puset e hapura nga ne u ndihmojmë njerëzve të pijnë ujë.

Veprat, që janë shkruar për emrat e bukur të All-llahut, gjatë një historie një mijë e katër qind vjeçare, janë për hapjen dhe për shndritjen e syrit dhe të zemrës së përlyer dhe të mykur.

Pa ndonjë inxhinier nuk mund të nxirret uji. Ai ia hap rrugën ujit që veç ekziston All-llahu natyrën e njeriut e ka krijuar të prirur për të adhuruar Zotin dhe, për të kuptuar ekzistencën dhe njësinë e Zotit, e ka krijuar mendjen. Mendja, e cila nuk e ka bllokuar veten me egoizëm, me mendjemadhësi, me idhuj për fitim, pa dyshim se do ta njohë Zotin e vet.

Për atë Pejgamberi a. s. nuk ka thënë se atë prindërit e tij e bëjnë musliman: *“Çdo fëmijë lind me natyrë të pastër (fitret) Pastaj prindërit e tij atë e bëjnë hebre, të krishterë apo mexhusi/ adhurues të zjarrit”*. (Buhariu, Xhenaiz 80, 92, Kader 3; Muslim, Kader 25) Sepse, ai fëmijë veç është me natyrë të pastërt islame. Fëmija kur fillon të flasë, në fillim flet vetëm të vërtetën. Ai nuk flet gënjeshtër Deri

atëherë kur e sheh se pse flet drejt ha dajak nga nëna dhe babai i tij. Andaj kur i thuhet **“A ti e theve gotën?”**, edhe nëse e ka thyer, ai përgjigjet **“Jo, unë nuk e kam thyer”**. Kështu i mësohet fëmijës diç nga hebraizmi. Kështu ai pastrim (fitret) islam fillon të ndotet me këso lloj pislleqesh.

Kështu nuk është e rastësishme që në çdo tregim prej të gjithë vëllezërve dhe motrave, me zemër më të mirë janë më të vegjëlit Kjo është nga ajo që fëmija më i vogël është më pak i prishur.

Në çdo fëmijë të lindur, sikur syri dhe dora, krijohet edhe frika që është e nevojshme. Pasi që fuqia e trupit dhe e mendjes në çdo njeri është ndryshe, ashtu edhe niveli i frikës te njerëzit dallon. Sikur të mos ishte frika në krijimin tonë, atëherë do të hidheshim në det pa ditur not, do të ecnim drejt trenit në hekurudha dhe nuk do ta kuptomin fundin tonë. Edhe frika, pra, është një dhunti shumë e madhe. Por, si në çdo çështje, edhe në frikë ka tepricë.

Frika dhe dashuria nuk maten me kandar, por që të jemi më të qartë, do të mudohemi ta shpjegojmë me gram

Sikur një fëmijë të lindur t’i ishte dhënë njëqind gram frikë, njëzet gram nga ajo frikë harxhohen natën kur nëna deri sa ai është i vogël, i thotë: **“Qetësohu se vjen ujku, ky, ai”**. E kur të rritet edhe pak i thotë **“Vjen polici, përgjegjësi”**, e kur të rritet edhe pak i thotë **“Mos bëj zë se pastaj s’mund të marrësh diplomë, nuk mund të zësh punë, nuk mund të fitosh, nuk mund të bëhesh zyrtar”**. Kështu mbaron frika njëqindgramëshe dhe më nuk mbetet frikë për All-llahun.

Ne njerëzve do t’ua mundësojmë që frikën që e kanë që në krijim ta ruajnë vetëm për All-llahun, e të mos mërziten prej këtij, atij, apo prej Amerikës, e të mos brengosen për rriskun dhe do t’i mësojmë të thonë ashtu si ka thënë Pejgamberi ynë: **“O All-llah, unë vetëm te Ti mbështetem”**.

Edhe dashuria vjen me lindjen. Ajo është që neve na magjeps ndaj njëri-tjetrit. Ai që e do Zotin, i do edhe krijesat e Zotit Ai që nuk e do Zotin, gruan e tij e do vetëm për trupin e saj, kurse ba-

banë dhe nënën e tij vetëm për pasurinë e tyre. Bilbilin e do për mish, kurse tokën për kullosë. Kur zhduken gjërat që i do ai, atëherë kërkon rrugë për të shpëtuar nga ato.

Njëri që nuk e besonte shpirtin, pasi që nuk mund të shihet me sy, nuk mund të preket me dorë, nëpër laboratore nuk mund të shihet me mikroskop, i thashë: **“Çka i pëlqeve gruas që e more?”**.

Ai m'u përgjigj: **“U dashurove në vetullat, flokët dhe në trupin e saj dhe u martova me të”**. Kurse unë i thashë: Nëse sot të vdes gruaja çfarë do bësh me të?

Me siguri do ta varros në dhe, u përgjigj.

E pse e varros në dhe? Vetullat, syrin, trupin, për të cilat gjëra t'i je martuar me të, ajo i ka në vend. Pse frikësohesh të qëndrosh pranë saj një sekondë, ashtu që menjëherë dëshiron ta shpiesh në varr?

Atë që ne e duam në babanë, nënën, fëmijët dhe në gruan tonë është shpirti i tyre. Pasi që ai shpirt të dalë, trupi bëhet i papëlqyeshëm, bile edhe i frikshëm. Ne e duam edhe trupin, sepse e bart shpirtin tonë. Për këtë, ne trupin e pastrojmë, e duam, e zbukurojmë, e veshim dhe e ushqejmë me ushqimet e nevojshme.

Sikur dritën që e kemi në shtëpinë tonë për të na shndritur neve, ashtu edhe dritën që na shndrit neve ka njerëz që tërë jetën nuk e kanë parë. Qëllimi ynë është dritë. Ne vetëm dëshirojmë që kabllo dhe avizet në tavan të elektrikut të jenë të bukura. Por, edhe pse rryma elektrike nuk mund të preket me dorë dhe nuk mund të shihet me sy, ne nuk mund të themi se nuk besoj më në ekzistimin e saj. Sepse, sikur të preknim një kablo të zhveshur, nuk do të kishim kohë të themi **“nuk besoj”** Edhe pse ekzistencën e diçkaje nuk e shohim, atë e kuptojmë nga veprat e tij. Ajo në një vend bëhet dritë, në një vend tjetër bëhet nxehtësi, kurse në një vend tjetër ngre pesha të rënda, kurse me sy nuk shihet. Pikërisht sikur magneti që nuk shihet me sy, por ekzistenca e tij kuptohet nga veprimi i tij. Derisa ka shpirt sytë qëndrojnë ndezur, e kur shpirti del prej trupit, atëherë mbetet sikur llamba kur

ndalet rryma. Ai më falënderoi kur i thashë se “ekzistenca e Tij kuptohet nga veprat e Tij”.

Ne përbëhemi prej shpirtit dhe trupit. Trupi ynë është i krijuar prej dheu, ashtu që edhe ushqimi i trupit tonë është prej dheu. Çdo gjë që veshim, hamë dhe pimë, vjen prej dheut. Shpirti nuk është i krijuar prej dheut, por atë e ka dhënë Zoti ynë, prandaj ushqimi i shpirtit nuk mund të jetë prej dheu. Ai vjen prej Zotit.

Kështu disa sjellje dhe mendime të njeriut ndikohen nga jashtë e disa nga brenda. Pesë shqisat tona janë dyer të hapura (të dukshme) të shpirtit dhe mendjes sonë. Atë, që prej atje e shohim, e dëgjojmë, e prekim, e nuhatim dhe e shijojmë, në trurin tonë shënon diçka. Këto gjëra që ndikojnë nga jashtë në ne formojnë personalitet

Kjo është edhe ajo që ndikon nga brenda E ajo është fitreja islame që vjen me lindjen. Si p.sh. dashuria e fëmijës së sapolindur i cili ende nuk e di fjalën dashuri, por shikimi i tij rreth e për-qark shpërndan gëzim.

Për të ekzistuar një harmoni mes të brendshmes dhe të jashtmes, duhet që ana e jashtme dhe ana e brendshme të sillen sipas fitres islame. Atë që shohim, që e dëgjojmë dhe që e nuhatim duhet të jetë e bukur dhe hallall. Prej planifikimit të qytetit e deri te rregullimi i shtëpisë çdo gjë duhet të jetë e bukur dhe normale. Prej pesë kanaleve shqisore e deri te deti i zemrës duhet të rrjedhin gjëra të mira dhe të bukura. Nëse nga brenda buron dritë e nga jashtë fëlliqësi ose nëse nga brenda rrjedh fëlliqësi e nga jashtë shkëlqen makiazhi, kjo i ngjan njeriut të cilit nga jashtë i vjen era e miskut, kurse nga brenda era e hudhrës. Zoti ynë thotë: “Gjërat e bukura dhe të pastta u takojnë atyre që janë të bukur të pastër” (Kur’an, Nur 24/26).

Mendjes, e cila ndikohet nga çdo send, nuk duhet besuar shumë. Ai i cili ec në rrugën që ia ka vizatuar mendja e tij e fëlliqur, kurse në fund kupton rrugën e gabuar dhe kërkon rrugën e vërtetë, pasi që thotë:

**“Vite kanë kaluar në udhëtim me mendjen
duke menduar arrita në kufirin e inteligjencës**

Në fakt ç'është mendja e ç'është intilegjenca?

Për t'u mashtruar janë nga një shkak",

thotë se në mohim nuk ka fund dhe këtë lojë logjike e shpreh kështu:

"E ç'është pra ky mohim

është vendimi në mohuesin" (*Allab Bir*, H Ali Yucel, Turk Tarihi Kurumu Basimevi, Ankara 1961).

Në një poezi tjetër thotë:

**Nëse unë prej mendjes sime kërkoj humbje
mendja ime mua më jep humbje**

Nga kjo kuptohet se, mendja e cila duhet të ta tregojë rrugën e vërtetë, kur njolloset, e tregon rrugën e gabuar.

Aliu (r.a.) mendjen e ka ndarë në dy pjesë: mendja e cila vjen me lindjen dhe mendja e cila fitohet më vonë. Ai thotë se mendja e cila vjen prej lindjes nëse nuk zhvillohet, mbetet e padobishme sikur drita që s'ka vlerë për të verbërin (el-Mufredat fi garib-il-Kur'an, Ragib, materia "**Akil**").

Rrugët e zhvillimit të saj janë dy:

1) **Pesë shqisat dhe**

2) **Lajmi i mirë**

Pesë shqisat tona, si **të dëgjuarit, të parit, të nuhaturit, të shijuarit dhe të prekurit**, janë dyer të hapura të botës sonë së brendshme. Nëpërmjet këtyre dyerve bëjmë prova dhe marrim rrugën prej të panjohurave drejt të njohurave. Vetëm se, pasi që në natyrë çdo gjë është e kufizuar, edhe shqisat tona janë të kufizuara.

Njerëzimi, për të shpëtuar prej tmerrit dhe egërsisë së errësirës që e rrethon njeriun, pasi të perëndojë dielli, e ka zbuluar zjarrin, gazin, rrymën elektrike dhe është bërë shok me gjërat e frikshme me të cilat është ballafaquar në errësirë. Është më se normale që njerëzit, zemra e të cilëve është nxirë me pabesi, të frikësohen prej besimtarëve. Ndërkaq, po të ndizet drita e imanit në të, do të shohë se edhe ai është njëri prej vëllezërve.

Kur të shohë se pesë shqisat, që janë burime të diturisë, janë të kufizuara, se çdo gjë që sheh kur largohet bëhet e vogël dhe

fillon të mos duket më, se nuk mund t'i dëgjojë zërat që janë më poshtë se frekuenca normale për dëgjim, se natën nuk mund ta shohë atë që e sheh ujku, se erën që e merr qeni nuk mund ta kuptojë, nuk mohon atë që e nuhat qeni dhe atë që sheh ujku, kështu që shqisat e tij i ka zhvilluar me anë të elementeve të reja të zbuluara

Janë zbuluar mjete për matjen e ajrit dhe të temperaturës, mjete që e tregojnë të largtën afër, kurse të voglën të madhe Në fund të të gjitha këtyre zbulimeve, e ka marrë parasysh edhe pjesën mashtruese si të shqisave, ashtu edhe të mjeteve të zbuluara për to. Njeriu, i cili e ka bërë idhull unin e tij, që është edhe idhull edhe adhurues i idhullit, dimensionin e zemrës së tij e ka mbyllur me idhullin e tij dhe nuk mund ta kuptojë kufizueshmërinë e shqisave të tij Sa dallime ka në mesin e gishtërinjve të njerëzve, aq dallime ka në të parët dhe në të dëgjuarit si dhe në vijën e karakterit.

Në këto dallime ka një rahmet nga ana e Zotit për ne. Sikur mendimet, ndjenjat dhe perceptimet të ishin të njëjta, nuk do të kishte përparim në dashuri, gëzim, art, stres dhe në shkencë. Një mijë poetë për një lule do të shkruanin vjersha me fjalë të njëjta, me ritëm të njëjtë dhe me kuptim të njëjtë. Botën do ta kishim stolisur me një ngjyrë, do të kishim bërë shtëpi të një tipi dhe do të kishim veshur tesha të njëjta.

Dallueshmëria e ndjenjave të njerëzit botës i ka dhënë ngjyra të ndryshme, e ka shpëtuar prej ekzistimit të vetëm një ngjyre dhe njerëzit i ka futur në gara.

Bilbili i zemrës gjithmonë dëshiron të udhëtojë matanë, kah pika e fundit ku arrin mendja.

Pesë shqisat tona dhe ato që e zgjerojnë fushën e tyre si satelitët, nëndetëset, mikroskopët, teleskopët etj, arrijnë deri në një vend dhe aty përqendrohen Njeriu, ndonjëherë nga egoizmi i tij nuk e pranon dobësinë e tij. Për të mbyllur dobësinë (impotencën) e tij, idhulli i egos e mbyll diapazonin e syrit të zemrës dhe thotë se më tutje nuk ka asgjë. Këtu fillon mohimi dhe prapambeturia, fanatizmi, mosnderimi i njerëzve dhe i natyrës.

Po t'i shikojmë filozofët e vjetër grekë, të gjithë ata thonë se kufiri i fundit i logjikës është kufiri i çdo sendi

Shohim se të gjithë njerëzit janë burgosur në mendimet dhe në mendjen e filozofit më të mençur, kurse atë, i cili ka dalë nga ai burg, e kanë mbytur duke e torturuar. Mohuesit e fesë në çdo kohë kanë qenë gardianë të mendimit që ka dashur ta burgosë çdonjërin brenda kufijve që i ka caktuar mendja e tyre.

Me hyrjen e muslimanëve në Iran, në Bizant dhe në Spanjë, kanë ndryshuar shumë gjëra. Çdo fundkapitull i veprave të dijetarëve islamë ka përfunduar me fjalën "**All-llahu A'lemu**" (All-llahu e di më së miri), e cila e ka kuptimin "Kjo është njohuria ime që ty nuk të detyron, Ti ke mundësi që më mirë dhe më tepër ta shfrytëzosh diturinë e drejtë të All-llahut, Vazhdo në rrugën tënde" dhe e kanë bërë me dije se diturinë më të drejtë mund ta mësojmë nëpërmjet peygamberëve që janë të dërguar të All-llahut, krijuesit të universit, kohës dhe të vendit.

Krahas kësaj dobësie (impotence), nga fjalët e Pejgamberit a s mësojmë se më i forti nga krijesat e All-llahut është njeriu (Tirmidhi, Ebvab-ut-Tefsir, kapitulli 3, Hadith 3366).

E dimë që çdo gjë që është e krijuar është e lidhur me vendin dhe kohën. Yjet, drita e të cilave neve na arrin për disa miliona vite, duhet ta ketë fundin e saj larg andej (në metafizikë). Edhe koha, ku ngjajnë me miliarda ngjarje, ka një fillim dhe një mbarim.

Pasi mendja me të gjitha mundësitë e saj nuk mund të arrijë në fund të kohës dhe të vendit (hapësirës) dhe nuk mund ta shohë botën e andejshme, fillon të mohojë, por zogu i zemrës vazhdon të t'i hapë krahët për në botën andejshme dhe dëshiron të fluturojë. Nefsi i kompozitorit, kompozitat e të cilit në tërë botën duartrokiten në këmbë, duke u zhytur në detin e qejfit, zogu i zemrës pa u kujdesur për atë durtrokkitje fillon të dëgjojë zëra të rinj.

Piktori, një pikturë e të cilit në panaiet e botës shitet me miliona dollarë, mundohet të kapë thelbin e ngjyrave të botës së brendshme e cila është më e gjërë se bota e dukshme, thelbin e së cilës nuk ka mundur ta kuptojë. Edhe poeti Mehmet Akif Ersoj

me britmën e tij ankohet për pamundësinë e të shprehurit me gjuhë të asaj që ndjen në botën e zemrës:

Shpirti në mua është sikur hidhërimi që e përjetoj në rrënim.

Që nga gjuha ime ende nuk është dëgjuar ajo vështirësi.

Aty ku lodhet ai, nga mendja fillon të shkundet zogu zemër. Ai dëshiron të fluturojë drejt vendeve ku nuk ka vdekje, ku nuk vyshket rinia dhe e bukura, ku nuk ekziston dielli që djeg dhe i ftohti që ngrin, ku nuk ka as gënjeshtër e as urrejtje. Kështu pra ne kemi nevojë për një kallauz që do të na përgatitë të fluturojmë prej kësaj bote në botën tjetër. Ai kallauz janë peygamberët të cilët e japin lajmin më të drejtë në rrugën e diturisë.

Korbi, syri i të cilit gjithmonë është në coftinë, asnjëherë nuk mund të lartësohet si skifteri. Edhe zogu i zemrës së njeriut, syri i të cilit gjithmonë qëndron në fitimin e tij, nuk mund të lartësohet shumë. Pra, peygamberët janë të dërguar që t'i pastrojnë papastërtitë si rrenën, shpifjen, përgojimin, zinanë, bixhozin, kamatën, alkoolin, mohimin etj, me të cilat është i sëmurë zogu i zemrës.

Të gjitha krijesat së pari kanë nevojë për besim dhe ndjenjë të besueshmërisë. Njeriu ka nevojë për ushqim dhe pije. Por, besueshmëria se ushqimi dhe pija nuk janë të helmuara, është nevoja më e madhe për besueshmëri.

Njeriu ka nevojë për një shtëpi ku do ta kalojë natën dhe ku do të mund të flejë. Por, që të flejë rahat në atë shtëpi, ka nevojë për rojtar, i cili i jep siguri dhe për dry të derës.

Për të marrë diçka është e nevojshme hipoteka, për të dhënë diçka dorëzani, për det anija, për ajër aeroplani, për zjarr zjarrfikësi.

Ligjet e vëna për sigurimin e njeriut, pasurisë, për udhëtim dhe për mbrojtjen e nderit burojnë nga nevoja për sigurim. Fjala **emanet**, që ka kuptimin siguri, është e së njëjtës rrënjë me fjalën **iman**.

Njeriu në këtë botë, ku duke qenë i pasur bëhet i varfër, duke qenë i ndershëm bëhet i nënçmuar, duke qenë i sëmurë shërohet, duke qenë i shenjtë bëhet i përbuzur, duke qenë fëmijë plaket,

duke qenë plak vdes, që veten e tij ta shpëtojë prej tmerrit, t'i shtohet frika dhe që të jetojë në siguri, ai ka nevojë për iman.

Siç thamë edhe më lart, imani vjen para ushqimit dhe pijes. Për këtë edhe Zoti ynë historinë e njerëzimit e ka filluar me një peygamber, Ademin a. s. Ai ia ka mësuar njerëzimit sesi të besojë dhe të jetë i sigurt dhe se çfarë duhet të bëjë për të mos e humbur imanin e tij.

Ata të cilët brenda kohës e kanë humbur rrugën e peygambereve, kanë mohuar madhësinë e All-llahut dhe kanë filluar të besojnë se mund të rriten vetë. Vetvetes së tyre për idhull ia kanë parapëlqyer mendjen e tyre. Duke i konkretizuar idhujt, të cilët në brendi kanë qenë abstraktë, janë munduar që ta plotësojnë nevojën e adhurimit. Ata të cilët e adhurojnë zjarrin, Apisit, Zeusin, Minervën, Lopën, Ahuramazdëne, Apollonin, në fakt e adhurojnë vetveten dhe kështu sigurojnë fitimin e tyre.

Ibrahimi a s idhujtarëve, të cilët për fitimin e tyre ndërtonin idhuj, u thoshte: “Ju përqaftat, përveç All-llahut, idhujt, vetëm për bashkëjetesë mes jush në jetën e kësaj bote, e në ditën e kiamtetit (ndryshon gjendja) ju do të kundërshtoni (refuzoni) njëri-tjetrin; Fundi juaj është zjarri, për ju nuk do të ketë ndihmëtar...” (Kur’ani Kerim, Ankebut 29-25). Kështu ai e përshkruante gjendjen e tyre shpirtërore.

Edhe idhujtarët e dinin që idhujt nuk flasin, se prej tyre nuk ka as dëm e as dobi, se ata nuk mund ta largojnë bile edhe një mizë mbi kokën e tyre.

Zoti thotë se njeriu i cili thotë: **“Unë jam ateist, nuk besoj në asnjë zot”**, e adhuron vetveten (Kur’ani Kerim, Furkan 25-43). Ky njeri, i cili e adhuron vetveten, kur do të kuptojë një ditë se edhe vetë do të vdesë, se fuqia e cila e ka dërguar në këtë botë do ta marrë përsëri, atëherë e ndjen nevojën për besim në një fuqi më të fortë se vetja e tij. Kështu ai, sikur djali i Nuhit a s , fillon të mbështetet në male të larta (Hud 11/43) dhe fillon t'i besojë natyrës (Xhathije 45-24).

Sikur që studihohej mikrobi nëpër laboratorë, filloi të hulumtohet edhe zoti natyrë Njeriu pa që mbi zotin natyrë, për të cilin

thuhet **“Natyra është bërës i çdo gjëje”**, ka një vulë të një artisti tjetër.

Fuqia e hekurt në midisin e melingonës së vogël, muzika që nuk mund të përsëritet dhe që del prej gjoksit të bilbilit të vogël, manushaqja që rritet në të njëjtën tokë, tulipani i kuq, trëndafili i kuq, kallami i sheqerit, biberi djegës, rrizku që u jepet miliona gjallesave në çdo pikë gjaku, ndryshimet që vijnë vetvetiu nga bota e brendshme, të gjitha këto zhvillime, ndryshime dhe rritje e tregojnë fuqinë dhe diturinë e dikujt.

Prej studiuesve të shkencave natyrore si të fizikës, kimisë, biologjisë, astronomisë, medicinës, të cilët kanë pasur edhe autoritet në punën e tyre, nuk ka asnjë prej tyre që te ketë qenë ateist (pabesimtar). Ata të cilët thonë se **“Unë jam ateist, nuk besoj në asnjë zot”**, sipas të ndjerit Mehmet Akif Ersoji, janë shtresa e cila nuk ka profesion, nuk ka shkollë, nuk ka unë të tij dhe të cilët karagjozllëkun e marrin për art:

“Vagabondë: asnjëri nuk ka profesion, nuk ka karakter të gjithë mbahen filozofë, por shumica nuk kanë shkollë Tash e shan All-llahun, kurse pastaj jep shumë para aspak nuk turpërohet, bëhet shërbyes i protestanëve” (marrë prej Safahat-it).

Këta janë njerëz të cilët shumë pak e kanë të zhvilluar mendjen. Braktisja e tyre në këtë gjendje është aq gjynah sa për të braktisur të pazhvilluarit ekonomikë në gjendjen e tyre.

Njeriu i cili është kapluar prej sëmundjes së margjinalizimit (dobësisë), sikur që e vjell atë që e ha dhe sikur që nuk i pëlqen edhe ushqimet më të mira, ai ashtu mund të mos e pranojë fenë e tij, e cila është ushqim i shpirtit dhe i trupit. Ne e kemi për detyrë që t'i hymë në zemër, sikur i japim serum dhe heqja e perdes së zezë nga zemra e tij është detyra jonë.

Me hulumtimet që u bënë në Perëndim njerëzit edhe më tepër i afruan kah Zoti i tyre. Kur u kuptua lindja e miliarda gjallesave që jetojnë në det se jeta dhe vdekja e tyre nuk janë të rastësishme, se nuk kanë rastësi në panxharin e sheqerit i cili bëhet në të njëjtin dhe ku bëhet edhe speci djegës që ka mundësi të bëjë të

djegë një kazan të mbushur me ushqime, se asnjëherë nuk përdoret sheqeri në vend të kripës e kripa në vend të sheqerit, se asnjëherë sheqeri i panxharit nuk ka dalë djegës, e speci djegës të dalë i ëmbël me sheqer, por u kërkua grumbulluesi i të gjitha këtyre elementeve, bërësi i kësaj fotogjeneze, ligjvënësi i këtyre që u zbuluan dhe më në fund **u bë rikthim në besimin në All-llahun**

Një kthim i tillë njeriun a e bën musliman?

Para pesëmbëdhjetë vjetësh një shkencëtar perëndimor botoi një kumtesë me titull: **“Tetë ngjarje që më çuan të besoj All-llahun”**. Në atë kumtesë shpjegoheshin jetët e gjallesave dhe thuhej se në to nuk ka rastësi.

Atë ditë veten time e kam pyetur: “A bëhet ky njeri musliman me këto pohime? Zoti ynë në Kur’anin Kerim edhe kësaj i jep përgjigje: “Ai (Ibrahimi) tha: “Ju përqaftuat, veç All-llahut, idhujt, vetëm se për bashkëjetesë mes jush në jetën e kësaj bote, e në ditën e kijametit (ndryshon gjendja) ju do të kundërshtoni (refuzoni) njëri-tjetrin; Fundi juaj është zjarri, për ju nuk do të ketë ndihmëtar... Nëse ti i pyet ata: “Kush krijoi qiejt dhe tokën, kush i nënshtroi (të lëvizin) diellin dhe hënën”? Ata do të thonë: “All-llahu”! E si prapësoheni, pra! All-llahu jep furnizimin atij që do nga robët e Vet, e ia pakëson atij që do. Vërtet, All-llahu është i gjendshëm për çdo gjë...” (Ankebut, 29/61-63).

Edhe mushriku (politeisti) mekkas që besonte në idhuj thoshte se All-llahu është krijues i qiellit dhe i tokës, zbukurues i qiellit me diell e hënë, ringjallës i tokës me shiun që e lëshon prej qielli, por nuk u bë musliman.

Ky pohim i një mohuesi, që adhuron idhujt, është një pohim i domosdoshëm. Zoti ynë i ka dy ligje apo dy ajete I pari është ajeti (ligji) që lexohet në Kur’ani Kerim dhe, i dyti, janë ajetet që i shohim dhe nuk i shohim në natyrë, të cilat shpjegojnë ekzistencën dhe njësinë e Zotit tonë. Shkencëtarët e njerëzishëm kur e pënë energjinë e atomit që nuk mund të shihet me sy, degët dhe gjetet e drurit të fikut në bërthamën e fikut, miliarda vija në gishtërinj që nuk i ngjajnë njëra-tjetrës, thanë: **“Këtë kjo tokë e zezë nuk mund ta bëjë Sikur kjo tokë e zezë të kishte intelegjen-**

cë kaq të hollë që ta bënte këtë, neve nuk do të na mbante mbi vete (nuk do të na lejonte që të shëtisim mbi të). Të gjitha këto i ka krijuar një fuqi mbinatyrore". Ata panë se në ligjet natyrore nuk ka asnjë mangësi dhe asnjë tepëricë dhe se asnjë ligj nuk e tejkalon kohën e tij.

Të gjithë ata të cilët këto ligje i mësuan dhe i panë, u detyruan të besojnë në fuqinë mbinatyrore që i krijoi këto, sepse edhe vetë ata lindnin, rriteshin dhe vdisnin në përputhshmëri me këto ligje.

Ata që besojnë se All-llahu është krijuesi i ajeteve në natyrë, nuk heshtën që të besojnë në ajetet e Kur'anit, sepse besimi në to e pengonte fitimin e tyre personal. Ai i dha fund administrimit monarkik në Mekke dhe e zhdukuri sundimin e njeriut mbi njeriun. E ndaloi bixhozin, kamatën, ryshfetin, veprimin në të zezë (ilegal) dhe fitimin e bazuar në gënjeshtër.

Ai ndaloi shitjen e gruas si një pasuri epshore. Ai, gjithashtu, ndaloi drogën e cila mendjes i vë perde, kurse jetës familjare i jep fund.

Të gjithë ata të cilët kishin fitim prej tyre mohuan një gjë të tillë. Ata thanë: **"Ne nuk njohim Zot"** Një grup tjetër thanë: **"Një pjesë të ajeteve u besojmë, kurse një pjesë tjetër nuk u besojmë"**

Ndërkaq, një grup tjetër thanë se, ajetet kur'anore e kanë plotësuar kohën e vet, ato kanë qenë të mira për kohën e katërmbëdhjetë shekujve, por nuk janë të përshtatshme edhe për kohën tonë. Ata këtë e thanë, por ranë në kundërshtim me vetveten.

Edhe pse thanë se në ligjet e natyrës, që prej kohës së Ademit a.s., nuk ka ndonjë parregullsi dhe se janë në përputhshmëri me kohën tonë, filluan të kërkojnë gabime në ajetet kur'anore.

Vetëm se ai që bën gabim në Kur'an, bën gabim edhe në ligjet e natyrës. Ata nuk mund të paramendojnë se, pasi që në natyrë nuk ka gabime, atëherë nuk mund të ketë gabime edhe në ligjet e Kur'anit.

Nuk mund të mendojnë, sepse trupi i tyre ka qenë i ushqyer me kamatë, ryshfet, plaçkitje, me fitime në rrugë ilegale, truri i ty-

re është bllokuar me mjete drogimi dhe sytë e tyre nuk mund të shohin as gjë tjetër përveç para, pozitë dhe autoritet.

Njeriu i cili beson në All-llahun, duhet të besojë edhe në përsosurinë e asaj që All-llahu, i cili natyrën e ka krijuar pa të meta, e ka shpallur. Gjithashtu duhet të besojë edhe në ahiret, melekë, pejgamberët, libra dhe në kaderin e All-llahut. Kur në mesin e njerëzve të ketë ndonjë mosmarrëveshje, atëherë duhet t'u kthehen ajeteve dhe mosmarrëveshjen ta zgjidhin në bazë të tyre (Nisa, 4/105), kurse në mesin e ajeteve nuk duhet të bëjnë asnjë dallim (Bekare 2/85).

Poeti i kohës së injorancës, **Imri el-Kajsi**, në një poezi të tij tregon se beson në All-llahun, por tek All-llahu nuk llogaritej musliman:

Njeriu frikësohet prej All-llahut dhe nëse nuk është barrë për familjen e tij, atëherë ai është trim i vërtetë ” (Divanu imri-ul-Kajs, f 366) Edhe pse mushrikët e dinin se çdo gjë bëhet sipas dëshirës së All-llahut (Kur'an, 6/148, 43/20) dhe se të gjitha punët i rregullon vetë All-llahu (Kur'an, 10/31), përsëri nuk besonin. Nga ajeti kuranor **“A nuk duheshte të na dërgohet ndonjë melek?”** (Kur'an, 25/21), kuptohet se mushrikët besonin në melekët.

Pasi Pejgamberit a s i erdhi një ajet, mushrikët me fjalët e tyre **“ajo që i është dërguar pejgamberëve të All-llahut pa mos na u dërguar edhe neve, ne nuk besojmë (në këtë pejgamber)”** (En'am 6/124), pohojnë se ata kanë besuar edhe në pejgamberët e mëparshëm.

Në një poezi të një poeti të periudhës së injorancës, **Zuhejrit**, shohim se edhe mushrikët kanë besuar në ahiret: **“Njeriu për gabimin që bën se i regjistrohet në libër dhe dënohet në botën e ardhshme ose përshpejtohet dhe i hakmerren që në këtë botë”** (Serhu Divani Zuhejr, f 102) Sot shohim shumë njerëz të cilët bëjnë shumë punë të mira, por nuk janë muslimanë dhe habitemi me këta. Edhe mushriku i Mekkes gjysmën e fitimit prej pemëve, perimeve dhe prej kafshëve e ndante për Zotin, kurse

gjysmën e ndante për idhujt (En'am 6/136), e përsëri nuk ishte musliman.

E ç'është ajo që i pengon të mos bëhen muslimanë? Ç'është ajo leqe e zezë që ua ka mbyllur zemrat?

Ai është ndryshk që e hedh në zemër papastërtia e egoizmit. Zoti ynë thotë: **“Jo, zemrat e tyre i ka ndryshkur puna e tyre që ata e kanë punuar”**. Ata besuan në ekzistencën e All-llahut, por ata, pasi që drejtësia e All-llahut i ka penguar profitet e tyre të bazuara në dhunë, shprehën dëshirë që kanunet e periudhës së injorancën të vëna nga ana e paraardhësve të tyre të jenë të vazhdueshme dhe legjitime. Ndërkaq, Zoti ynë me ajet kuranor (6/136) lajmëron se disa njerëz, të cilët edhe pse deklarojnë se nuk ka tjetër ligjvënës më të mirë se All-llahu dhe thonë se besojnë në Pejgamberin a s dhe në pejgamberët e mëparshëm, ata përsëri pëlqejnë që të gjykohen përpara djajve e jo përpara All-llahut dhe kur të njëjtit thirren që të besojnë (Kur'an, 4/61) në Kur'anin e shpallur dhe në Pejgamberin e All-llahut ata kundërshtojnë Mushrikët, të cilët thonë se idhujt i besojnë që ata t'i ofrojnë tek All-llahu, zemrat e tyre i kanë të bllokuara me anë të idhujve.

Besimi në All-llahun arrihet me anë të njohjes së cilësive të Tij. Besimi i një njeriu që beson si që besonin filozofët e vjetër në lidhje me krijimin, të cilët gjërat që nuk kishin mundësi t'i kuptojnë me mendje ia lanë Zotit, kurse për gjërat që i kapnin me mendje thonin **“Zoti nuk ka punë me këto gjëra”**, ai besim nuk i pranohet. Besimi i njeriut në All-llahun duhet të jetë edhe besim në cilësitë e Tij, kurse njeriu i cili mohon një cilësi të All-llahut nuk është besimtar.

Manifestimi i Esmau'l-Husna-së (Emrave të bukur të All-llahut)

Sikur hëna, bota dhe gjithçka që ekziston në botë që në bazë të nevojës dhe kapacitetit të vet shfrytëzon dhe e reflekton dritën e diellit, sikur manushaqja që ngjyrën e saj e merr prej brendësisë së shtatë ngjyrave të diellit dhe e bën petk për vete e cila zhduket në festën e verës, sikur tulipani i kuq i cili ngjyroset dhe merr pulla të ndryshme të bardha nga shtatë ngjyrat e diellit, po ashtu edhe gjithçka që gjendet në diell, në hënë apo në botë, prej zërit të bilbilit e deri te planeti më i madh, çdo gjë është manifestim i **emrave të bukur** të All-llahut xh. sh. Sikur që në diell ekzistojnë shtatë ngjyra, ashtu edhe fjala All-llah në vete ngërthen tërë kuptimin e **emrave të bukur**. Ne themi sikur **Ibrahimi (a s)** se “**Unë i kthehem Atij që e ka krijuar tokën dhe qiellin**” (6/79) dhe drejtohem drejt Tij.

Zemra jonë shndritet me besim ndaj Tij, kurse karakterin tonë e formësojmë me manifestimin e emrave të Tij. Ai që ia kthen shpinën dritës përpara e ka errësirën. Kurse, përndryshe, na mbro e Zot, All-llahu nuk e errëson askë “**ndërsa kush e merr të shtrembërtën, ai e ka humbur veten**” (10/108).

Sikur Allahu të mos ishte **KADIR**, fuqia e të Cilit mjafton për çdo gjë, kush do të mund t'i mbante ato yje në hapësirë duke u rrotulluar në qiell? Kush mund ta mendonte diellin i cili edhe na shndrit edhe na ngroh? E tërë bota nuk mjafton për lëndë djegëse bile edhe një orë për diellin. E kush, pra, prej krijimit e deri më sot i jep lëndë djegëse diellit? Ne themi se ai është All-llahu, **FUQIA** e të cilit (**KADIR**) mjafton për çdo gjë. Atë e përmendim

me emrat e bukur të Tij dhe e mendojmë me anë të krijesave të Tij.

Emri **ALL-LLAH** është emër i cili në vete i ngërthen kuptimet e të gjitha cilësive të tjera. Po ashtu thuhet se është edhe **Is-mi a'zam** (emri më i madh) (*Tefsiru Inbi Kethir, komentimi i sures Fatiha*). Ky emër i bukur i All-llahut që në Kur'an përmendet **2697** herë, për dallim nga emrat e tjerë, për shkak të kuptimit që e ka, përmendet shumë më tepër Kuptimin e **99** emrave të tjerë e mban në vete. Siç kuptohet edhe nga vetë titulli i lartëpërmendur "**Manifestimi i emrave të bukur të All-llahut**", dielli edhe pse në vete ka shtatë ngjyra dhe shihet si një ngjyrë, ashtu edhe emri **ALL-LLAH** është emër i vetëm që në vete i ka të gjitha emrat e tjerë të bukur. Gjatë historisë shumë faraonë veten e tyre e kanë paraqitur si **ILAH** ose si **RAB** (79/24), por asnjëherë nuk kanë pretenduar në **ALL-LLAH**.

Edhe pse thuhet se fjala **All-llah** nuk rrjedh prej ndonjë fjale, por përsëri ka që thonë se kjo fjalë rrjedhë prej fjalës **ELEHE** ose **VELEHE** Këto fjalë kanë kuptimin: Ai është i vetmi i adhuruar që adhurohet, Ai është që mendjet i lë të habitura me rregullin, harmoninë dhe hollësitë që gjenden në krijimin e njeriut dhe në ndjenjat e tij, të yjeve, të deteve, të insekteve, luleve etj., dhe të gjitha janë të vërteta "**Vetëm Atë e adhurojmë**" (1/6). Krijesat i shikojmë si të meta, nuk mund t'i shohim dhe në fund dorëzohe-mi (67/4). Për të shpëtuar nga problemet botërore me të cilat është i shqetësuar shpirti ynë, mbështetemi vetëm tek Ai dhe zemrat tona vetëm me Atë gjejnë qetësi (13/28).

Specifikat e fjalës **ALL-LLAH**

Çdo gjë fillon me Të. Pra gjithçka fillon me fjalën "**Bismi-llah**". Çdo gjë përfundon me emrin e Tij, me "**Elhamdulillah**". Çdonjëri që mbetet pa çare tjetër më në fund thotë All-llah. Kjo

pra është ajo fjalë që në vete i ngërthen të gjitha emrat e tjerë hyjnorë të Zotit Askush nuk ka guxuar që veten ta quajë All-llah Asnjë shoqëri nuk e ka mohuar All-llahun, pas që janë mashtruar në cilësimin dhe në emërtimin e Tij.

Nëse e largon elifin nga fjala All-llah, mbetet fjala **Lillah** që do të thotë toka dhe qielli janë të All-llahut (24/42). Nëse e largon lamin, mbetet **Leh** dhe ka kuptimin çdo gjë është e Tij (25/2). Nëse e largon nga fjala All-llah edhe lamin e dytë, atëherë mbetet **Hu**, e cila sipas asaj që thuhet në suren Ihlas ka kuptimin **“Ai All-llahu është tek”** (112/1) (*Sherbi esmail husna, Kurtubi Varak, 191/b Selajmanije no: 448*).

Kur njeriut i ngjan ndonjë dëm ai menjëherë kthehet drejt All-llahut dhe kërkon ndihmë (16/53; 17/67; 39/8). All-llahu kur do ta aktivizojë kijametin së pari do t’i marrë shpirtrat e besimtarëve. Në atë moment shumë trishtues që askush nuk e përmend All-llahun, pabesimtarëve fjala All-llah do t’iu merret prej goje dhe nuk do të mund të thërrasin All-llah (*Sherbi esmail husna, Kurtubi Varak 188/6, Sulejmanije no: 448*).

“Zemrat qetësohen duke e përmendur All-llahun” (13/28). Sikur që uji që vlon shumë në zjarr dhe fillon të derdhet, apo nëse është me kapak të mbyllur plas, ashtu edhe shumë ngjarje që ndodhin në jetën e përditshme e vlojnë zemrën tonë, e hipin tensionin e gjakut në tru dhe sjellin deri te gjakderdhja në tru. Të tillët gjenden nëpër spitale të të çmendurve Por, nëse ujit që vlon shumë apo derdhet i hedhim një gotë ujë të ftohtë, ai qetësohet dhe i ndalet derdhja e tij. I njëjtë është rasti me emrin e bukur të All-llahut. Nëse këtë emër sikur ujin e hedhim mbi ato kriza dhe mbi shpirtrat tonë që vlojnë, atëherë do ta qetësojmë vetem tonë. Ai që dëshiron le ta provojë. Në momentin kur mendon se ka një brengë (krizë), le të marrë **abdest** dhe disa herë apo 99 herë le të thotë All-llah. Atëherë duke menduar se brengat që i ka janë rezultat i veprave të tij, le të kërkojë falje prej Zotit, apo le të mendojë se ato që i ndodhin janë një sprovë dhe nëse mendon se si ta japë këtë provim përpara All-llahut do t’i fitojë nimetet e Zotit, le të kërkojë ndihmë nga Zoti.

Vetëm nuk duhet harruar se dhikri (përmendja e Zotit) bëhet në tri forma:

1. **Përmendje me gojë (gjuhë):** Kjo bëhet duke lexuar Kur'an, me Subhanallah, Elhamdulillah, All-llahu Ekber, me kelimeit tevhid dhe me salavate të ndryshme.

2. **Përmendje me zemër:** Kjo bëhet duke menduar për cilësitë e All-llahut, duke kërkuar prej Tij manifestimin e cilësive si dituri, butësi, mëshirë, bujari dhe cilësi të tjera. Po ashtu duke menduar edhe mënyrën, formën si dhe qysh janë krijuar krijesat.

3. **Përmendje me trup:** Kjo bëhet duke i bërë ato që urdhëron All-llahu dhe duke u larguar nga ato që ndalon Ai. Duke i larguar pengesat që e pengojnë rrugën drejt All-llahut dhe për të fituar dynjanë dhe xhennetin duhet kontribuar me djersën e ballit, me gjak dhe me lot. **Mungesa e njërës nga këto dhikre (përmendje) edhe tjetrën e bën të pasuksesshme.**

RAHMAN: Me këtë cilësi shprehet Ai, i cili botën sikur një anije përplot me dhunti e shëtiti nëpër hapësirë, Ai i cili jep ushqim të nevojshëm për trupin njeriut për të katër stinët, sikur një limanë të asaj anije, Ai trupin e krijuar prej dheu dhe e ushqen me ushqime prej dheu, Ai që njeriun e furnizon me shpirt dhe me ajetet kuranore, që janë fjalë e Tij, që t'i të zbatojë urdhrat dhe ndalesat e Tij, Ai pra është All-llahu mëshira e të cilit është më e madhe se dënimi i Tij. **Në botë All-llahu nuk bën dallim në furnizim mes besimtarit dhe jobesimtarit.**

Besimtari që ia ka hapur zemrën Rrahmanit, pa dallim ka mëshirë ndaj të gjitha krijesave të All-llahut. Edhe në gjendje lufte nëse pabesimtari e thotë shehadetin, besimtari e mëshiron atë, shpata e tij mbështillet me mëshirë dhe nuk pret më, e nëse në luftë e ka patjetër që ta vrasë armikun edhe vrasjen e bën pa torturë. Prej vëllaut të tij tiran mundohet ta largojë tiraninë, mundohet t'i ndihmojë të nevojshmit dhe ka mëshirë ndaj tij.

RAHIM: Çdo gjë në tokë dhe në qiell e madhëron All-llahu: kullosa dhe drunjtë i bëjnë sexhde All-llahut. All-llahu e dallon besimtarin nga pabesimtari, i cili nuk i bën sexhde dhe i bën

shok All-llahut, kështu që besimtarin e zhyt në mëshirën e Tij, kurse pabesimtarin e fut në xhehennem.

Besimtari, zemra e të cilit është ujitur me mëshirën e All-llahut, të gjithë besimtarët duhet t'i dijë si pjesë të trupit të tij, urinë dhe etjen e tjetrit duhet ta ndjejë në tërë trupin e tij, të përplitet sikur harabeli që i përpëlit fletët mbas shqiponjës, e cila ia sulmon të vegjlit e saj

EL-MELIK: Yjet të cilat janë të shkapërderdhura nëpër qiell sikur miliarda balona të lidhura me pe, duke u rrotulluar në planetin e caktuar dhe në mbrëmbje duke e shndërruar qiellin në vend të kamomilëve, të cilat e dinë se të kujt janë dhe se cili është pronari i tyre dhe thonë se PASURIA ËSHTË E ATIJ, ato, krahas asaj që njerëzve u bëjnë dritë, që natën ua tregojnë rrugën dhe detyrës për stolisjen e qiellit, e kanë për detyrë që shejtanët t'i largojnë dhe t'i pengojnë që të mos mund të hipin në qiell. Njeriu që beson në El-Melik kur shikon kah qielli, sheh dritë, largesë dhe yje, sheh njëzëri blu magjepsëse.

Kur syrin e kthen nga toka sheh fusha me valë të gjelbëra, dete me shkumë të bardhë, sheh male të larta që dëshirojnë të arrijnë në qiell. I mbyll sytë dhe shikon botën e vet ku gjen miliona erëra lulësh, sheh miliona pemë dhe perime të shndërruara në gjak, sheh se në një pikë gjaku jetojnë me miliona gjallesa, në trurin e vogël të tij, ku bëhen paqe dhe luftëra, sheh se janë të regjistruara me miliarda kujtime dhe thotë se “**Sundimtari i vërtetë All-llahu sa i madhëruar është**” (20/114) dhe fillon që shpirtërisht të fluturojë drejt Atij **El-Melikut** “**Ai është pronar i pasurisë**” (3/26), kurse tapitë tona janë të përkohshme Këto tapi një kohë kanë qenë të faraonit. Pastaj kanë kaluar në dorë të Musait (a.s.). Një kohë ishin në dorë të Konstantinit e më pas kaluan në dorë të Sulltan Fatihut. Ata jetuan dhe vdiqën. Me vete nuk morën asgjë. Sikur çdonjëri të kishte mundësi që të merrte me vete një grusht, neve nuk do të na kishte mbetur asgjë.

Ne e dimë dhe besojmë se pasuria i takon vetëm Atij dhe Ai bën me të çfarë të dëshirojë, ne e dimë se në natyrë dhe në njeriun ka rregulla (48/4-7), atë që njeriu e kërkon me zbatimin e rre-

gullave të sheriatit (4/58; 4/83), se muslimanët edhe në botë gjykohen në emër të Tij, se në ahiret do të ndodhë drejtësia absolute dhe ne mbështetemi në All-llahun që është Melik, fjalë e cila buron nga fjala el-Malik (43/74), i cili është drejtor i burgut të **xhennemit**, por ne kërkojmë që të shpërblehemi me **xhennet**, i cili është vend i lumturisë (54/55) “**pranë sundimtarit të fuqishëm**”.

Besimtari, i cili beson se **Meliku** është sundimtari i dy botëve dhe këtë e vërteton dyzet herë me leximin e ajetit të katërt të surës Fatiha në namazet e tij ditore, nuk i përulet botës, gjërave në këtë botë apo gjërave që i ka bërë njeriu me dorën e vet. **Ai nuk është robi i njeriut, por është robi i All-llahut.**

Është e lejuar që simbolikisht njeriut t’i thuhet melik. Komandantin Talut e kanë quajtur melik (2/247).

EL-KUDDUS: Ai është larg çdo gjëje që mund t’i përshkruhet, është larg bile edhe prej cilësive edhe më të bukura që mund t’i mendojë mendja e njeriut, sepse imagjinata e njeriut është prej atyre gjërave që dihen. Ndërkaq, All-llahu xh sh është diçka tjetër nga ajo e bukur dhe e mirë që ne e dimë dhe e njohim **Ai është ashtu sikur Ai vet e ka përshkruar veten e Tij.**

All-llahu që është Kuddus është i pastër. Për të filtruar dhe pastruar rrethin (natyrën) e ndotur, Ai ka krijuar me miliarda drunj dhe lule. Ai për të marrë papastërtinë e ajrit, natyrën e ka zbukuruar me erëra pishash, trendafilash dhe manushaqesh. Çdo gjëje që nuk lëviz, i vjen era. Këto ujëra që nuk lëvizin dhe u vjen era i avullon dhe i zhduk dielli dhe për të pastruar përsëri ajrin. Atë ujë të avulluar e kalon nëpër llambikun e ajrit dhe përsëri na e kthen në tokë për pastrim (8/11 dhe 25/48,49) dhe për zbukurim.

Për pastrimin e detit me miliona gjallesa janë në aksion. Sikur të gjitha vezët e peshqve të bëheshin peshq për një moment, deti do të mbushej me peshq dhe do të dilnin në tokë ku nuk do të mund të jetohej prej erës së tyre.

Dielli duke i zhdukur papastërtitë, natyra merr ngjyra të ndryshme. Ushqimi i mijëra kafshëve, zogjve dhe i insekteve janë

coftinat, papastërtitë, mbeturinat, eshtrat etj. All-llahu **KUDDUS** është i pastër. Ai dëshiron që njerëzit dhe natyra të jenë të pastër. All-llahu me ligjet e sheriatit dëshiron që ne duke shprehur keli-mej tevhidin të pastrojmë veten nga papastërtia e pabesisë, me abdest, gusul dhe me misvak të pastrojmë veten nga papastërtia fizike, kurse me zekat dëshiron që të pastrojmë pasurinë tonë. Ai kërkon që ligjet që i ka vënë në natyrë të mos mundohet dikush t'i ndryshojë dhe çdokush të mbrohet prej djallit dhe ka paralajmëruar se djalli njerëzit do t'i urdhërojë **“të ndryshojnë atë që ka krijuar All-llahu”** (4/189).

Ata të cilët besojnë në **KUDDUS** dhe e pastrojnë zemrën dhe trupin e tyre, në të njëjtën kohë do të jenë edhe pastrues Mushriku (politeisti) së pari zemrën e tij do ta pastrojë me **Lailahe** dhe do ta stolisë me **illallah**, sikur dielli, së pari do ta thajë papastërtinë e pastaj do ta shndërrojë në një bukuri manushaqeje dhe me vetveten e tij nuk do ta përlyejë me pisllek.

EL-MU'MIN: All-llahu është Ai që jep besim, siguron çdonjërin, qoftë mu'min qoftë pabesimtar, prej mijëra belave dhe fatkeqësive, besimtarët në ahiret i mbron prej xhehennemit për të mbrojtur çdo gjallesë prej rrezikut të urisë nga dheu nënë na ka ofruar çdo lloj ushqimi

Toka sikur të ishte edhe ar, përsëri ditën do të piqeshim, e natën do të ngriheshin. Zoti njeriut afrikan, i cili sot ballafaqohet me urinë, i ka dhënë rrizkun, por dora tirane jomuslimane arin, argjendin dhe fosfatin afrikan e bart në vendin e vet. Duke i përhapur fotografitë e njerëzve, eshtrat dhe lëkura e të cilëve gati sa është ngjitur nga uria, thonë kështu bëjmë ne. Ndërkaq, Zoti ynë lajmëron se do të jetojnë njerëz që do të mundohen të prishin ahengun botëror të natyrës të cilët do të lëvizin me vesvesen e djallit (4/119). Ai që beson në All-llahun **MU'MIN** është **mu'min** (besimtar) dhe sigurinë e pasurisë, jetës, nderit, mendjes dhe të fesë e siguron me anë të urdhrave të ndalesave të All-llahut

Pejgamberi ynë thotë: **“Besimtari është pasqyrë e besimtarit (mu'minit)”** (Ebu Davud, K Edeb, Hadith4918). Fjala e dytë mu'min (besimtar) që kalon në këtë hadith ka kuptimin e njeriut

besimtar, kurse disa dijetarë e komentojnë se me fjalën e dytë Mu'min ka për qëllim All-llahun xh. sh. Është thënë se kur besimi në All-llahun është me zemër, besimi shprehet edhe me punë edhe me trup, mu'min është njeriu në të cilin duken urdhrat dhe ndalesat e All-llahut Poeti thotë:

Zemrën pastroje prej çdo gjëje (tjetër përveç All-llahut)

Pasqyrë e zemrës është Rrahmani

Zemrën nga kënaqësitë ndaje

Pasqyrë e zemrës është Rrahmani,

Me këto fjalë poeti tregon se zemra duhet pastruar prej çdo gjëje tjetër përveç All-llahut. Sikur lulja gonxhe që dëgjon bilbilin, hapet dhe zemrën e ndan nga gëzimi dhe kënaqësia. Sipas poetit, edhe besimtari duhet ta hapë zemrën në detin e adhurimit me ashk dhe dashuri, e cila tregon se është pasqyrë e Zotit të vet Njeriu i cili e then pasqyrën e zemrës do të pësojë vetëm ai:

“Mos e thyej pasqyrën, sepse pastaj të tregon me një qind fotografi”, gjegjësisht, mos e thyej pasqyrën se pastaj ajo të paraqet ty me një qind fytyra.

Zoti ynë, i cili është Mu'min, neve na mbron prej mijëra sëmundjeve që duken dhe nuk duken. Flokët tanë, lëkura jonë, gjaku ynë, pështyma jonë dhe çdo gjë që ekziston në çdo kohë, përkundër miliona mikrobeve që i bëjnë sulm njeriut, presin mbrojtje të gatshme.

Zoti **Mu'min** kështu i ka krijuar gjërat Por, nëse njeriu ndërhyr dhe e prish atë harmoni, atëherë mbisundon sëmundja Ebu Umame (r a.) tregon se para 1400 vjetve brengat kanë shpejtuar drejt njeriut sikur miza bala, pastaj lajmërohen se ato brenga i kanë përzënë melekët: **“Ju sikur të shihnit ato brenga (probleme), atëherë do t'i prisnin me duar të shtrira dhe me gojë të hapura”** (Prej Taberit, El-Imanu bil Melaike, 161).

Për të qenë ne të sigurt kundër mikrobeve që shpejtojnë drejt gojës, të cilat i dimë dhe nuk i dimë dhe për të qenë të pastër dhe me trup të fortë, All-llahui ka krijuar edhe materiet ushqimore. Edhe ilaçin për shërimin e sëmundjeve e ka vënë mbi një lule.

Ai që i beson All-llahut Mu'min do t'i shëtisë të gjitha lulet dhe me ta do të flasë me një gjuhë laborator, pastaj do të mësojë se për çfarë vlejné ato ilaçe dhe në fund do të sigurojë shërim prej sëmundjeve.

Zoti ynë me kalanë **LA ILAHE ILLALLAH** besimtarët do t'i shpëtojë prej xhehennemit Besimtari që beson në këtë kelime-i tevhide duhet të dijë se të gjithë njerëzit prej Ademit a s janë vëllezërit e tij dhe me tërë pasurinë, gjakun dhe vetveten e tij do të luftojë për t'i penguar vëllezërit e tij që të mos digjen në xhehennem dhe që ata t'i marrë në kalanë e Islamit. Pasi që Pejgamberi a s thotë: **“Unë jam urdhëruar që me njerëzit të luftoj derisa ata të thonë Esh-hedu en la ilahe illallah”** (Buhariu, Iman 17, 28, Salat 28, Zekat 1, Itisam 2, 281; Muslim, Iman 32-36; Ebu Davud, Xhihad 95). Ne zemrën tonë ia kemi dhuruar Krijuesit (**HALIK**), i cili me formën e dhënë një pike uji të quajtur meni, e krijoi njeriun.

Ne e njohim Dhuruesin (**VEHHAB**), i cili krijoi ujin, ajrin, diellin dhe tokën, i cili pa kërkuar shpërblim tokës i dhuroi mijëra lule për të çelur, kështu që ne nuk falënderojmë askë tjetër përveç Tij. Pasi që ia kemi hapur krahët Shndërruesit (**MUHAVVIL**), i cili tokën e shndërron në lule, lulen në mjaltë, mjaltën në gjak, kurse gjakun përsëri e kthen në tokë, nuk do të zhdukemi në dhe.

Ne i besojmë Furnizuesit (**RAZIK**), i cili e furnizon çdo gjallesë që lëviz, kur nga frika e rrizkut nuk ia hapin krahët e as që i përulemi krijesës.

Ne jemi mbështetur në Mbrojtësin (**HAFIDH**) që mbron fëmijën në barkun e nënës nga të ftohtit dhe nxehtësia, i mbron kafshët nga kullosat e dëmshme, prandaj nuk frikësohemi prej tiranisë dhe çfarëdo lloji torture që bëhet nga ana e pabesimtarëve apo tiranëve

Ne zemrën tonë ia kemi hapur Mëshiruesit (**RAHMAN**), i cili edhe pse besimtarit i jep nga dhuntitë e Tij në botën e shtruar sikur tryezë, kurse pabesimtarit i jep zemërim, nuk bën dallim në mesin e tyre Lulen e zemrave tona me ballë e kemi paraqitur në sexhde, kurse me gjuhë në dhikër (përmendje).

Ne jemi përrulur përpara **XHEBBAR-it**, i cili i then në mes ata të cilët pretendojnë në zot në pasurinë e Mëshiruesit, i cili kra-hun e thyer të kanarinës e mbështjell me mëshirën e Tij, prandaj nuk përkulemi dhe nuk puthim këmbën e asnjë tirani.

Ne pasi që e njohim Krijuesin (**BARI**), i cili çdo gjë që ka krijuar e ka vënë në një harmoni ngjyrash dhe vijash të ndryshme dhe i cili ka krijuar belin e hollë të milingonës shumë punëto-re, në punët tona kemi kujdes për imtësitë, thjeshtësitë dhe në bukurinë e saj.

Ne e njohim Formëdhënësin (**MUSAVVIR**), i cili ka krijuar me miliona krijesa që nuk i përngjajnë njëra-tjetrës, i cili në bish-tin e palloit ka dhënë mijëra ngjyra, i cili jep forma dhe ngjyra që nuk vjetërsohen, kështu që kur shëtisim nëpër galerinë e botës nuk harojmë që ta falënderojmë edhe pronarin e tyre.

Ne jemi strehuar te **SETTAR-i** (Mbuluesi i turpit) dhe te **GAFFAR-i**, (Mbuluesi i gjuhaneve me sevabe). Ne pasi që merremi me gabimet dhe turpet tona, nuk kemi kohë të merremi me turpin dhe gabimin e tjetrit. Ne, pasi që çdo gjë e shikojmë me kë-naqësi (**rida**), nuk grindemi.

Ne i kemi besuar **MU'MIN-it** (të Besueshmit), i cili me dri-tën e besimit na ka shpëtuar prej errësisë së pabesisë. Me besimin që na ka dhënë, Ai na mbron prej egërsisë së botës dhe prej trish-timit të ahiretit.

Ai që beson në Mbrojtësin (**MUHEJMIN**), i cili vite me ra-dhë e mbron atë që e kanë ndërtuar me lutjen e tyre dy pejgamberët (**Ibrahimi dhe Ismaili a. s.**), ndërtimi i të cilës ishte kundër monumenteve torturuese të ndërtuara mbi mishin, gjakun dhe mbi djersën e ballit të mijëra punëtorëve të diktatorëve tiranë, rreth së cilës si flutura dhe me një dashuri rrotullohen me milionë njerëz dhe në çdo rrotullim e puthin gurin e zi (**Haxher ul-esved**), e di se prej tiranëve në botë me mallkim është përmendur vetëm emri i disave; kurse pejgamberët, të cilët kanë çuar krye kundër tiranëve, njerëzve ua kanë bërë të ditur drejtësinë e Zotit dhe ummetin e tij e përmend (përkujton) me mëshirë. Kjo tregon

se xhenneti, mëshira dhe ngadhënjimi i takon atij që e përmend **Muhejminin**.

Ne besojmë se zotërues në të dy botët është Ngadhënjyesi (**AZIZI**), i cili nuk ka shok në lartësim dhe i cili e sheh njeriun në dimensionin e tij shpirtëror të mbyllur me mjegull të errët në mendimet e tij dhe pastaj ndërton kala të ndryshme dhe kërkon ta gjejë Zotin dhe pastaj thotë: “Nuk e gjetëm dot, nuk ka” (28/38), që të jetë shembull për njerëzit që në këtë botë i zhyt në fund të detit Për ata të cilët kanë perde në sy dhe thonë se “**ne nuk besojmë në ekzistencën e një gjëje që nuk mund ta studiojmë në laborator**”. Në fillim na vjen shumë keq dhe më vonë për të pasur edhe në zemrat e tyre sy, atyre u ndihmojmë dhe i kapim për zemre.

Ne besojmë në të Durueshmin (**SABUR**), i cili i jep frymë për të lehur edhe atij që e mohon Zotin me gjuhën që ia ka dhënë po ai Zot, sikur qentë që lehin natën kur e shohin dritën e hënën Ne durojmë çdo lloj belaje apo fatkeqësie që na drejtohet neve, pas peygamberëve, duke punuar në këtë botë për shtet, ahiret dhe për xhennet

Ne e njohim Krijuesin (**BEDI**), i cili në një pëllëmbë fytyrë ka krijuar me miliarda vetulla, sy, hundë dhe vija të buzëve të pangjashme me njëra-tjetrën dhe u ka dhënë formë Ne e dimë se lulja dhe insekti nuk janë të natyrës, porse edhe vetë natyra është vepër e All-llahut.

Ne besojmë në Grumbulluesin (**XHAMI**) e miliarda qelizave përreth shpirtit, ashtu si grumbullohen miliona grimca hekuri përreth magnetit Ne e dimë se njerëzit të cilët në këtë botë digjen në zjarr apo mbyten në ujë, përsëri do të tubohen rreth Zotit. Meqë e dimë se prej pronës së Tij nuk mund të dilet, ne i zbatojmë urdhrat e Tij dhe ikim prej ndalesave të Tij.

Ne jemi të sigurt më fuqinë e të Gjithëfuqishmit (**KADIR**), i cili lulen e bardhë e krijoi prej tokës së zezë, kurse njeriun e krijoi si drita, pabesimtarëve në fillim u dha afat e pastaj i shkatërroi. Nëse në pronën e Tij do të ecnim në rrugën e urdhrave të Tij, edhe sikur të jemi të vetmuar dhe rruga jonë të kalonte nëpër

zjarr sikur Ibrahim i s.a., nëpër lum sikur Musai a.s., apo nëpër burg sikur Jusufi a.s., në zemrën tonë nuk do të kishte frikë dhe nga rruga jonë nuk do të ktheheshim.

Ne besojmë në Regjstruesin (**MUHSI**), i cili di për çdo gjeth që bie, për çdo pikë shiu që bie, për çdo frymëmarrje që merret. Pasi që e dimë se çdo frymë që merret më nuk kthehet prapë dhe se për të gjitha do të pyetemi, atëherë kur të jemi vetëm çdo frymëmarrje duhet ta shndërrojmë në përmendje (dhikër), kurse kur të jemi në shoqëri ta shndërrojmë në fjalë me aromë të bukur sikur lulja

Ne e dimë dhe e falënderojmë vetëm Falënderuesin (**HAMID**) që është i denjë i vërtetë për lavdërim dhe falënderim dhe se Ai është furnizuesi që e furnizon njeriun me të gjitha cilësitë natyrore, i cili e bën edhe trurin elektronik, edhe pse shkencëtarët nuk pushojnë duke u lavdëruar për bërjen e trurit elektronik që regjistron zë, që shkruan dhe që flet.

Pasi të pranojmë se njeriu, i cili prej një pike është bërë fëmijë, pastaj i ri, pastaj plak dhe më në fund shndërrohet në dhe, kur i sheh ndryshimet që ndodhin në botë thotë se këto i ndryshon një i Pandryshueshëm (**HAKK**), nuk harrojmë se çdo përsosuri ka edhe zenitin e vet.

Ne e njohim Ringjallësin (**BAITH**), i cili drunjtë dhe farën e vdekur në stinën e vjeshtës të mbështjellë me qefinin e borës së bardhë, në stinën e pranverës i ringjall menjëherë dhe po ashtu besojmë në ringjalljen e njerëzve në ahiret. Ne duke rënë me kokë për dhe (në sexhde) përpara Lartësuesit (**RAFI'**), i cili zemrat tonë i rrit me iman dhe me dituri dhe i lartëson me autoritet, asnjëherë nuk dëshirojmë të jemi sikur tagutët (shejtanët) të cilët kokën e mbanin lart në qiell, kurse në jetën e përhershme të jemi prej atyre që hidhen në xhehennem. Ne e dimë se All-llahu **Rafi'** shumë mbretër tiranë në këtë botë i ka nënçmuar dhe i ka zhytur në fund të detit. Zoti ynë i cili lartëson me emrin e Tij Rafi' një pjesë të atyre që nuk janë të denjë me emrin e Tij (**HAFID**) do t'i poshtërojë në këtë botë e një pjesë në botën e ardhshme.

Paraja, pasuria, gruaja, autoriteti janë gjëra që i dëshiron çdo njeri. Njerëzit në bazë të natyrës dhe të mentalitetit në njerën, apo në disa nga ato, dashurohet në mënyrë ekstreme. Ne nga Zoti jonë, i cili është Ai që para nesh nxjerr dhe zgjeron çdo gjë (**BASIT**) kërkojmë që të na mundësojë gjërat që janë legjitime dhe që të dy botët të kthehen në xhennet, kurse Ai në disa raste për të na sprovuar e në disa raste për të na dënuar një herë na shtërngon, e një herë nga ngushton (**KABID**), kurse ne, që Ai të mos na shtrëngojë në të dy botët, përsëri e lutim Atë.

Një njeriu, që veten e llogarit dijetar, nëse i parashtrijmë pyetjen “Sa përqind di ti në krahasim me numrin e krijesave që gjenden në qiell dhe në tokë?”, si përgjigje do të kishim marrë “Dituria ime në krahasim me diellin është sa një pikë (uji)”. Për përcaktimin e numrit të qelizave në trupin tonë nuk mjafton as njohuria e as numri që e dimë për to. Njohës i të gjitha këtyre, i asaj që ka ndodhur dhe që do të ndodhë në univers është All-llahu xh. sh., i cili është Emërtuesi dhe i Gjithëdijshti (**ALIM**), i cili çdo gjë e vë në vendin e vet dhe çdo gjësë i jep rrizk. Ne ecim, çlirojmë zemra dhe për ta bërë çdo vend mesxhid (vend për lutje), pasi e gjithë toka për ne është bërë mesxhid, çlirojmë vende me emrin e Çliruesit (**FETTAH**), i cili neve derën e rrizkut na e ka hapur me anë të lidhjes së gjakut që në barkun e nënës, pastaj nga barku i nënës për në këtë botë të ngushtë na ka hapur rrugë. Në disa raste hidhërimit dhe pikëllimit të mbështjellë në zemrat tona i gjen zgjidhje me anë të një fjale, të një buzëqeshjeje, të një gjuaje, të një pasurie apo me ndonjë gjë legjitime që pëlqen zemra. Ai është Ai i cili i çelë lulet e bardha në degët me ferra dhe i cili po ashtu ka hapur dyer të ndryshme për të mos vazhduar dhuna e tiranëve ndaj luftëtarëve të drejtë.

Që të mos na poshtërojë Ai me emrin e Tij Nënshtrues (**MUDHILL**) dhe të mos na nënçmojë, ne nuk duhet të devijojmë në rrugët haram dhe të mos ndahemi nga drejtësia.

Ne gjithmonë dëshirojmë që manifestimi i emrit të Tij Ngrihtës (**MUIZZ**) të jetë në ne dhe në vendin më të lartë dhe mundohemi ta mbjellim fjalën më të lartë **kelime-i tevhidin**.

Pasi që e dimë se Zoti ynë çdo gjë që përmendim me emrin e Tij Dëgjues i gjithçkaje (**SEMI**) e dëgjon, si atë që kemi bërë në këtë si mesxhid, si atë që kemi folur apo që kemi menduar, mundohemi që nga goja jonë mos të dalë fjalë e keqe, kurse nga zemra jonë të mos lindin ide të ndyta.

Dijetarët tanë shumë me vlerë për cilësitë dhe emrat e All-llahut xh. sh. na kanë dhënë njohuri shumë të mira Shkrimtarët tanë, të cilët i kanë komentuar nëntëdhjetë e nëntë emrat e All-llahut, për të cilat ka lajmëruar Pejgamberi a. s., përveç tyre kanë përmendur edhe dyzet cilësi që në vete i ngërthejnë të gjithë emrat e Zotit Gjashtë prej tyre përmenden si **cilësitë dhatije**, kurse tetë të tjerat si **cilësitë thubutije**.

Cilësitë e All-llahut

Cilësitë dhatije

1. Vuxhud: All-llahu xh.sh. ekziston. Zoti ynë thotë: “A dyshojnë në ekzistimin e All-llahut Krijuesin e qiellit dhe të tokës?” (Ibrahim, 10).

“Ai është i Pari që s’ka fillim dhe i Fundit që s’ka mbarim, i Dukshmi dhe i Padukshmi, dhe Ai është më i Dijshmi për çdo gjë” (Hadid, 3).

Argument për ekzistimin e Tij është Ai vetë (Ali Imran, 18). Gjithashtu janë ajetet e Kur’anit dhe ato që i shohim në gjithësi Njeriu që arrin në një ishull, nëse atje sheh ndonjë përkujtimore, menjëherë do të mendojë se dikush ka ardhur dhe e ka ndërtuar atë. Kurse nuk thotë **“Këtu ka rrënë shi dhe e ka zbutur mermerin, e pastaj erërat e forta atë e kanë shndëruar në statujë”**, sikur që sot thonë disa të çmendur se **“Natyra është vepër e rastësishme”**. Kur e sheh violinën dhe botimin, e mendon artistin e tyre Ai nuk tregon çmendurinë duke thënë se zëri që del prej bilbilit të thatë është i rastësishëm

Njeriu nuk është sikur statuja. Ai është një krijesë që lëviz, rritet, flet, dashuron, dashurohet dhe është bërës i veprave madhështore në tokë. Muslimani nuk mund të jetë si ata të mjerët që thonë **“Se njeriu është rezultat i grumbullimit rastësisht të grurit, bukës, pemëve dhe perimeve”**.

2. Kidem: Ekzistenca e All-llahut nuk ka fillim. Koha dhe vendi janë për ata që janë të krijuar. Pasi që Ai nuk mund të kup-

tohet apo të rrethohet nga ndonjë krijesë nuk ka fillim. Sikur “**Ai të kishte fillim**” do të shtrohej pyetja se kush është krijuesi i fillimit të Tij, kështu që e tërë jeta do të kalonte me pyetjen se “kush e krijoi atë, kush e krijoi atë”.

3. Beka: Ekzistenca e All-llahut nuk ka mbarim (fund). Këtu thuhet ajo që u tha për cilësinë **kidem** Pasi vendi dhe koha janë të krijuara nga Ai, atëherë ato nuk mund ta rrethojnë Atë. Për këtë arsye pasi që All-llahu nuk ka fillim dhe mbarim **çdo gjë është e kalueshme, kurse Ai është i përhershëm.**

Ai i cili i beson All-llahut të përhershëm, asnjëherë nuk përkulet përpara atyre që janë kalimtare, kështu që njeriu krijesën nuk e pranon si gjënë më të lartë dhe autoritetit të tij nuk i nënshtrohet asnjëherë. Nëse njeriu i përkulet fuqisë e cila njeriun e ka krijuar nga një pikë uji, pastaj atë e mplotak dhe më në fund e shndërrohet në dhe, atëherë nuk i përkulet me tjetërkujt.

4. Vahdanijet: Edhe thelbi edhe cilësitë e All-llahu janë të njëjta. Ekzistim i çdo gjëje çift (mashkull-femër, i ëmbël-i idhët, i plotë-i mangut, mirë-keq, dita-nata) është argument për ekzistimin e Tij. Prej kur është krijuar bota, moskalimi i natës dhe i ditës, i njëra-tjetrës, lëvizja e pahabitshme e hënës në orbitën e saj, ngjyra dhe era e lules dhe mosçelja e karanfilit në degën e lules, janë argumente për njësinë e All-llahut, janë shenja për mosekzistimin e një shoku në pronën e Tij.

Në administrimet e sotme në çdo katër vjet kemi ndryshime administrative dhe fabrikat e motorëve shndërrohen në fabrika për endje Arat e hashishit shndërrohen në ara gruri (drithi). Pasi të ndërrohet udhëheqja, përsëri prishet Edhe rregullat në natyrë tregojnë për njësinë e Tij si udhëheqës dhe si krijues. All-llahu në Kur'an tregon se krijuesi i rregullit të gjithësisë është tek: “**Sikur në qiell dhe në tokë të kishte zotër të tjerë të dy (edhe toka edhe qielli) do të shkatërroheshin**” (Enbija).

Ata që besojnë në All-llahun të vetëm kanë një libër, një kible, një qëllim dhe mes veti kanë një bashkim.

Pasi që i besojnë All-llahut që është Zot i vetëm, nuk bëhen të pamoralshëm sikur ata të cilët edukohen sipas disa metodave të tjera, **por edukohen me edukatën e Zotit.**

Pasi që ata besojnë në All-llahun si Zot i vetëm, nuk u nëshetrohen dhe nuk i pranojnë rregullat e atyre të cilët punojnë për fitimin e tyre vetjak.

Pasi që beson se rrizkun e jep vetëm Ai, ai nuk i nënshtrohet askujt dhe pasi bën përgatitjet e duhura nuk ndjen pikëllim.

5-Muhalefetun li'l havadith: Ai nuk i përngjan asnjërës prej krijesave “A është Ai që krijon njësoj sikur Ai që nuk krijon?” (Nahl, 17), “Atij nuk ngjan asgjë” (Bekare, 11).

Ai sheh por jo sikur ne. Të parit e tyre është i kufizuar. Ai ndëgjon, por jo sikur ne që jemi me të dëgjuar të kufizura. Në çdo gjë të krijuar ka ndryshime. Të fuqishmit dobësohen, mbretërit rrëzohen, zjarret shuhen, bile edhe njeriu më i fortë prej një mikrobi shumë më të vogël shtrihet për tokë. Ata që lindin dhe që linden, vdesin, flejnë, druri i jetës u pritët.

Zoti ynë “**Nuk ka lindur e as nuk është i lindur**” (Ihlas, 3) “**Ai as nuk fle e as nuk dremit**” (Bekare, 255). Sikur të flinte apo të dremiste, yjet do të dilnin prej orbitës së vet dhe do të ndesheshin mes veti.

All-llahu është tjetër prej çdo gjëje dhe çdo forme që mund të paramendohet. Ai është tërësia e asaj që bën iluzion, që sheh dhe që di njeriu, kurse All-llahu është krijuesi i tyre . Krijuesin nuk e nxë krijesa. Për atë peygamberi a s ka thënë: “**Mos mendoni në All-llahun, por mendoni në ni'metet e All-llahut**” (Taberani dhe Bejhaki, Keshfu'l-Hafa 1/311).

Ndihma e Tij nuk u përngjan ndihmave të krijesave. Ai pasi është edhe krijuesi i ndihmës së krijesës, ajo ndihmën e kërkon prej Tij. Kështu muslimani nuk frikësohet prej asnjë force dhe fuqie tjetër përveç Tij.

6. Kijam bi nefsihi: Ai ekziston vetvetiu i pavarur dhe nuk ka nevojë për krijesat e Tij. Sikur Ai të ishte krijuar prej dy gjërave, do të shkatërrohej. Atëherë duhej të kishte një tjetër që këto dy gjëra t'i bashkonte. Pasi të gjitha këto janë të pamundshme,

atëherë Ai është **KAJJUM**, ekzistenca e të cilit është nga vetë Ai dhe krijimi i të gjitha krijesave, jeta e tyre dhe kthimi tek Ai, janë në dëshirën, fuqinë dhe në diturinë e Tij. Çdo gjë ka nevojë për të, kurse Ai nuk ka nevojë për asgjë.

Një njeri që beson se çdokush dhe çdo gjë është krijuar nga Ai dhe se çdoherë kanë nevojë për Të, nuk i beson askujt tjetër, përveç Atij.

Ai që e di se rizku i çdonjërit është në dorën e Tij, duke u frikësuar prej rizkut, nuk shitet dhe nuk i nënshtrohet askujt, pos All-llahut.

Ai që beson se Ai është ringjallës dhe mbytës i çdo krijese, nuk frikësohet se dikush mund ta mbytë. Ai i bën përgatitjet dhe jeton në rrugën e Islamit.

Cilësitë thubutije të All-llahut

1. Hajat: Ne mbështetemi dhe besojmë në All-llahun që të shijojmë pavdekshmërinë dhe mbetemi të gjallë, sepse Ai është i gjallë, kurse vdekja është specifike vetëm e krijesave të Tij, gjallëria e të Cilit është e përhershme. Prej kur është lajmëruar se ata të cilët vdesin në rrugën e All-llahut janë të gjallë (Ali Imran, 169), pejgamberët dhe ummetet e tyre nuk janë frikësuar prej atyre që i kanë penguar prej rrugës së xhennetit.

Besimtar i vërtetë është ai i cili beson se mbështetja në urdhërat e All-llahut jep jetë dhe i cili gjatë gjykimit përpara mbretit tiran thotë: **“Burgu im është vetmia, udhëtimi im është syrgjynosja, kurse dëshmia është vdekja në rrugë të All-llahut”**.

2. Ilm: Njeriu që beson në All-llahun i cili di atë që është e fshehur dhe që duket (En'am, 73), atë që gjendet në barkun e nënës (Ra'd, 8), atë që është në zemër (Enfal, 43), nuk e prek haramin qoftë në shtëpi, në punë, në apartament, në kazermë apo në maje të malit.

Ai dëshiron që dituria e përhershme e All-llahut të manifestohet edhe në të, të shpëtojë prej paditurisë dhe të punojë dhe të stoliset me dituri e cila është ndërtesa e aksionit.

Besimtari mëson se në botë lulet, insektet, njeriu dhe yjet janë krijuar për njeriun. Ai flet sikur Llukmani, sepse dhe se për çfarë janë krijuar të gjitha këto dhe në fund ia ofron njeriun për shërbim.

Besimtari ajetet e Kur'ani Kerimit, i cili ka zbritur për t'i rregulluar marrëdhëniet ndërmjet njerëzve dhe njeriut, ndërmjet njeriut dhe Zotit dhe ndërmjet njeriut dhe natyrës, i lexon një nga një, i kupton dhe i zbaton, sepse ai ka ardhur prej All-llahut që di (**ALIM**) çdo gjë.

3. Semi': Ai dëgjon çdo gjë (Zuhruf, 80). Njeriu që beson në All-llahun, së pari, kontrollon gjuhën e tij, ndërsa duke e përmendur All-llahun dhe duke e shpjeguar Islamin në rrugën e All-llahut, e mban veten të gjallë. Ai mbrohet prej fjalëve amorale, rënies në zina me gjuhë, frikësohet prej rënies në xhehennem me fjalë përgojimi, shpifjeje, rrene, sharje. Ai pasi që e di se çdo fjalë që del prej goje All-llahu e dëgjon dhe se ajo regjistrohet, ai largohet prej fjalëve që nuk përputhen me rizanë e All-llahut, prej fjalëve që e nënçmojnë njeriun si fjalët kaba, ofenduese, të shëmtuara në fjalët e mira, përmirësuese dhe magjepsëse.

Ai, pasi që e di se kufijtë mes shteteve nuk mund t'i pengojnë fjalët, madje edhe furrat më të mëdha, si Bizanti dhe shteti i Xhengis Kanit, nuk kanë mund t'i ndalin fjalët e bukura të Islamit, duhet ta përdorë mirë edhe shpatën e dorës edhe shpatën e gjuhës.

4. Besar: "Ai sheh gjithçka" (Shura, 11). "**Ai i sheh të gjitha sytë**" (En'am, 103). Sytë tanë Atë nuk e shohin, por i shohin krijesat e Tij. I shohin krijesat e Tij që të adhurojnë Atë sikur ta kenë parë. Pejgamberi a.s. ihsanin (bimirësinë) e shpjegon kështu: "**Ibadeti duhet bërë sikur All-llahun e shohim. Edhe pse ti Atë nuk e sheh, Ai të sheh ty.**" (Muslim, Babu bejanil iman vel Islam vel Ihsan 9) dhe ka lajmëruar se ne të gjithë jemi nën kontroll.

Muslimani duhet të jetë më i kujdesshëm se shoferi, i cili nga frika se mos e kapë radari gjatë rrugës nuk e kalon shpejtësinë e duhur. Madje edhe nëse radari prishet dhe prej policit nuk merr dënim. Edhe nëse merr dënim ai është dënim me para. Vetëm se njeriu i cili e kalon kufirin e hallallit të All-llahut, melekët e shënojnë ashtu sikur e sheh All-llahu. Te melekët nuk mund të ketë gabime. Ata nuk mashtrohen me para ose me ndonjë grua. Për këtë një musliman që beson se All-llahu është **Besir** (Sheh çdo gjë), nuk orvatet për vjedhje, kamatë, për treg të zi, dhe me rrugë të rrejshme ta uzurpojë pasurinë e huaj, me anë të zinasë të prekë në nderin e huaj, me anë të alkoolit të mohojë zotin me trup dhe me shpirt dhe të jetë jo i ndershëm ndaj miliona krijesave që e madhërojnë All-llahun.

5. Irade: Një gjë në fillim nuk ekziston e pastaj ndodh me dëshirën e All-llahut. “Ai bën atë që dëshiron”. (HUD 107; Kassas 67), “Ai kur dëshiron diçka vetëm thotë bëhu dhe ajo bëhet”. (Nahl 40; Jasin 82).

Dëshira e All-llahut nuk i ngjan dëshirës sonë. Ne atë që dje e kemi dashur shumë sot mund ta hedhim në bërllaqe. Dëshirat janë të kufizuara dhe të ndryshme, pasi që të menduarit, ndjenjat dhe të kuptuarit tonë është i kufizuar. Për këtë gjë, nëse dëshirën tonë ia nënshtrojmë dëshirës së krijuesit të gjithësisë dhe udhëheqësit më të mirë të saj, atëherë mund të shpëtojmë.

Jo për përgjegjësinë, por kjo i ngjan dëshirës së babait që fëmija i tij të mos prekë kabllon elektrike, kurse dëshira e fëmijës është të luajë me kabllon dhe me prizën elektrike. Shpëtimi i fëmijës është në përshtatje me dëshirën e tij ndaj dëshirës së babait të tij.

Ai i cili i nënshtrohet dëshirës absolute të All-llahut, nuk i mbetet më që t'i nënshtrohet një njeriu tjetër sikur ai vetë dhe zhduket edhe idhujtaria.

Në çdo kohë ka nga ata që fryjnë erë pabesie dhe ua do zemra, që hyjnizojnë dëshirën e tyre apo dëshirën e faraonit, Nemrudit, Ebu Xhehlit, Marksit.

6-Kudret (Fuqia): Fuqia e Tij mjafton për çdo gjë. Historia e njerëzimit nuk ka parë dhe nuk do të mund të shohë Krijues më të fortë që ka krijuar diellin, i cili pa lëndë djegëse e nxeh dhe shndrit botën, Rrotullues që rrotullon trilionat e yjeve pa mos u ndeshur njëri me tjetrin që nga krijimi i botës, Dhënës i jetës dhe Krijues i miliona gjallesave në një pikë gjaku. Njeriu që është krijesa më e fortë mund të ngre vetëm një peshë të caktuar. Në një moment dridhjeje shohim se malet lëvizin nga vendi dhe llavët shkaktërojnë çdo gjë përpara tyre. A thua kush i bën këto dhe malet të vlojnë dhe të lëvizin nga vendi?

Nëse tërë botën si lëndë djegëse do ta futnim në diell, nuk do të zgjaste as pesë minuta. Ajo do të digjej sikur gjethi i hedhur në flakë. Pse lënda djegëse e këtij dielli nuk përfundon prej kur është krijuar bota?

Atë e ka krijuar All-llahu “Fuqia e Tij mjafton për çdo gjë” (Hadid 2). “Ai është pronar i fuqisë dhe i forcës” (Dharijat 58). Njeriu që beson se fuqia e tij është e mjaftueshme për çdo gjë dhe që sheh dhe di se fuqia e krijesave të Tij është e kufizuar, nuk frikësohet nga kjo fuqi ekonomike, politike dhe nga armët e njeriut me fuqi të kufizuar. Ai që beson në Fuqinë (Kadir) e Zotit, veç qasjes së çdo lloji kushtesh në rrugën e Tij, pa u frikësuar, vazhdon në rrugën e Tij.

7. Kelam (të folurit): All-llahu flet pashkronja dhe pa zë. Poeti Ahtal në një poezi thotë: “Fjala është në zemër, kurse gjuha është argument i asaj që është në zemër” (Sirri Pasha, Ahsenul Kasas, 1/37).

Fjala e përhershme pa fund dhe pa fillim është fjala që gjendet në vetë Zotin si kuptim.

Fjalët, shkronjat, dhe format nuk janë as pa fillim e as pa mbarim.

Librat dhe peygamberët që i janë dërguar një populli, janë dërguar në gjuhën e atij populli, edhe librat janë shkruar në gjuhën e atij populli. Qëllimi i fjalës Kelamullah është vetë kuptimi që shpreh fjala.

Një besimtar që beson se Kelamullah është i pafillim dhe i pafund, është i qëndrueshëm kundër atyre që dëshirojnë ta shpallin joligjor dhe prodhojnë fjalë kundër fjalës së All-llahut dhe e dinë se ajo është e përhershme, do të dominojë mbi atë që është e përkohshme.

8. Tekvin (Krijimi): All-llahu krijon. Edhe kjo cilësi është e përhershme, pra në aspektin kohor nuk ka fillim dhe mbarim.

Sikur cilësia e krijimit të ishte e krijuar duhej të kishte edhe një krijues tjetër, përveç All-llahut. Edhe kjo logjikisht nuk është e mundur, sepse sikur të pranomin një krijues tjetër dhe ai të kishte cilësinë krijesë, do të kishte nevojë për një krijues tjetër. Kjo çështje nuk ka kufi, pyetje dhe përgjigje të pafundta.

Ka një fjalë si “çdo gjë është e krijuar vetvetiu”, të cilën e kanë thënë mu'tezilët, kurse tash e thonë adhuruesit e natyrës, ateistët. Ndërkaq vetë jeta e tyre e përgënjeshton një gjë të tillë.

Sikur njeriu vetë ta kishte krijuar veten e tij, nuk do të kishte dashur asnjëherë t'i bien dhëmbët, t'i zbardhen flokët, t'i dobësohen sytë, t'i shtrembërohet trupi apo edhe të vdesë. Të gjitha këto raste flasin për manifestimin e cilësive të ne si ihja-ringjallje, imate-vdekje, tahlih-krijim, terzik-furnizim.

Edhe sikur disa gjuhë ta mohojnë cilësinë krijuese, me miliona ose miliona krijesa në univers në gjuhën e tyre vërtetojnë një gjë të tillë.

Njeriu që beson në All-llahun si krijues i çdo gjëje, sikur edhe vetë të ishte në këtë univers nuk do të mund ta ndjente se është vetë, por do ta kuptonte se tërë gjithësia është me të.

Pasi që Ai është ai që i vdes, që i ringjall dhe që i furnizon njerëzit, arma dhe fuqia e armikut nuk do ta neveritë njeriun pas marrjes së masave të nevojshme. Njeriu ecë drejt caktimit të Zotit.

Besimi në melekët

Ne besojmë në melekët të cilët me urdhrin e Zotit na mbrojnë, fjalët dhe sjelljet tona i shënojnë, i zbatojnë rregullat natyrore të Zotit për përgatitjen e ushqimit dhe veshjes së nevojshme për shpirtin dhe trupin tonë. Ato i duam për shkak të besimit tonë. Si mos të duhet ai që rregullisht neve na mbron pa shpërblim dhe nuk ndahet nga ne as edhe një moment. Ka raste kur nëna, familja apo fëmija të nervozohen për një fjalë apo një sjellje tonën dhe të na braktisin, kurse melekët a mund të jenë të tillë... edhe pse në disa punë dhe fjalë nuk pajtohen me ne, por përsëri nuk na braktisin.

Ato për ne gjithmonë i luten Zotit (40/7). Zoti në 88 ajete të Kuanit flet për melekët. Pejgamberi a.s. tregon se “melekët janë të krijuar prej dritës, shejtanët prej zjarrit, kurse Ademi prej dheu” (Muslimi, Zuhd 60). Numrin e tyre e di vetëm All-llahu: “Melekët nuk kundërshtojnë All-llahun, por i zbatojnë urdhrat e Tij” (66/6).

Specifikat e melekëve

Këto krijesa të vlefshme janë të krijuara prej drite dhe mund të shihen vetëm me lejen e Zotit. Tregohet se melekët i janë paraqitur Merjemes, nënës së Isait a.s. (19/16), Ibrahimit a.s. (51/24-28), Lutit a.s. (11/77-78).

Për paraqitjen e tyre Davudit a.s. na tregon Kurani a.sh. (38/21-22), ndërsa për atë se si i janë paaqitur Pejgamberit a.s. edhe sahabeve të tij na tregon hadithi i njohur, si Hadithi i Xhibril-it (Muslimi, Iman 7; Ebu Davudi, Sunen, 4695; Tirmidhiu, Iman H. 2613).

Shndërrimi i materies në energji dhe i energjisë në materie e bën më të qartë paraqitjen e melekut në formë të njeriut dhe kthimin e tij përsëri në gjendjen mëparshme. Kur shtypim sustën e televizorit, paraqitet fotografia jonë bashkë me ajrin që e marrin në momentin përkatës dhe të njëjtën e shohim në ekan. Nëse njeriu i cili nuk mund të pengojë lëvizjen e qerpikut e bën këtë, atëherë çfarë mund të bëjë Zoti?

Fuqia e melekëve

Telin e kuq të bakrit ne mund ta shohim, kurse rrymën në tel nuk mund ta shohim. Pasi nuk mund ta shohim nuk mund të themi se rryma nuk ekziston, pasi ndikimin e saj e shohim me ndezjen e llambës ose në ngritjen e qindra tonelatave. Prej Kurani Kerimit mësojmë se melekët kanë një fuqi të madhe, saqë me një frymë i vrasin gjallesat në tokë dhe në qiell (39/68), se ka melekë që e mbajnë fronin (69/17), se ata janë që e kanë kthyer në gjendje normale gjendjen e homoseksualitetit që e mundësojnë sot shtetet e zhvilluara këta janë që i shkatërrojnë vendet e popullit të Lutit a.s. (11/82).

Në bazë të asaj që e dimë se shpejtësia e dritës është 300.000 e më tepër km në sekondë, lajmi për atë se rrugën prej 50 mijë vjet të gjatë e kalojnë për një ditë, duhet kuptuar më mirë.

Vetëm se kjo është një çështje e besimit. 1400 vjet më parë, në kohën kur shpejtësia e dritës nuk është ditur, njerëzit kanë thënë: “Nëse thotë Zoti, është e vërtetë”. Sot ata të cilët janë verbuar me errësirën e pabesisë thonë: “Ne besojmë nëse këtë e vërtetoj-

në evropianët”. Ata, pasi nuk kishin mundësi të shpjegonin sesi janë bërë kalatë, mbishkrimet dhe piramidat që gjenden në sipërfaqe të tokës, kanë thënë se janë shokë jashtokësorë, kurse për shpirtrat më mistikë që kanë zbuluar shokët botërorë, kështu kanë bërë shpjegime të paqarta. Të gjitha këto detyrime pengojnë që trutë të mendojnë e të pranojnë besimin. Në Kuran jepen njohuri për urdhrat, ndalesat, parimet morale, sistemin e administrimit të shtetit, jetën në të kaluarën dhe për të ardhmen. Për të kaluarën jepen shpjegime të tilla, saqë shkenca e sotme e njeriut modern ende nuk është në gjendje t’i kuptojë ato. Thesi shkencor prej najlloni nuk mund të jetë kallëp për arin e shkrirë, sepse digjet.

Kurani tregon se “Ata diturinë që nuk e kuptojnë, e përgënjeshtrojnë” (27/84). Ai lajmëron se Jakubi a.s. duke qenë në qytetin Kenan, në largësi prej 500 km prej Egjiptit, ku ka qenë Jusufi a.s., e ka ndjerë erën e Jusufit, kurse ata që kanë qenë përreth tij kanë thënë: “Ti je i marrë” (12/94). Jakubi a.s. si ka pasur mundësi ta nuhatë erën e Jusufit a.s. 500 km në largësi? Nëse atë e sjell era e cila ka shpejtësi prej 100 km në orë, atëherë deri te Jakubi duhet të arrijë për 5 orë, kurse në ajet lajmërohet se sapo u nda prej Egjiptit, ai e nuhati erën e Jusufit. (12/94). Era e (aroma) që vjen në moment nuk ka rrymë. Sot ka rrymë nëpërmjet të së cilës zëri dhe forma e diçkaje mund të transmetohet nëpërmjet kanaleve televizive. Në televizor mund të shohim lulet e ngjyrave të ndryshme, por nuk mund ta nuhatim erën e tyre. Kjo ngjarje që i ndodhi Jakubit a.s. është një muxhize e Allahut xh. sh.. Muxhizet janë ndodhi mbinatyrore me të cilat pejgamberët me ndihmën e All-llahut kanë korrë sukses në misionin e tyre. Njerëzit në këso lloj veprimesh pa ndërmjetësus nuk mund të veprojnë.

Detyrat e melekëve

Melekët, numrin e të cilëve e di vetëm All-llahu (74/310), veprojnë nën udhëheqjen dhe kontrollin e katër melekëve të mëdhenj: Xhebrailit, Mikailit, Israfilin dhe Azrailin.

Një pjesë e tyre pa u bezdisur, mërzitur apo lodhur, natën dhe ditën e madhërojnë All-llahun (21/20). Një pjesë mbajnë arshin (39/75), kurse një grup tjetër janë të obliguar me xhennetin (13/24). E një pjesë i shkruajnë fjalët, sjelljet e mira dhe të këqija (50/18).

Disa melekë janë të obliguar që të na mbrojnë (82/10). Në një moment rreziku mbyllja e menjëhershme e syrit, e mbron syrin nga rreziku. Në kësaj i themi **refleks**, porse kjo realizohet pa dëshirën e njeriut që është krijesa më e fortë në natyrë. Këtë ngjarje fjala refleks nuk mund ta shpjegojë. Refleksi, i cili e realizon këtë ngjarje, me siguri është një sistem. Ai është rregull që All-llahu xh. sh. e ka vendosur në trupin e njeriut. Kurse melekët janë zbatues të këtyre rregullave. Në ndaj këtyre mbrojtësve tanë, të cilët nuk i paguajmë me asgjë materiale, duhet të sillemi mirë. Sjellje tregohet me fjalë të mirë, me orë të mirë dhe me të qenët rob i mirë përballë (karshi) All-llahut xh.sh.

Ndërkaq, disa melekë janë të obliguar me marrjen e shpirtit. Kur'ani kur flet për melekun që merr shpirt, nuk përmend njësin, por shumësin e fjalës (6/61). Aty tregohet për **Nashidat**, që i marrin shpirtrat e besimtarëve, dhe për **Nazitë** që u marrin shpirtrat pabesimtarëve duke i bërë azab (79/2). Për të dobësuar besimin tonë disa persona bëjnë pyetje: "Një melek si mund të marrë shpirtrat e disa njerëzve përnjëherë? Sipas asaj që kuptojmë prej ajeteve kuranore, meleku i vdekjes nuk është një. Por, edhe sikur të ishte një melek i vdekjes, në besimin tonë nuk mund të ketë mangësi. Në e dimë se miliona drita që janë të ndezura në Stamboll një njeri mund t'i ndalë për një moment.

Llojet e melekëve

Prej katër melekëve vetëm emri i Xhebrailit dhe i Mikailit përmendet në Kur'an (2/98), kurse emri i Israfilin përmendet në Sunnet (Hakimden Naklen el manu bil melaike 59; Tirmiziden naklen sah: 89). Emri i Azrailit në Kur'an përmendet si Melekul Meut (32/11). Në hadith emri Azrail nuk përmendet, vetëm se djali i Aliut r.a., hz. Huseini ka thënë se "Azrail do të thotë Abdul Xhebbar" (Ibni Cerriden naklen, el-imanu bil melaike 59).

Xhebraili është një melek i madh që ka pamje madhështore, dituri të mirë, biografi të mirë, dritë dhe fuqi për të penguar dëmin e shejtanit dhe të pabesimtarëve ndaj Kur'anit; është i besueshëm në sjelljen e shpalljes dhe në ndihmën që ua bën apo do t'ua bëjë besimtarëve (el-iman bil melaike, f.60), besimtarëve u jep forcë (16/102), pabesimtarëve u jep frikë (7/171) dhe i dënon ata (7/78), i do besimtarët që i do All-llahu (Ahmed Ibn Hambelden naklen, el-Imanu bil melaike, 74). Detyra e tij nuk është vetëm sjellja e shpalljes.

Mikaili edhe ky sikur melekët e tjerë e madhëron All-llahun (37/166), udhëheq me rënien e shiut dhe rritjen e kullosës (Taberani ve Bajhakiden naklen, el-Imanu bil melaike 95), pra ligjin që All-llahu e ka vënë në natyrë, me emrin e All-llahut, e udhëheq Mikaili. Ai kujdeset për ngritjen e avullit, rënien e shiut dhe daljen e rirskut prej tokës.

Israfilin është meleku që e adhuron All-llahun (37/166), që do të fryjë surin, kur do të ndodhë kijameti (39/68; 36/51; 27/87) dhe do t'i thërrasë njerëzit të ngrihen nga varri (30/25), kurse tani merret me adhurim ndaj Zotit dhe me punë të mira për të cilat ne nuk dimë gjë.

Azrailin është kryetar i melekëve që e madhëron All-llahun dhe duke marrë shpirtin e gjallesave bëhet shkak i vdekjes së tyre. Në Kur'an, në ajetin "melekët kur ua marrin shpirtin atyre që i bëjnë zullum vetes" melekët që marrin shpirt janë përmendur në shumës. Ka vende ku përdoren edhe në njëjës (32/11). Ibni Kethiri

në tefsirin e tij gjatë komentimit të ajetit (6/61), duke transmetuar Ibën Abasin, lajmëron se meleku i vdekjes (Azraili) ka edhe ndihmësit e tij. Ndërkaq, Zoti tregon se melekët që ua marrin shpirtin pabesimtarëve ua marrin me azab (8/50), kurse besimtarëve në mënyrën më të bukur (17/32). Ai që e merr shpirtin e pabesimtarëve quhet Nashidat, kurse ai që e merr shpirtin e besimtarëve quhet Naziat (79/1-2).

Melekët që bartin Arshin gjithmonë e madhërojnë dhe e falënderojnë All-llahun, kurse për besimtarët kërkojnë falje (40/7). Në ajet tregohet se ata janë tetë (69/17), por mbetet e diskutueshme se a janë tetë melekë apo tetë rreshta. Ibni Abasi tregon se ata janë tetë rreshta, kurse numrin e tyre e di vetëm All-llahu (el-Imanu bil Melaike 96).

Melekët Mukarrebun ose Kerubijjin janë melekë që njihen me afërsinë e tyre ndaj All-llahut. Këta janë melekë që pas peygamberit Muhamedit a.s. dhe peygamberëve të tjerë janë më afër All-llahut. Ata asnjëherë nuk tërhiqen nga adhurimi (4/172) dhe gjithmonë e adhurojnë Atë.

Rojtarët e xhennetit (Hazenetul xhennet): të devotshmit të cilët për të mos e humbur dashurinë e Zotit qysh në dynja, brendësinë e tyre e kanë stolitur me Hakun (Zotin), kurse anën e jashtme të tyre për popullin që në derën e xhennetit do të pritët me selam nga ana e melekve (39/73). Ata i vizitojnë besimtarët në vendet e tyre në xhennet, u japin selam dhe u tregojnë për bukuritë e xhennetit (13/23). Kryetari i melekve rojtarë të xhennetit quhet RIDVAN.

Rojtarët e xhehennemit (Hazenetul xhehennem): janë melekët e xhehennemit. Ato thuhet se janë me trup të bëshëm (66/6) dhe e bëjnë atë për të cilën janë të urdhëruar. I pyesin ata që shkojnë në xhehennem dhe, pasi që ata i pranojnë mëkatet, i hedhin në xhehennem (39/71). Emri i kryetarit të tyre është Malik (43/77). Melekët e xhehennemit quhen edhe Zebani (96/18). Numri i tyre diskutohet, ndërkaq, numri 19 që përmendet në ajet tregon udhëheqësit e melekëve të xhehennemit për të cilët disa dijetarë thonë se janë 19 rreshta ose 19 grupe (74/30).

Melekët Kiramen Katibin janë melekët që shkruajnë çdo fjalë që del prej goje (50/18), çdo fshehtësi që kalon nëpër zemër, atë që njerëzit e flasin fshehurazi mes tyre (43/80) dhe atë që e veprojnë (82/12; 45/29). Sesi është shkrimi, lapsi dhe fleta e melekëve, ne nuk e dimë. Vetëm se, pasi që të shohim se në farën e fikut, veçoritë e degëve, gjetheve dhe frutave të drurit dhe pasi që një disketë kompjuteri në vete ngërthen një bibliotekë të tërë, të mos i besosh kësaj, do të thotë të jesh i verbër. Punët që shënohen në ahiret do të jepen dhe do të na thuhet “lexo librin tënd” (17/14). Sipas asaj që lajmëron Ibni Abasi, aty është e shënuar çdo gjë që kemi ngrënë, kemi pirë, parë, kudo që kemi shkuar apo kemi ardhur (Tefsiri Ibni Kethir 50/118). Sipas lajmërimit të Hatta Tanusit edhe rënkimi i sëmundjeve do të jetë i shënuar. Ata të cilët kanë veturë dhe e dinë se nëse vozit tepër dhe të kap radari do të dënohesh, andaj nuk e tejkalon kufirin e shpejtësisë. I njëjti është rasti me regjistrimin që e bëjnë melekët të cilët i regjistrojnë ata të cilët e tejkalojnë vijën e hallallit dhe kalojnë në haram, që e dinë se ata do të dënohen në ahiret. Ndërsa nëse pendohen dhe bëjnë tevbe, Pejgamberi a.s. për të tillët jep sihariq se do të falen (Hakimden naklen, el-Iman bil melaïke, 154). Meleku që është i obliguar të regjistrojë fjalët dhe veprat e njeriut mbi varrin e të vdekurit e falënderon dhe madhëron All-llahun deri në kijamet (Beyhakiden naklen, el-Imanu bil melaïke, s151).

Melekët Munker dhe Nekir janë dy melekë që vijnë për të pyetur një të vdekur që është futur në varr. Këta e pyesin të vdekurin se kush është zoti i tij, cila është feja e tij, cili është libri i tij, kush është pejgamberi i tij (Tefsiri Ibni Kethir, 14/27). Aishja r.a. e cila ishte e brengosur nga pyetjet që bëhen në varr, e pyet Pejgamberin a.s.: “O i dërguar i All-llahut, unë jam një grua e dobët, ç’mund të bëj me këtë rast?”. Pejgamberi a.s. i përgjigjet: “Aata që e besojnë All-llahu i mba një fjalë e sigurt edhe në këtë botë edhe në ahiret”. Ata të cilët besojnë dhe vdesin me këtë besim, në përgjigjen ndaj pyetjeve nuk do të kenë vështirësi. Vendi i atyre që kanë përgjigje të drejta është xhenneti, ndërkaq vendi i atyre që ja-

pin përgjigje të gabuara është xhehennemi (Buhari ve Muslimden naklen, el-Imanu bil melaïke 216).

Melekët Havedha janë melekë që me urdhrin e All-llahut e mbrojnë njeriun prej dëmeve. Njeriun e ndjekin përpara dhe mbrapa dhe me urdhrin e All-llahut e mbrojnë atë (13/11). Në komentimin e këtij ajeti Ibni Kethiri prej Buhariut transmeton këtë hadith të Pejgamberit a.s.: “Ka melekë që u ndjekin ditën dhe natën”.

Besimi në ekzistimin e xhinnëve

Nëse njeriu i cili me logjikën e dhuruar nga mesi i tij i ngushtë, vëzhgon përreth, sikur përpara 300 vjetësh t'i kishin thënë se me miliona njerëz kanë jetuar me një pikë uji që kanë pirë, nuk do të besonte. (?) Për këtë shumë zbulues të mëdhenj në kohën e tyre nuk kanë qenë të pranuar nga shumë njerëz, kurse disa prej tyre janë kuptuar më vonë. Në fakt, ata që zbulojnë nuk krijojnë diç të re, por zbulojnë një gjë që ekziston. Vetëm se, pasi syri dhe zemra e tyre ka qenë ndryshe nga të tjerët, nuk janë kuptuar. Ne të gjithë kemi sy, por radiumin e ka parë syri i Maria Kyrysë (1867-1934). Ne s'e kemi parë, por nëse e ka parë zonja Mari, është e vërtetë dhe e kemi pranuar se "radiumi ekziston".

Nga Kur'ani dhe sunneti mësojmë se xhinnët kanë ekzistuar para njeriut, gjegjësisht para Ademit a.s. (15/27), se nga ata ka edhe meshkuj edhe femra (72/6), se ata na shohin, kurse ne nuk mund t'i shohim (7/27), se ata e dëgjojnë Kur'anin (72/1), se qëllimi kryesor i krijimit të tyre është adhurimi i All-llahut (51/56), se janë të krijuar prej zjarrit (55/15), se prej tyre ka besimtarë dhe jobesimtarë (72/15), se kanë një fuqi të madhe dhe kanë prirje për art (38/37; 27/39; 34/12), se mund t'u paraqiten njerëzve, se njeriut që merret me magji, krahas një lajmi të mirë, i japin edhe 100 lajme të këqija (Mishkatu'l Mesabih, 4594).

A i bëjnë xhinnët dëm mendjes?

Pejgamberi a.s. tregon se shejtani ec nëpër venët e gjakut të njeriut (Buhari, Ahkam, 21; Ebu Davud, Savm 78; Ibni Maxhe, Sijam 65) dhe se mund të depërtojë deri te truri i tij. Çdo ditë duke lexuar suren en-Nas, e përsëritim atë se prej sherrit të xhinnëve

kërkojmë mbështetje tek All-llahu. Ata xhinnë që janë të dëmshëm dhe nuk besojnë, janë sikur njerëzit pabesimtarë. Gjithmonë veprojnë keq ndaj shoqërisë dhe natyrës. Vetëm se, pasi çdo gjë rrjedh sipas asaj që e ka caktuar Zoti, atëherë çka është dëmi i një helmi në trupin e njeriut, i tillë është edhe dëmi i një xhinni në vetë njeriun. Për këtë myslimanët me anë të fjalëve që i kanë mësuar prej Zotit, prej sherrit të shejtanit mbështetem në All-llahun. Ndihmë nuk kërkon prej asnjë fallxhiu apo xhinni. Xhindët më tepër ndikojnë tek ata që frikësohen nga shejtani (Habenneke, El-Akide'uj-Islamije, v. 2, nr.32). Këto krijesa të krijuara prej zjarri, pasi që kanë mundësi të futen në venët e gjakut të njeriut, ashtu sikur rrezet për shërimin e trupit të njeriut, dihet se i bëjnë dëm trupit të njeriut. Ne myslimanët ashtu sikur që besojmë se meleket janë të krijuar prej dritës dhe se njeriut i mësojnë gjëra të mira dhe e mbrojnë prej disa rreziqeve, po ashtu besojmë se edhe shejtani, i cili është i krijuar prej zjarrit, njeriut i jep një dyshim. Po ashtu besojmë se këto krijesa janë edhe shkaktare për shumë të këqija dhe bela.

A mund të merret njohuri prej xhinnëve?

Pasi që xhinnët janë krijesa me vetëdije, e disa janë besimtarë e disa jobesimtarë, e e kanë dëgjuar Pejgamberin a.s., me ata është e mundur të shihesh dhe të bisedosh. Vetëm se gjatë historisë me ata janë marrë fallxhorët dhe xhinxhinjtë, të cilët nuk kanë qenë të pranuar nga ana e dijetarëve islamë. Zoti në Kur'an tregon se shejtani vjen tek ata që janë gënjeshtarë dhe shpifës, të cilët edhe veprojnë sipas fjalës së tij (26/222-223).

Mbrojtja e punës së keqe si e mirë nga ana tiranëve, pabesimtarëve dhe mëkatarëve vjen nga ajo që shejtani atyre ua ka zbukuruar punën e keqe (6/43-137; 27/24). Mendimi i atyre që e djejin trupin e fëmijës së vdekur dhe të njëjtin e llogaritin ceremoni fetare, i atyre që adhurimin e tyre e kryejnë në Tibet dhe si të shenjta e pranojnë edhe atë se “minjtë janë forma e ardhjes përsëri në këtë botë të fëmijëve të vdekur më parë”, i atyre që idhujt i kanë bërë me dorën e tyre, i hyjnyzojnë, i atyre që mendimet e tyre i llo-

garitin mbi të tjerëve dhe të tjerët i detyrojnë në pranimin e tyre dhe i atyre të cilët këtë e bëjnë me një logjikë tinzake. Këto mendime nuk janë gjë tjetër vetëm këshilla apo zbukurime të vetë shejtanit. Kur'ani na tregon se luftën që e bëjnë pabesimtarët ndaj myslimanëve është po ashtu nxitje e shejtanit (6/121).

Më lart thamë se shejtani mund të marrë forma të nduarduar-ta. Nëse disa raste për t'i devijuar myslimanët e pastër, shejtani merr pamjen e ndonjë shejhi. Çdo lider që nuk i përkulet Kur'anit dhe Sunnetit, ngado që të vijë, nuk ka respekt. Pas vdekjes së Pejgamberit a.s. askush më s'e ka parë atë si të gjallë në mesin e njerëzve. Por, ka mundësi që atë ta shohë vetëm në ëndërr. Ajo që shihet në ëndërr nëse është me përputhshmëri me Shemali Sherifin pranohet se është parë Pejgamberi a.s. Pas vdekjes së Pejgamberit a.s. ai nuk i është dukur i gjallë askujt, për këtë edhe një veli (evlija) i vdekur nuk mund të duket si i gjallë, por mund të shihet vetëm në ëndërr. Omeri r.a. i cili është i udhëzuar dhe i përmirësuar me Kur'an, asnjëherë nuk ka vepruar në kundërshtim me urdhërat e Pejgamberit a.s. Edhe pas vdekjes së Pejgamberit a.s., Omeri nuk është pajtuar me mendimin e Ebu Bekrit për luftën kundër atyre që nuk japin zekat. Por më në fund e pranon mendimin e Ebu Bekrit dhe vepron sipas tij.

Xhinnët nuk e dinë gajbin (fshehtësinë). Ata të cilët nëpërmjet xhinnëve lajmërojnë për fshehtësinë, gënjejnë.

Spiritualistët

Me këtë veprim në të kaluarën janë marrë fallxhorët, shtrigat dhe shinxhinjtë (ekzoteristët). Dijetarët islamë e kanë luftuar shumë këtë dukuri. Sot me këtë merren njerëz të specializuar që kanë shëtitur nëpër Evropë, që janë ritur në rajonin Ganxhë dhe që besojnë në jogë. Ata nuk thonë epilepsi, por thonë medium. Nuk thonë shpirt (huddam), por spirit, nuk thonë shpirtëror, por spiritizëm. Ata prapambeturi e quajnë besimin në Pejgamberin a.s. i cili është i dërguar 14 shekuj më parë, kurse përparim e quajnë besimin në jogë, që daton 3 shekuj më parë. Sipas tyre, prapambeturi është të thuhet “All-llah, All-llah, All-llah”, kurse përparim është të thuhet “Shijan, Shijan, Shijan” dhe kështu të kalohet në trans.

Pasi që i kam parë disa nga këta njerëz, e kam kuptuar se në ç’gjendje janë ata pas kontaktit të tyre me shejtanin.

Një njeri i tillë që është përplasur me djallin në vitin 1972 mbante një konferencë për ata që veten e quajnë intelektualë. Aty isha edhe unë. Ai shpjegonte besimin e reinkarnacionit në fetë hinduse dhe thoshte: shpirti pas vdekjes së njeriut kalon në një gjallesë tjetër. Nëse jeta e njeriut ka qenë e mirë, shpirti i tij kthehet në botë me një krijesë më të mirë. Për këtë thotë ai ka dëshmitarë të gjallë. Një fëmijë në Adana tregon për gruan që është i martuar dhe për emrat e fëmijëve të tij. Ne shkuam dhe e morëm atë fëmijë dhe e sollëm pranë gruas për të cilën ai thoshte se është gruaja e tij. Gruan dhe fëmijët u njohën përnjëherë. Fëmija tha se “mua më vranë në kopsht duke më rënë në kokë me sëpatë”, kurse gruan e tij kur e pyetëm se “ku e ke burrin”, ajo tha se para 8 vjetësh e kanë vranë në kopsht duke i rënë me sëpatë në kokë. Ndërkaq, burri i saj kishte vdekur më 8 nëntor 1962. Në anën tjetër mësuam se edhe fëmija ka lindur më 8 nëntor 1962, kështu

që në ditën kur ka vdekur burri i saj ka lindur edhe ky fëmijë. Në këtë rast njëri nga dëgjuesit tha: “Më falni, vetëm se, çdokush e di se shpirti i jepet fëmijës kur ai është 4-muajsh në barkun e nënës. Kështu në momentin kur njeriu ka vdekur, fëmija ka qenë pesë muajsh”. Në këtë moment organizuesi i konferencës u ndal dhe tha se kjo datë duhet të studiohet përsëri dhe kështu edhe konferenca u ndërpre.

Për vërtetimin e besimit në reinkarnacion jepen disa shembuj edhe nga vetë Evropa. Për shembull, një familje që jeton në Paris nisat që pushimin ta kalojë në Marsilia. Pas arritjes atje, vajza e tyre ato vende që më herët nuk i ka parë, i tregon në shtatë programe. Kuptohet se ajo vajzë që ato vende që s’i ka parë më parë, i njeh shumë mirë. Në fund merret vendim se shpirti që gjendet në këtë vajzë më herët ka ekzistuar në një princeshë që ka jetuar atje.

Në fakt ne nuk dimë se këto ngjarje kanë ndodhur apo jo. Edhe kjo ka mundësi të jetë një shpikje, sikur ajo në Adana. E nëse nuk është shpikje, atëherë mund të thuhet se vajza në fjalë ka mundësi që ato vende t’i kishte parë në ëndërr. Një shok që erdhi të më vizitojë në kurs, ku vazhdova 2 vjet, pasi që e përfundon Institutin islam, pasi hyri brenda, pa parë gjë më tregoi për çdo skaj të asaj ndërtese historike. Duke qenë ulur më tregoi për klasat, banjën, kuzhinën, toaletin, kopshtin dhe për mesxhidin e saj. Mirë, si i di këto? Mbrëmë mendova për to, kurse natën që do të vijë tet ti, i pashë në ëndërr.

Disa gjëra që i kam parë në ëndërr tash i shoh. Kjo është e vërtetë. Bile disa njerëz pa shkuar në ndonjë vend thonë: “Unë e njoh këtë vend”, kështu që vendet që s’i ka parë, mundohet t’i përshkruajë.

Vajza nga Parisi atë e ka parë në ëndërr dhe e ka regjistruar (deponuar) në ndërdije. Shumë njerëz që nuk e njohin këtë realitet, mundohen që në emër të shkencës të ringjallin besimin e reinkarnacionit të fesë hinduse 6-mijëvjeçare dhe ta kthejnë rrugën e xhennetit për në xhehennem.

Sido që të jetë, për ëndrrat e mira duhet falënderuar All-llahun dhe ato duhet treguar shokëve, kurse prej ëndrrave të këqija duhet të kërkojmë mbështetje tek All-llahu, duke thënë: Eudhu-besmelen (Buhari, bab-u Ta’biri ruja).

Ëndrra

Ka disa gjëra që i shohim në gjumë, e të cilat më vonë bëhen realitet. Në ëndërr shohim disa vende dhe personalitete të cilat i shohim edhe zgjuar. Për ëndrrat kanë diskutuar edhe pejgamberët, filozofët dhe shkencëtarët.

Ç'është ajo që shihet dhe kush është ai që sheh ëndërr?

Dallimi në mes të ëndrrës së vërtetë dhe ëndrrës jo të vërtetë është sikur dallimi në mes të fjalës së drejtë dhe fjalës së gabuar. Edhe fjala mirë edhe fjala keq, si koncepte gjenden në mendje. Në të vërtetë fjala keq në realitet nuk ekziston. Për këtë pejgamberi a.s. thotë: “Ëndrra e mirë është prej Rahmanit (All-llahut), kurse ëndrra e keqe prej shejtanit” (Buhari, Ta’biri Ruja babi). Po ashtu thotë se ëndrra është tre llojesh: myzhde ose sihariq i Rahmanit, frikë e shejtanit dhe shpikje e epshit. Katër llojet e ëndrrës së Rahmanit dijetarët i kanë shpjeguar kështu: “Këshilla e All-llahut xh.sh. e bërë drejtpërsëdrejti shpirtit të njeriut që fle, e dyta këshilla me anë të melekut të obliguar, takim me shpirtrat e njerëzve të mirë dhe këshillave të tyre, shkuarja e botës shpirtërore të udhëheqësi dhe mësimi i disa ngjarjeve që do të ndodhin (er-Ruh, Ibnu Kajjim). Këshilla e melekut në zemrën e njeriut e dimë se është mashtrim i shejtanit. Pejgamberi a.s. thotë: “Shejtani qarkullon nëpër gjakun e njeriut” (Buhari, Ahkam 21). Ai futet nëpër venët e gjakut sikur rrezet-x që depërtojnë në të. Ai aty fut dyshim dhe njeriun mund ta nxitë në të keqe (Muslim, Zuhd 60). Të dy së bashku do të punojnë për ndikim të njeriut. Sot shumë sëmundje shërohen me rreze. Ndërsa ne, për t’i flakur disa mendime të dëmshme, duhet që me eudhu-besmele të vëmë një perde

mes nesh dhe shejtanit, kurse këshillave të melekëve duhet t'ua hapim zemrat.

Në Kur'an flitet edhe për ëndrrat hyjnore, edhe për ëndrrat satanike (hulm) (12/43-44). Edhe fjala turke ihtilam, me të cilën shprehet mashtrimi i shejtanit natën, rrjedh prej fjalës hulm.

Nëse ëndrrën e komenton Pejgamberi a.s., është e vërtetë, pasi që kjo shpreh dituri, kurse komentimi i të tjerëve për ëndrrën nuk është dituri përfundimtare dhe nuk vlen për argument. Për shembull, pashë në ëndërr se Pejgamberi a.s. urdhëroi që të pimë alkool. Duke u bazuar në këtë nuk mund të pihet alkool. Nëse urdhërohet ndonjë ibadet që nuk është në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunnetin ose një gjë e tillë simbolizohet, atëherë duhet kryer.

Për komentimin e ëndrrës nuk ka ndonjë mësim të posaçëm. Ajo komentohet me një mendjemprehtësi (feraset). Nëse zemra e njeriut është pa njolla, në bazë të disa shenjave diçka mund të kuptojë.

Dallimi në mes ëndrrës dhe së vërtetës është sikur dallimi në mes imagjinatës dhe së vërtetës. Sikur që zjarri imagjinues nuk e djeg që njeriun, edhe pse ai djeg në realitet.

Fjala ta'bir (shpjegim apo komentim i ëndrrës) do të thotë të kalosh-kalimi i ndjenjës prej formës në kuptimin që e shpreh ajo. Njeriu atë që e dëgjon, e formëson në pjesën e trurit për imagjinim. Për shembull, një zë abstrakt që e dëgjojmë nëpërmjet telefonit, e formësojmë menjëherë, sepse e njohim pronarin e zërit. Nëse dëgjojmë ndonjë fjalë që nuk e dimë a ekziston në thelb, për shembull, si fjala "salamandër", përveç si fjalë të ne nuk mund të formësohet diç tjetër. Nëse thuhet "salamandri është një shpezë" menjëherë ia mendojmë krahët ose i vëmë krahë harabeli ose krahë shqiponje. Menjëherë atë e formësojmë në imagjinatën tonë dhe e përdorim si një formë që e kemi marrë më herët në memorjen tonë.

Në ëndërr shpirti ndahet prej trupit, kurse kur njeriu është zgjuar nuk ndodh një gjë e tillë, sepse derisa është zgjuar nevoja është më e madhe. Gjatë fjetjes vazhdon veprimi i gjallërisë, ajo që ne e quajmë anë fizike të njeriut, kurse shpirti shkon te vendi i quajtur alemi emr, atje bëhet dëshmitar i ngjarjeve që do të ndo-

dhin dhe për një moment kthehet dhe ia jep imagjinatës. Imagjinata lajmit që vjen i jep formë në bazë të asaj që ka njohuri. Për shembull, nëse njeriu sheh në *alemi emr* se do të ballafaqohet me armikun, imagjinata atë e formëson në gjarpër ose në qen (Ahse-nu'l-Kasas, Sirri Pasha 1/75).

Ky formësim varet prej gjendjes së atij që sheh ëndërr. Për një edukuesi të gjarpërit, gjarpëri nuk vlerësohet si armik. Në disa raste në ëndërr përsëriten gjërat që janë parë ose dëgjuar gjatë ditës. Kjo është përsëritje e vetë nefsit nga i cili nuk pritet diçka tjetër. Është e mundur që në ëndërr të shihet shpirti i të vdekurve. Vetëm se lajmet që i japin mund të jenë edhe gabim, sepse në formën e tyre mund të futet edhe shejtani. Pejgamberi a.s. thotë se shejtani nuk mund të marrë pamjen e tij. Kështu, ai që në ëndërr e sheh Pejgamberin a.s., e ka parë me të vërtetë atë. “Ëndërra e njeriut të mirë është një pjesë prej 46 pjesëve të pejgamberllëkut” (Buhari, Babu Ta’biri Ruja). Me këtë tregon se disa gjëra mund të dihen edhe para kohës. Gjashtë muajt e parë të 23 vjetëve të pejgamberllëkut të Pejgamberit a.s. kanë qenë në ëndërr. Pra, 6-muajshi është një pjesë prej 46 pjesëve të 23 viteve të pejgamberllëkut. Po ashtu Pejgamberi a.s. thotë: “Ëndërra e besimtarit për afrimin e kohës është e vërtetë” (Buhari, babu Ta’biri Ruja). Qëllimi i afrimit të kohës është stina e vjeshtës, kur nata dhe dita janë të barabarta. Në vjeshtë të gjitha ushqimet piqen. Gjumi është i harmonizuar. Po ashtu është e kuptueshme se nëse trupi dhe shpirti janë të pjekur dhe të përsosur, edhe ëndërrat do të jenë të vërteta. Ëndërra e atij që fle i ngopur tepër, nuk është ëndërr, por është ankth.

Një grup njerëzish, gjatë tërë historisë thonë se e vërteta i ngjan ëndërrës dhe nuk është ekzistencë. Në ëndërr jetojmë, ndërkaq kur zgjohemi nuk ekziston asgjë. Thuhet se atë që e shohim dhe e dëgjojmë është ajo me të cilën jemi kushtëzuar. Në realitet ka gjëra që i shohim dhe nuk janë të kushtëzuara. Për shembull, edhe pse e dimë se gjilpëra shpon, në bazë të saj e kemi kushtëzuar edhe veten, përndryshe ajo nuk dhemb aq shumë. Si përgjigje e pyetjes se a të dhemb gjilpëra kur të shpon papritmas, me siguri është se po, që do të thotë se edhe pa kushtëzim ndjen dhembje.

Besimi në librat e shpallur (kitabët)

Fjala “kitab” rrjedh prej fjalës ketebe dhe ka kuptimin qepje dhe bashkim i dy pjesëve të lëkurës. Edhe shkronjat bashkohen me njëra-tjetrën me anë të lapsit dhe kështu formohet fjala kitab – libër.

Kur themi libri hyjnor, përnjëherë na kujtohet Kur’ani Kerimi për të cilin Zoti në Kur’an në suren Bekare e përmend fjalën “*ja libri*”.

Në suren Nisa, ajeti 136, thuhet: “O ju që besuat, besoni vazhdimisht All-llahun, të dërguarit e Tij, librin që gradualisht ia shpalli të dërguarit të Tij dhe librit që e pat zbritur më parë...”, me të cilën urdhëron besimin në librat e shenjtë. Edhe ne duke u bazuar në Sunnet, çdo mbrëmje lexojmë dy ajetet e fundit të sures Bekare me të cilat përforcojmë besimin në All-llahun, melekët, librat, pejgamberët dhe në ahiret. Ne deklarojmë se përkundër hebrenjve, që nuk besojnë në Inxhil dhe Kur’an, dhe përkundër të krishterëve, që nuk besojnë në Kur’an, ne besojmë në të gjithë pejgamberët e All-llahut dhe në të gjithë librat e shpallur nga ai dhe se ne jemi ata që i bashkojmë të gjithë.

Shpalljet që përmenden në Kur'an:

1. Ibrahimit a.s. i janë zbritur fletushka (suhufe) (Nexhm, 37; A'la, 19).

2. Musait a.s. i është zbritur Teurati (Ali Imran, 45, 3; A'la, 19; Maide, 44, 46, 110; A'rav, 157).

3. Davudit a.s. i është zbritur Zeburi (En Bija, 105; Nisa, 163; Isra, 55).

4. Isait a.s. i është zbritur Inxhili (Ali Imran, 3; Maide, 46, 47-87; Feth, 29; Teube, 111).

Zoti në ajetin 213 të sures Bekare tregon se njerëzit një kohë kanë qenë një ummet (popull), pastaj janë përçarë. Ndërkaq, për të zhdukur kundërshtimin në mes njerëzve, Zoti ka dërguar pejgamberë të cilët kanë dhënë sihariq për xhennetin dhe kanë frikësuar me xhehennem.

Fahreiddin Raziu, Kadi Bejdavi dhe dijetarë të tjerë duke u bazuar në këtë ajet thonë se çdo pejgamberi i është shpallur libër. Kurse Ebu Idriz el-Hulami transmeton prej Ebi Dherr el-Gifariut se Ebu Dherri r.a. ka pyetur: “O i dërguar i All-llahut, sa libra ka dërguar All-llahu? Pejgamberi a.s. përgjigjet: 100 fletushka, edhe atë 10 fletushka Ademit a.s., 50 fletushka Shitit a.s., 30 fletushka Idrisit a.s., 10 fletushka Ibrahimit a.s., Teuratin, Inxhilin, Zeburin dhe Furkanin”. (El-Akidetul Islamijje ve Usesuha, Abdurrahman Habenneke, 2/260).

Qëllimi i shpalljes së librave

All-llahu xh.sh. me mëshirën e tij të gjerë njeriun nuk e lë të vetmuar. Historinë e njerëzimit Ai e ka filluar me një peygamber të cilit i ka dhënë edhe shpallje.

Që njerëzit të mos bien në dorën e kryetarit të shtetit hindus, i cili qytetërim e quan që në shekullin XX të djegë nënën e tij, i cili ka marrë vendim që qytetin ta nxehë duke i djegur të vdekurit, të mos bien në dorën e udhëheqësit amerikan, i cili lejon martesë me krijesa të tjera përveç gruas, e njerëzve të cilët nuk mendojnë për njeriun e uritur dhe të cilët mundësojnë që qeni të bëhet trashëgimtar, Zoti ka dërguar libra dhe peygamberë.

Kurse qëllimi i dërgimit të Teuratit tregohet në këtë formë: “Ne e zbritëm Teuratin, në të cilin është udhëzimi i drejtë dhe drita. Sipas tij gjykuan ndaj atyre që ishin jahudi, peygamberët.” (Maide, 44).

Pra, Teurati është dërguar për të treguar rrugën, për të shndritur anën e brendshme dhe të jashtme të njeriut dhe për të gjykuar sipas urdhrit të All-llahut. Ata të cilët nuk gjykojnë sipas fjalës së Tij llogariten jobesimtarë (Maide, 44).

Kurse për Zeburin tregon se i ka zbritur Davudit a.s. i cili bashkë me shokët e tij duhej të përgatiste sundimin e All-llahut në tokë dhe se udhëheqja në tokë u takon njerëzve të mirë. Për këtë në Kur'an thuhet: “Ne kemi shënuar në Zebur (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Lavhi Mahfudh), e me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë” (Enbija, 105).

Për t'i thënë “*ndal*” ligjeve të parlamentit romak që shtetet e ndryshme i ka shkatërruar, ka derdhur gjak dhe lot, ka shpallur fitore, skllëverit ua ka dhënë luanëve për ushqim dhe që Zoti drejtësinë e Tij t'ua bëjë të ditur të gjithë njerëzve, ua dërgoi Isain a.s. të cilit i dha Inxhilin si gjykues. Zoti thotë: “Që ithtarët e Inxhilit të gjykojnë sipas asaj që Zoti e zbriti në të” e pastaj thotë: “e kush nuk gjykon sipas asaj që zbriti Zoti është gjynahqar” (Maide, 47).

Përkufizimi i Kur'anit

Kur'anin e përkufizon vetë Kur'ani. Pasi që në suren Fatiha bëhet lutja “na trego rrugën e drejtë”, në faqen e 2-të në suren Bekare thuhet: “Ky është libri që në të nuk ka dyshim, është udhëzues për të devotshmit”, dhe lajmëron se është i dërguar për udhëzim.

Njeriut përnjëherë i vjen në mend ajo se Teurati, Zeburi dhe Inxhili janë shformuar, andaj a thua nuk ka mundësi të deformatet edhe Kur'ani? Për këtë Zoti që para 1.400 vjetësh ka garantuar për mos deformimin e tij, “Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij” (Hixhr, 9).

Në një ajet tjetër po ashtu thotë: “Atij nuk mund t'i vishet e pavërteta në asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të Lavdishmit” (Fussilet, 42).

Gjatë historisë ka pasur nga ata që kanë dashur që Kur'anit t'i futin gjëra të devijuara, por All-llahu atë e ka mbrojtur me “*Kurra*” (hafizët e Kur'anit), që janë kalorësit e Kur'anit në tokë.

Kjo është fjala e All-llahut. Por ne si e kuptojmë dhe si e komentojmë këtë?

Zoti Kur'anin e ka dërguar që të kuptohet. Po ashtu të qenët e Muhamedit a.s. prej popullit arab është nga ajo që Kur'ani si fillim i ka zbritur një popull që flet arabisht.

“Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni” (Zuhruf, 3; Jusuf, 2). Gjithashtu tregon se komentimi i ajeteve bëhet nga vetë Kur'ani. “(Ky është) libër”, ajetet e të cilit janë radhitur edhe shkoqitur nga i Dijshmi i të gjitha çështjeve në hollësi” (Hud, 1).

Pasi All-llahu është Ai i cili i ka shpallur të gjitha ajetet, mes tyre nuk mund të ketë kundërshtime (Nisa, 82). Sot, pasi të gjitha ligjet e shteteve botërore janë të përgatitura nga njeriu, kanë kundërshtime në mes veti, po ashtu kundërshtime ka edhe në mes të kushtetutave, ligjeve penale etj.

Situata e vështirë në këtë kohë moderne myslimanët përsëri i ka kthyer te Kur'ani. Ky poshtërim nuk është vetëm në jetën materiale, por edhe në atë kulturore. Kemi filluar që ajetet kuranore t'i komentojmë në bazë të mendimeve tona kontradiktore dhe të çuditshme. Po ashtu një kuptim e rezultojmë me dy kuptime. Për shembull, pas leximit të ajeteve si: "... Obligim ynë ishte të ndihmojmë besimtarët" (Rum, 47); "..All-llahu kurrsesi nuk ju mundëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët" (Nisa, 141) ose ajeti "A tyre nga mesi juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, në vend të frikës Ai do t'u dhurojë siguri..." (Nur, 55) dhe pas shikimit të shteteve të fuqishme dhe vendeve ku popullata është me shumicë myslimane, disa kanë menduar se çështjen do ta zgjidhin duke bërë komentime të përshtatshme të Kur'anit dhe duke thënë se "sot myslimanët nuk jetojnë".

Në ajetet (argumentet) natyrore të Zotit ka një rregull. Për të fituar nga ato ne duhet t'u përshtatemi ligjeve natyrore, kështu që edhe në ligjet legislative të Zotit ka një rregull të cilit duhet përshtatur. Për këtë në Kur'an thuhet: "nëse ju ndihmoni All-llahun, Ai u ndihmon juve" (Muhamed, 7). Në një ajet tjetër po ashtu All-llahu thotë: "Nëse All-llahu dëshiron t'ju ndihmojë, s'ka kush që mund t'ju mposhtë" (Ali Imran, 160).

Ardhja e ndihmës varet prej vullnetit të treguar. Libri në Mir'at-ul usul (16-17) përkufizohet kështu: "Rregull i zbritur Muhamedit, peygamberit tonë".

Në çdo shkencë përkufizimet janë shumë me rëndësi, kështu që çdo ekol, medhheb apo shkollë dallon në bazë të përkufizimeve të saj. Dijetarët e Ehli Sunnetit të cilët Kur'anin e përkufizojnë si rregull me kuptim hyjnor, e pranojnë se edhe fjalët edhe renditja në Kur'an është prej All-llahut. Prandaj kanë thënë se ai që e lexon përkthimin e Kur'anit, nuk lexon Kur'an, sepse përkthimi është ajo që e ka kuptuar përkthyesi. Komentimet janë marrje nga Kur'ani aq sa njerëzit kanë pasur kulturë. Prej ajeteve që tregojnë

se Kur'ani për t'u kuptuar ka zbritur në gjuhën arabe, ka zbritur që të gjykojë në mes të njerëzve, ashtu siç e ka paraqitur All-llahu, e kuptojmë rregullin dhe kuptimin e Kur'anit.

Atë që e kemi dhe e lexojmë quhet "Mushaf". Ai përbëhet prej letrës së prodhuar dhe prej ngjyrës. Fjala popullore se "Kur'ani nuk digjet" është e vërtetë, sepse rregulli dhe kuptimi i tij nuk digjet, porse digjet vetëm Mushafi, sepse është letër dhe ngjyrë. Ata të cilët bëjnë analiza matematikore mbi shkronjat e Mushafit nuk e pranojnë as dijetarët e Ehli Sunnetit as të shiitëve e as të dhahiritëve, sepse Kur'ani si rregull dhe kuptim është hyjnor. Kurse në aspektin e shkrimit, nuk është hyjnor. Për këtë çështje janë shkruar libra dhe kumtesa të shumta. Ashtu si janë shkruar libra për numrin 19, janë shkruar edhe për numrin 14 (Kur'ani Kerim Bilgileri, 70-71), për numrin 7 (114 sure Isimleri dhe Manalari, S. 10-11, Zija Bilgiç), si dhe për numrin 22 (Kur'ani Kerim Bilgileri, 61, Osman Keskinoglu).

Nëse juve nuk ju intereson ana ligjore e veprës dhe nëse keni shumë kohë, merrni numrat 40 dhe 70 që përmenden shpesh në Kur'an dhe diçka mund të gjeni..., vetëm se kjo nuk është e drejtë.

Flamurtarët e Islamit

Ata të cilët në historinë e njerëzimit, prej Ademit a.s., kanë vazhduar të ecin në rrugën e peygamberëve me nder dhe me autoritet e kanë bartur flamurin islam. Ata të cilët nuk kanë qenë të denjë të bartin flamurin islam kanë përjetuar një kolonizim kulturor dhe në trurët e tyre e kanë ngulitur flamurin e mosbesimit.

Zemra është qendra e dashurisë, e cila është vendi më me vlerë i njeriut dhe e cila nuk mund të okupohet me armë, top ose me bajonetë. Peygamberi a.s. për hafizët të cilët zemrën e tyre ia kanë hapur fjalës së All-llahut jep sihariq pozitën më të lartë: “Ata të cilët Kur’anin e bartin në zemrat e tyre, në fakt ata e bartin flamurin e Islamit” (et-Tergib ve te’t-hip 2/345).

Kurse zemra e atij që nuk ka vend për fjalën e All-llahut i përngjan “shtëpisë së prishur” (et-Tibjan fi adabi hamaleti’l-Kur’an, Nevevi 26). Në vendet e shkatërruara dhe të rrënuara rriten kullo-sa të dëmshme që e hanë vetëm gomarët e zgjebosur. Aty jetojnë gjarpërinj dhe akrepë, kështu që edhe gjendja shpirtërore e njeriut i cili me vjershat, romanet apo me tregimet e tij mundohet ta përhapë amoralitetin, është e rrënuar sikur kullosat e egra, ku ka ferra dhe akrepi ku nxjerr helm.

Falënderimi i takon All-llahut që zemrat e numrit të madh të njerëzve i ka stolitur me suren Fatiha dhe me Ihlas. Kurse ne me fjalë blasfemie dhe me sjellje të këqija pozicionohemi me të njëjtin kundërshtim. Prej kësaj duhet të mbrohemi dhe mbi fjalën e All-llahut nuk duhet të pranojmë fjalë tjetër.

Ata që janë kokëlartë dhe ballëlartë (krenarë)

Qetësia e njerëzve në shoqëri është në bazë të njohurive dhe të përvojës së tyre. Ata të cilët janë të sigurt në vërtetësinë e asaj që kanë mësuar, janë të rehatshëm. Ata të cilët sjelljet e tyre i përcaktojnë sipas rregullave njerëzore islame, pranë njerëzve që nuk janë me sy dhe me zemër të verbër, pranohen si të mirë. Për këtë, Omeri r.a. për ata që lexojnë Kur'an, i cili u mëson të vërtetën mbi ligjin më të përsosur dhe lajmet më të drejta dhe me vlerë, thotë: “O ju që lexoni Kur'anin, kokën mbajeni lart, rruga juaj është e drejtë. Garoni në të mirë në këtë rrugë. Mos ua shtrini dorën njerëzve” (et-Tibjan fi adabi hameleti'l-Kur'an 26). Me këtë ai urdhëron që koka të mbahet lart, kurse njerëzve sikur ne të mos u shtrihet dora, të mos u hapen mendimet dhe zemrat për ndonjë vendim. Zoti në Kur'an na përkufizon sikur sahabet fisnikë: “ata që janë me të janë të ashpër kundër pabesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vetes..” (48/29). Kurse Pejgamberi a.s. thotë: “Lexoni Kur'an, pasi që All-llahu zemrën e atij që lexon Kur'an nuk e dënon” (et-Tibjan fi adabi Hameleti'l-Kur'an 10). Myslimanët duhet të pranojnë që me Kur'an të mbushin zemrën e tyre me të cilën do të shpëtojnë edhe prej problemeve të kësaj bote, edhe prej dënimit në ahiret. Ata të cilët për udhëzues të tyre në jetë, në çdo marrëdhënie sociale dhe ndërkombëtare e marrin Kur'anin, All-llahu gjithmonë i lartëson. Kurse ata që largohen nga ai, në këtë botë i poshtëron, ndërsa në ahiret lajmëron se do t'i ringjallë të verbër (20/124).

Emrat e Kur'ani Kerimit

Fahreddin Raziu në tefsirin e tij (Tefsiri Kebir, 2/116, 117, 118) tregon se Kur'ani ka 32 emra të cilët i përmend duke sjellë argumente nga vetë Kur'ani. Ne do të mundohemi t'i shpjegojmë vetëm disa nga ata (emra).

Kur'an është emri më i njohur. Quhet Kur'an pasi në vete ngërthen sure dhe ajete, njohuri për të kaluarën dhe për të ardhmen, për të njomën dhe të thatën. Atë e lexojnë nuset me vel, ata që kanë mendje të freskët, kryetarët e shteteve, punëtorët, gra, meshkuj, femra, me një fjalë, pasi çdokush e lexon, ai quhet Kur'an.

Furkan quhet zbritja e ajeteve dhe sureve për 23 vjet ajet pas ajeti e sure pas sure. Në vendin ku zbritur ai ka ndarë të drejtën nga jo e drejta, besimin nga pabesia, drejtësinë nga zullumi.

Sirat'ul-Mustekim: quhet kështu pasi ata që i mbështeten atij janë në rrugën e vërtetë. Në botë shkohet drejt formimit të shtetit, kurse në ahiret drejt xhennetit. Pejgamberi një ditë mbi rërë vizaton një vijë, pastaj në anët anësore të vijës vizaton dy vija në anën e djathtë dhe dy vija në anën e majtë, kurse në fund dorën e vë në vijën e mesme dhe lexon ajetin vijues: "udhërefyes e mëshirë, ashtu që të besojnë se do të takohen me Zotin e tyre" (6/154). Me këtë Pejgamberi a.s. ua ka tërhequr vërejtjen njerëzve të cilët nga ana e shejtanit kanë qenë të devijuar majtas dhe djathtas dhe i ka urdhëruar ata të shkojnë në rrugën e vërtetë të Islamit.

Besar: quhet përcaktimi i Allahut në vëzhgimin tonë ndaj njeriut dhe natyrës, Ai nga bota na çon të shohim ahiretin, na e tregon autoritetin mbas perdes së kaderit, prandaj edhe quhet Besar. Kur një myslimani t'i thuhet "sa zog i vogël është bilbili", kuptohet se ai mysliman e madhëron Zotin e tij kur sheh bilbilin që nga gjoksi i vogël i tij dalin muzikalitete më të këndshme të botës. Kurse jobesimtari kur thuhet se "sa zog i mirë është bilbili", pyet sesa kilogram mish ka ai. Macja bilbilin e sheh si një kafshatë mi-shi, edhe lopa lulen e sheh si një turmë kullose.

Besimi në peygamberët

Zoti ynë, që është Rrahman dhe Rrahim, me mëshirën e Tij historinë e njerëzimit e ka filluar me peygamberin e parë, Ademin a.s., një peygamber që kishte gjuhën, shkrimin, librin, gruan e tij.

Shpirti, i cili gjithmonë dëshiron të mirën, të bukurën dhe hallallin, njeriun që është furnizuar me epsh, që gjithmonë dëshiron të keqen, haramin dhe disfatën, edhe botën e brendshme të njeriut e bën edhe më të gjerë se fushat e betejave.

Në fuqinë rrënuese të epshit nuk mund të arrijë as Shejtani, as Neroni e as Xhengizi. Madje edhe Shejtani përpara epshit qëndron duar lidhur. Ushtritë luftojnë vetëm në fushëbetejë dhe mbeten jashtë shtëpive (vendbanimeve), kurse epshi shëtit me ne nëpër çarshi, në vendin e punës, me sy tradhëtari kërkon gjahun e tij, kur është në xhami gjithmonë mendon jashtë xhamisë, kurse në dyshekun e tij ëndërron me mijëra të zhveshura.

Për epshin nuk përdoret as topi, as arma, as bajoneta. Ai nuk hidhet sikur këmisha e as imani nuk mbillet sikur fara e lules. Për këtë Zoti thotë: "Në fe nuk ka dhunë" (2/256).

Trupi është krijuar prej dheu, prandaj e gjithë ajo që hahet dhe pihet është prej dheu. Shpirti vjen prej Zotit, prandaj ushqimi i tij nuk vjen prej tokës. Ushqimi i tij me anë të peygamberëve është i dërguar nga ana e Zotit.

Për këtë Zoti historinë e njerëzimit nuk e ka filluar me një mjek, por me një peygamber. Njeriu kur sëmuret ka nevojë për mjek, kurse për peygamberin ka nevojë gjithmonë.

Njeriu i sotëm këtë e ndjen edhe më tepër. Vetëm se, sikur një i sëmurë fizikisht, të cilit i parapëlqehet ushqimi më i tepërt,

porse ai nuk pranon, i njëjtë është rasti me atë që nuk e pranon Pejgamberin e në anën tjetër vuan nga një sëmundje kulturore.

Gjatë historisë, prej Ademit a.s. e deri te Muhamedi a.s., janë dërguar mijëra pejgamberë, numri i të cilëve nuk dihet.

Zoti lajmëron se: “Ne dërguam në çdo popull të dërguar...” (Nahl, 36; R’ad, 7). Sipas asaj që kuptojmë nga këto ajete, kudo që të jetë aty ku ka ekzistuar shoqëria njerëzore janë dërguar pejgamberë ose të dërguar të pejgamberëve.

Për shoqëritë që sot jetojnë një jetë primitive dhe për shoqëritë që njihen si më të qytetëruara, në bazë të studimeve të bëra për to, janë zbuluar shumë anë që llogariten të njëjta për të dyja palët. Nga kjo kuptohet se burimi i njerëzve është i njëjtë, kurse gjatë kohës, mes tyre kanë ndodhur ndarje dhe përçarje.

Pejgamberët i qytetëruan njerëzit edhe më të egër, kurse njerëzit që i varrosnin vajzat e gjalla i kanë sjellë në gjendje që ata të zemërohen bile edhe për thyerjen e këmbës së një kafshe.

Specifikat e përbashkëta të pejgamberëve

1. Ata njerëzit i kanë shpëtuar nga adhurimi i njeriut dhe u kanë mundësuar që ta gjejnë lirinë e adhurimit tek All-llahu (En-bija, 21/25).

2. Ata i kanë mësuar njerëzit sesi luftohet ai që pengon lirinë e adhurimit dhe që shoqërohet me shejtanin, i cili njerëzit i detyron të adhurojnë njeriun (4/60, 76; Nahl, 36).

3. Ata nuk bisedojnë për urdhrat, ndalesat dhe lajmet e tyre, por komunikojnë me urdhrat, ndalesat dhe lajmet e All-llahut (Nexhm, 2; Junus, 15).

4. Ata nuk kërkojnë pagë nga njerëzit si kundërvlerë pejgamberllëku, kryetar shteti, komandanti, gjykatësi, mjeku apo të detyrave të tjera (Hud, 51).

5. Atë urdhër apo ndalesë që e propagandojnë ata, ata së pari e praktikojnë vetë dhe bëhen shembull për të (Ahzab, 21).

6. Ata i sihariqojnë ata të cilët janë me drejtësinë e All-llahut dhe në tokë pastrojnë dhunën. Ata pra në këtë botë sihariqohen me shtet, kurse në ahiret me xhennet (Nur, 55; Teube, 72).

7. Ata i largojnë njerëzit prej adhurimit të diçkaje tjetër, përveç All-llahut (16/36), prej alkoolit (5/90), prej bixhozit (5/90), prej zinasë (17/32), prej rrenës (22/30), prej fitnes (6/137), prej turbullirave (5/64), prej kundërshtimit të All-llahut (3/36) prej sjelljeve të ndryshme që largojnë prej xhennetit dhe çojnë në xhennem.

Nevoja e njerëzve për pejgamber

Ata të cilët thonë: “Unë sot nuk kam nevojë për pejgamber dhe për mësimet e tij”, dhe ata të cilët besojnë se jetën mund ta rregullojnë vetëm sipas mendjes së tyre, le ta dinë se gjërat të cilat i pranojnë si të mira, të bukura, se i kanë gjetur me anë të mendjes së tyre, s’janë asgjë tjetër veçse ndikim i fjalëve, sjelljeve dhe traditave të pejgamberëve.

Asnjë mohues në sjelljet dhe fjalët e tij nuk ka mundësi që qind për qind të largohet prej mësimëve të pejgamberëve.

Sot ata që thonë: “Unë jam ateist”, edhe nëse dëshirojnë që fëmijët e tyre qind për qind t’i largojnë prej udhëzimeve të pejgamberit, edhe sikur çdo fëmijë që lind ta mbajë në një vilë të ndarë, po edhe sikur t’i japë mësimet speciale, t’ia ndalojë që të komunikojë me njerëz të tjerë, nuk ka mundësi që ta largojë prej saj, pasi çdo njeri sadopak ka njohuri për pejgamberin dhe kjo njohuri në këtë mënyrë arrin deri te fëmija.

Një dijetar i njohur perëndimor thotë: “Kush e zbuloi nuk e di, vetëm se, sipas meje, në botë zbulim më i madh është selami”

Selami, që është një lidhje dashurie e padukshme mes zemrave, është prej këshillave të pejgamberëve (Buhari, Iman 20). Edhe nderi ndaj të rriturve, dashuria ndaj më të vegjëlve (Tirmidhi, Birr 15), ndihma ndaj të shtypurve, pengimi i dhunës (Buhari, Medhalim 4), ngopja e të uriturve dhe nxitja e të ngopurit për të ushqyer të nevojshmit janë këshilla të pejgamberëve. Edhe atë që thonë “unë nuk besoj në pejgamber”, në realitet ata i praktikojnë këshillat e pejgamberëve.

Ata që thonë “mendja mjafton për çdo gjë” janë ata tibetas që larashëve u dhurojnë kufomat e shenjtorëve, të cilët e hanë mi-

shin pasi e ndajnë nga eshtrat. Ata që po ashtue hanë mishin e fëmijëve, llogariten kanibalistë, kurse ata që thonë "njerëzit më të përshtatshëm të shoqërisë janë homoseksualët, ndërsa ata që nuk veprojnë në këtë formë duhet shëruar", a thua pretendojnë se mendja nuk ekziston?

Shumica nga këta me gjuhë dhe me zemër janë pabesimtarë, kurse me sjellje mysliman. Këta nuk bëjnë marrëdhënie intime me vajzat e tyre, pasi mbi ta ka ndikuar feja. Edhe sikur këta të thonë se "mendja këtë nuk e pëlqen", kjo gjë është rezultat i shikimit nga këndi fetar.

Një mendje e cila është larg ndikimit të këshillave të peygamberëve për gruan, që nuk bën dallim mes vajzës së tij dhe vajzave të tjera, ai ka mundësi të martohet edhe me vajzën e vet, sikur që një kohë në Iran vepronte Mazdeku.

Njerëzimi ka nevojë për peygamberllëkun që neve na mëson çdo gjë, prej prerjes së thonjve e deri tek administrimi shtetëror. Edhe ata që thonë "Unë nuk kam nevojë", sikur njerëzit që janë të sëmurë nga dobësia dhe që janë larguar nga ushqimet e ndryshme edhe nga kultura perëndimore e lindore, janë dobësuar dhe kanë hequr dorë prej ushqimit shpirtëror, prandaj e kanë sëmundjen e shakllabanit. Atyre u duhet një mjek i mëshirshëm që t'u afrohet për t'i shëruar.

Cilësitë e peygamberëve

1. Sidk: Të qenët e vërtetë edhe fjala edhe thelbi. Peygamberët në jetën e tyre askujt s'i kanë thënë gënjeshtër. Edhe Ibrahim i a.s. kur ka thënë për gruan e tij se "kjo është motra ime" (Buhari, Enbija 8), nuk e ka nëpërkëmbur të drejtën, sepse gruaja e tij ishte motra e tij në fe.

Dyftyrëshit, të cilët dallojnë në brendi dhe në dukje, në këto sjellje janë të padukshëm. Vetëm se, në fytyrat e tyre njëherë u paraqitet shkëlqimi që tregon unin e tyre të vërtetë.

2. Emanet është personi të cilit i besohet, i cili mbron fjalën dhe pasurinë dhe nuk tradhëton. Ata sidomos ndaj fjalës së Allahut janë të besueshëm. Ata fjalën e bartin në origjinal, pa i shtuar apo pakësuar ndonjë shkronjë.

Ata i kanë zbatuar marrëveshjet ndërshtetërore. Madje edhe kundërshtarët më të mëdhenj e kanë vërtetuar drejtësinë dhe besueshmërinë e tyre.

3. Fetanet quhet talenti dhe zgjuarësia fantastike pejgamberëve. Ata i kanë njohur njerëzit, të cilëve ua kanë shpjeguar fenë në nivelin e të kuptuarit të tyre. Fuqinë dhe armët e njerëzve luftëtarë si dhe strukturën e tyre i kanë njohur mirë, i kanë vlerësuar dhe i kanë udhëhequr mirë. Argumentet e paditësit dhe të të paditurit i kanë vlerësuar mirë dhe kanë gjykuar sipas Kur'anit. Ai me letrat që ua ka dërguar kryetarëve të shteteve, duke pasur parasysh besimin e tyre të gabuar, ka përdorur metodë magjepsje dhe simpatike. Për nxënien përmendsh të fjalës më të mirë të Allahut, për të mos e harruar atë dhe për t'ua kumtuar atë shokëve të tij, duhet një mendje e shëndoshë.

4. Ismet quhet mbrojtja e pejgamberëve prej mëkateve nga All-llahu. Ata urdhrat dhe ndalesat që kanë ardhur prej Zotit së pari i kanë praktikuar vetë dhe, kështu që, nuk mund të paramendohet që të mos dëgjohet dhe të praktikohet fjala dhe porosia e pejgamberëve.

Ata kanë qenë shembull më i bukur në fjalë dhe në sjellje. Shembulli më i mirë është qëndrimi i tyre larg mëkateve. Në histori ka njerëz që dëshmojnë për këtë. Dobësitë e njeriut të mençur janë sjellje që nuk i ngjajnë mençurisë së tyre.

Pejgamberët kanë qenë të mbrojtur prej Zotit dhe kështu kanë qëndruar larg mëkateve të mëdha. Sipas shumicës së dijetarëve, pejgamberët edhe para pejgamberllëkut kanë qenë të mbrojtur prej mëkateve të mëdha.

5. Teblig quhet detyra e tyre për bartjen e lajmeve si: farzet, hallallet dhe porositë e All-llahut njerëzve pa të meta pa tepëricë. Pra kështu quhet propagandimi i fjalëve pa i shtrembëruar dhe pa ua përshtatur njerëzve.

Dallimi mes resulit dhe nebiut

Fjala **nebi** rrjedh prej fjalës *ne-be-e* ose *nebve* dhe ka kuptimin lajmëtar ose lartësues.

Në aspektin terminologjik e ka kuptimin e njeriut i cili me anë të shpalljes është zgjedhur në mesin e njerëzve të krijuar nga All-llahu. Kurse **resul** është njeriu i dërguar për t'ua treguar njerëzve sheriatin.

Çdo resul është nebi, kurse çdo nebi nuk është resul.

Besimi në ahiret

Në shumë ajete të Kur'anit pas besimit në All-llahun përmendet edhe besimi në ahiret. Pejgamberët dhe librat e shpallur tregojnë për vdekjen e njerëzve dhe se pas vdekjes ata do të ringjallen dhe do të japin llogari. Derisa njeriu është në jetë duhet vepëruar sipas urdhrave dhe ndalesave të Krijuesit.

Pasi askush nuk vjen dhe askush nuk shkon edhe kur mungojnë lajmet për të, mund të jetë shkak që disa njerëz të mohojnë ahiretin, kurse disa të tjerë të mos e besojnë atë plotësisht, por as ta mohojnë plotësisht.

Zoti, për të penguar këto devijime dhe për të mundësuar që njerëzit të besojnë ashtu si ka besuar njeriu i parë, Ademi a.s., për çdo popull ka dërguar edhe pejgamberë të tjerë.

Parimet e besimit janë të njëjta te të gjithë pejgamberët. Ekzistimi i besimit në ahiret te të gjitha fetë është argument se të gjithë njerëzit prej Ademit a.s. besojnë në Zot.

Madje edhe në shoqëritë, të cilat qëndrojnë larg urdhrave të pejgamberit a.s. dhe i hyjnizojnë parimet e tyre, shihet ndikimi sadopak i traditës pejgamberike.

Besimi në ahiret është domosdoshmëri e besimit në Kur'an dhe në Sunnet, që janë argumente tradicionale të dorës së parë. Vetëm se, kur Kur'ani na urdhëron për besim në ahiret, nuk mjaftohet vetëm me argumentet tradicionale, por ai na përmend edhe argumente logjike.

Sipas asaj që na lajmërohet në ajetin 78 të sures Jasin, një mushrik mekas e sjell një asht të kalbur dhe pyet: "Kush do ta ringjall këtë?". Si përgjigje Pejgamberi a.s. ia përkujton ajetin 79 të

së njëjtës sure: “Atë do ta ringjallë Ai që e ka krijuar atë për së pari herë”.

Sot një pabesimtar pyet: “Nëse një njeri bie në det dhe atë e gëlltit balena, kurse balenën e kap peshkatari, prej mishit të së cilës hanë 1000 persona dhe nëse prej atyre personave njëri vdes në Evropë e tjetri në Azi, njëri digjet në zjarr e tjetri mbytet në ujë, njëri bëhet dhé e dheu bëhet kullosë, kurse kullosën e ha lopa dhe ajo shndërrohet në mish, atëherë si do ta ringjallë këtë All-llahu?”

Në fakt kjo pyetje është pak më e zgjeruar nga ajo që pyet një mushrik në Meke, por në thelb është e njëjtë.

Këtij i përgjigjem kështu: ”Ti tregom për ndarjen kurse unë do të tregoj për tubimin e tyre!” Më pastaj vazhdova. “Ti nuk ke ekzistuar ku babai dhe nëna jote janë martuar, e kur ti ke filluar të krijohesh ke qenë një materie shumë e vogël. Aty pasi qëndrove 9 muaj dole në dynja. Pas lindjes ti do të kesh 70-80 kg duke ngrënë dyner të Adanas, yndyrë, grurin e Konjës, pjeshkët e Bursës duke pasur parasysh dritën dhe rrezet e diellit dhe erërat pajros dhe lodos. Nëse fillojmë të tregojmë, atëherë çfarë duhet thënë për krijimin e patateve, cila prej se dhe si është krijuar. Shumë gjëra duke u nisur prej Japonisë e deri në Amerikë, u tubuan në ty dhe ti u krijove. Ai i cili ty të bëri në këtë gjendje, veç shkatërrimit tënd, po ai do të ringjallë.

Madje njeriu i cili nuk ka mundësi të sundojë edhe mbi një kapak të syrit. Nëse ai ka mundësi që nëpërmjet televizorit të grumbullojë ngjyra të ndryshme të natyrës, Krijuesi i njeriut, i ajrit, i tokës dhe i tërë kozmosit, një grumbullim ringjalljeje të tillë mund ta bëjë shumë më lehtë.

Ata të cilët thonë: ”Nuk ka tjetër, vetëm kjo jeta jonë në këtë botë, dhe ne nuk do të ringjallemi“ (En`am, 29; Mu`minun, 39; Xhathije, 24). Pranverën e mohojnë pasi nuk e kanë parë sikur që nuk i kanë parë insektet, kurse dimri ka edhe pranverë.

Sikur të ketë mundësi fëmijës në barkun e nënës t'i thuhej “Jashtë vendit ku gjendesh ti ka një botë më të gjërë”, ai mund të mohojë. Ata lindin dhe kur arrijnë moshën e përgejgjësisë, nga pejgamberët apo nga librat e shpallura u thuhet: ”shpejtoni në

xhennetin gjërësia e të cilit është sa toka dhe qielli” (3/183). “E dihet se jeta e botës tjetër është më e dobishme dhe e përjetshme” (87/17). Ata që kanë mendje insekti thonë se a mund të ketë vend më të gjerë se kjo botë dhe ky qiell. Kështu ata nuk bien në gjendjen e fëmijës në barkun e nënës, por edhe më poshtë, pasi fëmijët janë pa mëkate.

Kurse një pjesë tjetër thonë: ”A ka ndonjë që ka shkuar dhe është kthyer prej ahiretit”. A thua, sikur të ishte kthyer dikush prej ahiretit do të besonin ata? Pejgamberi a.s. kur u kthye prej Mi’raxhit, lajmëroi për xhennetlinjtë dhe për xhehennemlinjtë, por vetëm ata që ishin me Ebu Xhehlin nuk i besuan. Për Zotin nuk është vështirë të ringjallë të vdekurin vetëm se kjo nuk është mirë me Sunnetullah. Sikur që hyrja e mohuesit në barkun e nënës është në kundërshtim me rregullat natyrore që i ka vënë Zoti, ashtu edhe kthimi i të vdekurit është në kundërshtim. Gjatë historisë ka pasur që janë rringjallur, por ajo është bërë në bazë të mu’xhizes. (2/259; 2/73).

Farat që në pranverë linden, verës e jetojnë rininë e tyre, në vjeshtë mbështillen me qefinin e gjetheve dhe në fund varrosen në tokë, në stinën e pranverës ringjallen dhe gjelbërimi i tyre na përkujon surin e Israfilit, gjëra këto që për ne janë argumente natyrore që na tregojnë për ahiretin.

Varri

Pejgamberi a.s. thotë: ”Vendqëndrimi i parë i mysafirëve të ahiretit është varri” (Musnedi Ahmed. 1/63; Tirmidhiu Zuhd, 5. hadis 2309; Ibn Maxhe, Zuhd. Hadis. 4267) dhe “Varri është ose një kopsht xhenneti ose një humnerë xhehennemi” (Tirmidhiu, Kijame, 27, hadis 2462).

Njeriu deri në kijamet qëndron në varr, e pastaj me surin e Israfilit “ngrihet nga varri dhe shpejton drejt Zotit të Tij” (36/51).

Ata, të cilët në varret e hapura nuk kanë mundur të gjejnë gjë, mohuan dënimin dhe shpërblimin në varr. Ata thonë se në një varr mund të varrosen disa persona, dhe atë njëri xhennetli e tjetri xhehennemli. Varri mund të jetë kopsht xhenneti ose humnerë xhehennemi. Nëse pranë të vdekurit vënë një mikrofon a mund t'i incizojnë fjalët e Munkerit dhe Nekirit? U provua por nuk u incizua. Dijetarët e kohës sonë u përgjigjën kështu: "Burri dhe grua, që flejnë në një krevat njëri sheh ëndërr duke shëtitur nëpër kopshte të bukura e tjetri ik prej një errësire të çuditshme. Ndërsa asnjëri nuk di gjë për tjetrin. Njëri në ëndërrën e tij digjet, kurse tjetri ngrin, kurse për njëri-tjetrin nuk dinë asgjë."

Njëri në ëndërr lexon Kur'an ose këndon këngë, kurse njëri i zgjuar pranë tij nuk e dëgjon. Të gjitha këto na tregojnë se në varr ka mundësi që të gjithë këto gjëra të ndodhin e ne të mos dijmë asgjë.

Një mijë njerëz të shpërndarë me fishkëllimën e policit të parë, me fishkëllimin e policit të dytë tubohen. Kështu edhe me surin e Israfilin njerëzit ngrihen nga varret e tyre dhe vijnë në vendin e mahsherit.

Çdo sjellje e njeriut do të dalë në shesh (17/13). Sipas punës, disave libri do t'u jepet në të djathtë, e disave në të majtë, e disave nga mbrapa (84/7-10; 69/25), do të maten punët e mira dhe të këqija (A'raf, 8-9). Nëse është pabesimtar (kafir) do të shkojë në xhehennem. Nëse është besimtar mëkatar, nëse falet nga Zoti, shkon drejt në xhennet, e nëse nuk falet shkon në xhehennem për aq sa ka gabuar.

Sirati

Mbi xhehennem ka një "urë që rrëshqet, që është më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se shpata" kjo urë për pabesimtarët është shumë e vështirë, kurse besimtarët do ta kalojnë si vetëtima,

si era ose si shpeza. (Muslim. Iman. 80, hadis 302; Musned-u Ahmed, 6/110).

Junus Emre thotë:

“Sirati është më i hollë se qimja

Është më i mprehtë se shpata

Mbi atë sirat

Kisha dashur të bëj shtëpi”. Por, për besimtarin nuk do të jetë i hollë dhe i mprehtë.

Njeriu rrugën e ahiretit duhet ta shndritë dhe ta zgjerojë që në këtë botë. Bamirësinë dhe hajratin nuk duhet t`ia lërë fëmijës që ai të veprojë për të. Babai duke shkuar në xhami për namazin e jacisë, djalit që mban llambën mbrapa i thotë: ”Biri im pse nuk bën dritë edhe përpara”, kurse djali i përgjigjet ”Baba drita që vjen nga mbrapa është e këtille”. Ju dritën tuaj ndizeni vetë, ajo që do të vijë pas, përsëri le të vijë.

Besimi në kader

Nëse sytë tanë i kthejmë drejt qiellit do të shohim formë të shenjave me dritë. Shndërrimi i Hënës pas pesëmbëdhjetë ditëve në Hënë të plotë dhe pas pesëmbëdhjetës tjetër, e kundërta, është kader.

Nëse sytë i kthejmë kah vetvetja jonë, do të shohim se në një ujë me madhësi sa një e pesë milionta e spermës është shkruar kaderi i duarve, i thonjve, i ngjyrave të syve, i numrit të flokëve, i vijave të gishtave dhe i karakterit tonë.

Kurse Zoti ynë thotë:

”Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar” (54/49).

Ky është ligj që Zoti e ka vënë në natyrë. Zoti për Hënë ka caktuar një orbitë dhe ajo ecë në atë arbitë pa u habitur. Format e Hënës, zënia e saj, janë kada dhe kader.

Çelja e lules, shndërrimi i saj në degë, lule dhe në fruta, janë nënshtrim i ligjit natyror të Zotit. Pra kaderi është ai ligji i Zotit.

Shndërrimi i një sperme në një person shtatëdhjetë kilogramësh dhe të qenët e çdo gjymtyre një vepër e veçantë artistike, përsëri është një renditje për rreth ligjit të Zotit.

Ne me gjendjen tonë jemi gjergjef. Zoti ynë zbukurimin e Tij e punon si do Ai. Për shkak të keqkuptimit tonë, kaderi sot kuptohet si gjendja e një hammalli, i cili mbi vete bart fatëkeqësi, krime, tradhëti, burimin e amoralitetit, vështirësitë njerëzore.

Ngjarjet natyrore, gjaku ynë, rrahja e zemrës sonë, lindja, plakja dhe vdekja, lindin nga dituria absolute e Zotit. Në këtë rast ne jemi sikur një njeri që udhëton me anije, ose si një milingonë mbi gurë të mullirit. Jemi të detyruar të veprojmë sipas anijes apo

sipas rrotës së gurit të mullirit. Vetëm se, brenda në anije jemi të lirë të veprojmë sipas vullnetit tonë.

Njeriu në anije duhet të qëndrojë në kabinën e tij, e nëse dëshiron të vendoset në kabinën e tjetrit, nëse dëshiron të flejë me një grua të huaj apo nëse dëshiron të harxhojë paranë e huaj, atëherë bën keqpërdorimin e lirisë së tij në anije.

Nëse botën e pranojmë si një mjet për fluturim në hapësirë, kurse njeriun si udhëtar të përkohshëm, kaderi i botës është të rrotullohet edhe rreth vetes edhe rreth diellit, për katër stinë të arrijë në stacione të ndryshme dhe njeriun ta ushqejë me dhunti të ndryshme. Ne nuk mund ta kalojmë këtë kodër dhe ta ndërrojmë rrjedhën e botës. Vetëm në të, brenda kufijve të jetës sonë mund të lëvizim si të duam.

Sjelljet e mira apo të këqija janë kaderi ynë. Këtë kader ne e kemi dashur dhe kështu e ka krijuar Zoti ynë. Vetëm se Zoti nuk krijon çdo gjë që ne e kërkojmë. Sikur Zoti të krijonte çdo gjë që ne e dëshirojmë, atëherë në tokë nuk do të kishte njeri.

Zoti në Kur'an thotë:

”Çfarëdo e keqe që mund t’iu godasë, ajo është pasojë e veprove tuaja (të këqija), e për shumë të tjera Ai u fal” (42/30).

Zoti na mbroftë. Kjo nuk është kështu se Zoti e ka shkruar ashtu.

Mirë çfarë do të thotë kader i shkruar?

Ky shkrim nuk është as alfabet arab, as latin e as kinez. Pastaj në ballin e askujt nuk shkruan asgjë.

Shohim se nga kjo farë (bërthamë) dalin qindra degë, mijëra lule dhe fruta, por ato në bërthamë nuk i shohim, kështu para nuk e shohim kaderin e njeriut. Ajo që Allahu disave na tregon më herët për kaderin e tij, është një përjashtim.

Fati në librat e akaidit është formuluar me këtë fjali: ”Dituria i nënshtrohet të diturës”.

Dituria e Allahut është e përhershme pa fillim dhe pa mbarim. Për Atë nuk ka kohë, prandaj për Atë nuk ekziston as e djeshmja, as e sotmja e as e nesërmeja.

Dituria jonë bazohet në kohën e kaluar dhe të tashme. Dituria jonë e sotme është më e madhe nga ajo e para 5000 vjetëve, sepse ne jetojmë në këtë kohë. Kurse për fatin këto kohë nuk ekzistojnë, prandaj Zoti si na njih neve, ashtu e di edhe të kaluarën dhe të ardhmen tonë. Kjo i ngjan asaj se ne atë që e kemi para nesh e shohim mirë, kurse atë që e kemi 10 km përpara e shohim më dobët, ndërsa anën e brendshme tonën nuk e shohim fare. Njëri që shikon prej aeroplani na sheh edhe neve, edhe anën para nesh edhe prapa nesh.

Kështu Zoti ynë, që është krijuesi i botës dhe i vendit, është larg përshkrimit të Atij vendi dhe kohe.

Se çfarë do të bëjë njeriu në kohë dhe hapësirë, ka treguar Zoti, kurse melekët e kanë shkruar. Ne nuk veprojmë ashtu se Zoti e ka shkruar. Ai këtë e ka shkruar pasi e di se çka bëjmë ne. Kjo i ngjan një njeriu që shikon me dylbi prej një kodrine dhe sheh se një njeri ka bërë një gropë në rrugë, pra ka bërë një kurth dhe në fund e sheh se atë gropë e ka mbuluar me një shtresë pluhuri.

Më vonë në të njëjtën rrugë e sheh edhe një person duke ardhur dhe shokut më të afër të tij i thotë: “Tash ky njeri do të bjerë në humnerë” dhe shoku i tij atë e shënon në fletore. Kurse pak më vonë ai udhëtar me të vërtetë bie në humnerë.

Tash njeriun në majë të kodrës e pyesim se a thua njeriu ra në gropë pse ky e dinte dhe pse njeriu afër tij e shkroi? Jo.

Kështu edhe Zoti pasi di për gjendjen e çdonjërit, melekëve u thotë që të shkruajnë gjendjen e çdonjërit. (Buhariu, Bed’ul-Hak, Hadith 3/36; Muslimi, Kader, Hadith 2643).

Sikur ne çdo gjë të vepronim, sepse Zoti e ka shkruar ashtu, kjo do të ishte në kundërshtim me caktimin e vetë Zotit, “Për shkak të veprave të njerëzve, janë shfaqur në tokë e në dete të zeza” (30/41). Sepse në këtë ajet ka thënë **“që e kanë fituar me duart e tyre”**.

“Çdokush do ta marrë frytin e punës së vet” (74/38).

“Kjo është meritë e duarve tuaja, se All-llahu nuk është zullumqar ndaj robërve” (3/182).

Në të gjitha ajetet njeriut i vishet ajo që e ka punuar vet. Vetëm mund të thuhet **“Por fuqinë e veprimit ia ka dhënë All-llahu”**.

All-llahu ia ka dhënë një dorë. Me të edhe mund të përkëdhelesh edhe mund të rrahësh. Nga thellësia e tokës mund të nxjerrësh xehe dhe mund të fluturosh edhe në qiell, mund të shëtitësh shtet më shtet. Edhe kësaj dore fuqinë ia ka dhënë Zoti ynë. Kurse udhëzimi i dorës është i yni. Dhe si e kemi përdorur ashtu edhe do të shpërblehemi.

Mjeku nxënësit të tij për të bërë operacion i jep neshter, kurse ai me të mbyllet njeri.

Babai fëmijës të vet për të punuar në kopsht i jep kazmë. Kurse djali i tij me të e prish murin e xhamisë. Këtu faji nuk është as i mjekut e as i babait. Faji është i atij të cilit i është dhënë mundësia dhe fuqia për veprim, kurse ai e keqpërdor atë.

“All-llahu nuk e prish gjendjen e një populli, përderisa ata ta ndryshojnë veten” (13/11).

Me këtë ajet Zoti tregon se njeriu vepron me dëshirën e tij dhe se për çfarë e kanë përdorur mundësinë e tyre për atë edhe do të shpërblehen apo do të dënohen. Kurse për ata të cilët mohojnë dhuntitë e All-llahut lajmëron se do të ketë dënim të frikshëm dhe uri. (Nahl, 112).

Po ashtu thotë:

“Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që e ka punuar” (53/39).

Temën tonë do ta përfundojmë me një poezi (*Safahat, libri i katërt, në katedrën Fatih*) të të ndjerit **Mehmet Akif Ersoi**:

“A bëhet politikë me lypësi, o budalla?

gjaku i politikës është pasuria, jeta e saj është fuqia,

Evropa, një bilbil i dobët njeh vetëm një realitet, fuqinë.

Furnizimi, ushtria duke ecur përpara fitimtar!

delegatët e Lindjes të përmalluar për të puthur yzengjinë!

E pse e lëshove nga dora atë madhështi,

E sot vazhdon të qëndrosh nën këmbë?

“**Vëlla!**”, apo? Jo asses, kjo fjalë nuk është e vërtetë;

E kërkove belanë, All-llahu ta dha...Kjo është e vërteta.
 Si është kërkesa, natyrisht, ashtu është edhe përfundimi,
 A ka mundësi që dëshira të të bëjë zullum?
 “Puno!” thotë **Sheriati**, ti nuk punove, ti u ndale,
 Për të shpikë lloj-lloj gënjeshtërash!
 Në fund aty e fute edhe “tevekkulin”,
 fenë e gjorë e ndërrove me maskaranë!
 Lëre punën, urdhëro nga vendi ku qëndron,
 Mos u lodh, pasi All-llahu është bamirës i së mirës!
 Shkruaj punët në mëngje sikur të dalësh nga shtëpia,
 Një nga një lexoji, kur ta mbushësh fletoren;
 Të gjitha ato punë Zoti i sheh: Ajo është detyra e Tij...
 Puna t’u lehtëua... tash drejt e në kafene shko!
 Fëmijët të uritur zvarriten nëpër dhomë...
 A nuk është Zoti dëshmitari i punëve tua? Ti shiko qejfin!
 Depoja e dhuntive të Tij është në arkën e Tij!
 Sa mastraf ke kërko...Ai të jep!
 Edhe armën e përdor Ai, edhe në kufi pret Ai;
 Nevojat tua t’i ka kryer apo? Vetëm Ai shton!
 Ushtri e ushtri melekësh janë nën urdhrin e Tij;
 Pabesimtarët në llogarinë tënde do t’i shkatërrojë!
 A tu lodh koka, ty të mjafton ai zëri yt naze:
 Thuaj “arrij!”, që të vijë vet, ose le të dërgoj Hëzrin!
 Nëse në shtëpi ka të sëmurë e ka borxh, le ta shikojë;
 Përnjëherë do të rrjedhë depoja e shifasë.
 Demek, çdo gjë është All-llahu...i afërmi yt, ndihmësi yt
 është Ai;
 Të Tij janë fëmijët: lala, motra, shërbyeseja është Ai;
 Ai është qehaja, intendantit, drejtori i arkës;
 Edhe pse marrja të takon ty, përgjegjësia e dhënies është e
 Tij;
 Sikur në anije të bëhet luftë...Ai është anija, Ai është kapiteni;
 Sikur të ketë nevojë edhe për ushtri...Ai është ushtari, Ai
 është komandanti;

Edhe ndaluesi i dhenve, edhe tagrambledhësi kryesor i qytetit është Ai;

Mjek familjar, farmacist...në fund gjithçka është Ai.

Po, ti çka je? Mbështetës?! Kjo më nuk pranohet!

Ka nevojë edhe për respekt...Ç'është ky jorespekt?

Zotin (Hudan) e bëri kull të vetin, e vetë u bë Zot;

Dhe pa iu turpëruar kësaj trimërie i thotë mbështetje...a?

Hebrenjtë Uzejrit, kurse të krishterët Mesias i thonë Zot,

Nëse kjo prishje vazhdon kështu ajo bëhet lement i tevhidit;

A thua imani e nxë këtë shirk të errët tëndin?

A thua mbështetja në Zotin është në këtë mënyrë?

a nuk mendon, për kë ka zbritur Kur'ani...

All-llahu i Lartësuar do të dalë, nëse pyet, kush do të mund të bisedojë!

Ky shabakues (sefih) që të gjithë urdhrave u shpallë luftë,

Obligimin ia drejton All-llahut!

E sheh njeriu gjendjen e këtij vagabondi;

Edhe për një punë më të vogël pa u mbështetur në një mjet,

A thua njeriu mund të jetë i suksesshëm?

I marri e tepron mjaft!

Ku ka korrje pa mbjellë! Eja trego?

Rruga, që ti i thua "**kader**", është përgënjeshtim i Sheriatit;

Kurse mbështetja (tevekkulu) yte është humbje mbi humbje.

Kaderi është prej farzeve të imanit...Ne i besojmë....

Vetëm se ai nuk e ka atë kuptim që ti e ke devijuar.

Kaderi: Gjërat e mundshme të bëhen të dukshme,

kushtet e të cilave gjenden në shesh.

Pse, si vjen...e gjithë ajo e panjohur;

Ne jemi përgjegjës për pamjen e vendimeve tona të lira.

Ç'është **kaderi**, ty nuk të takon hulumtimi i asaj fshehtësie;

Detyra jote është nder ndaj gjithçkaje që urdhëron Zoti.

Kur **kaderi** merr atë formë që ti ia jep;

Për një moment të gjitha urdhrat e sheriatit bëhen të pavlefshëm!

Pse, pra, Resuli i Nderuar i All-llahut,

Këtë temë ia ndalon besimtarit, a thua kot?
 Kur themi **kader**, dëgjo se ç'kuptonin ashabët:
 Urgjentisht i arriti në ndihmë Ebu Ubejdes
 me shokët e tij ushtar në një kohë Faruku.
 - Kij kujdes mos dysho, sepse ndodhia është e dokumentuar-
 Omeri mori rrugën për në Damask dhe zbriti në "Surg".
 Ebu Ubejdeja shpejtoi menjëherë kur mori lajmin.
 Halifja Hazreti Serdarin e pyeti: Ku është ushtria?
 Ç'keni bërë? Ç'keni në plan për të bërë?
 Ebu Ubejdeja tha "kanë murtajë" ushtarët;
 Omeri me shokët e tij qëndroi në vend pa u ngritur.
 "E duhet shkuar drejt murtajës, apo duhet ikur nga ajo?"
 pyeti mendimin e të gjithë muhaxhirëve fisnikë.
 Njëri nga ata tha: "qëllimi është me rëndësi, duhet shkuar";
 "Jo, kjo është rrezik" thanë muhaxhirët e tjerë.
 Halifja kur i pa mendimet e ndryshme;
 I thirri: edhe ensarët i gjeti në të njëjtin dyshim.
 I shpërndau të gjithë, por edhe u mërzit.... atij i mbet,
 T'i pyesë më të vjetërit e muhaxhirë kurejshit; i pyeti edhe ata.
 Ky grup pa asnjë kundërshtim mes veti tha:
 "Është gabim të shkohet drejt në murtajë";
 "Nesër kthehuni" i urdhëroi sahabët Omeri.
 Në agim duke u përgatitur për në rrugë,
 Doli Ebu Ubejdeja: "O Omer, për hajr!
 A ikni prej kaderit të All-llahut?"
 U kthye Omeri dhe tha: "ke të drejtë,
 Vetëm se ne duke ikur prej Kaderit të All-llahut,
 Vrapojmë drejt kaderit tjetër të All-llahut.
 Nëse në një vend me kullosë, rreth e përçark një lumë me
 gurëz,
 Gjendet deveja jote, o Ebu Ubejde;
 Nëse e merr atë dhe e çon në një rafshnaltë,
 Ose e çon në një vend me kullosë,
 Mendo, nëse kjo që bën nuk është kader atëherë ç'është?"
 Omeri duke folur, u paraqit Ibn Afi,

Menjëherë filloi të transmetojë hadithi taunin.
Ebu Ubejdeja, normalisht, u ndal kur dëgjoji këtë.
Muhaxhirinët kurejshitë, sahabet fisnikë,
Ibni Hattabi, janë rukne të rëndësishme të sheriatit;
Kur thuhet **Kader** të gjithë çfarë kuptonin, a e kuptove a!...
Përsëri, pa u turpëruar mos fillo të shpifësh për Zotin
(Hakkun).

Shkenca e fikhut

Është të njohurit e rregullave të veprave të njeriut, i cili është i mençur dhe i moshës madhore dhe i cili obligohet me urdhrat dhe ndalesat e sheriatit.

Edhe shumica e popullit të Turqisë për çëshjet e fikhut i përmbahet rregullave të fetfave të **Ebu Hanifes**, emri i vërtetë i të cilit është **Nu'man ibn Thabit**, i cili është i lindur në vitin 80 h., kurse ka vdekur në moshën 70 vjeçare në vitin 150 dhe njihet si njëri prej tabiinëve.

Ebu Hanifja ka nxjerrë më shumë se një mijë nxënës, nxënësi por më të njohur të tij ka qenë **Ebu Jusufi**, i cili ka lindur më 135 dhe ka vdekur më 189 nga babai Jakub Ibn Ibrahim, i cili ka lindur më 113 dhe ka vdekur më 182 dhe Imam Muhamedi që njihet si **Muhamed Ibn Hasan**.

Në librat e fikhut Ebu Hanifja me Ebu Jusufin njihen si SHEJHAJN, kurse Ebu hanifja me Imam Muhamedin si TARAFAJN, Ebu Jusufi me Imam Muhamedin si IMAMAJN ose si SAHINAJN.

Shkaku se pse është quajtur Ebu Hanife: Emri Hanife nuk është se ai ka pasur një vajzë Hanife, pasi që nuk dihet se Ebu Hanifja ka pasur fëmijë tjetër, përveç Hammadit. Fjala Hanife në gjuhën irakiane ka kuptimin **divit**. Imami krahas shkrimit të bukur ka përdorur edhe divit dhe për këtë është quajtur Ebu Hanife. Gjegjesisht, ai i cili gjërat që i dëgjon i shënon me divit është quajtur babai i divitit. (*Meshabir'un-Nisa, Mehmet Zibni Efendi*).

Sikur sot ata që kanë para llogariten si baba të parasë, ashtu edhe imami ynë (Ebu Hanifja), i cili divitin gjithmonë e ka mbajtur në vete është quajtur si i tillë (Babai i divitit). Dua të them se “**Kur**

themi se në çështjet e fikhut jemi në medhhebin e Ebu Hanifes, nuk jemi simpatizues se është babai i divitit, porse ne jemi prej medhhebit që merret me divit, shkrim dhe me shkencë.”

All-llahu universin e ka lënë në dorë të njeriut. Që të vazhdojë njerëzimi deri në kijamet, ai ka dhënë martesën, kurse për mbrojtjen e trupit duhet bujqësia, tregtia, industria dhe arti. Në të gjitha këto njeriu nuk mund të bëjë vetë, prandaj është paraqitur nevoja për bashkëpunim.

Temat të cilat janë për mbrojtjen e drejtësisë dhe për pengimin e tiraninë, pasi që dëshira, apirata, dashuria dhe urrejtja e njeriut ndryshojnë, si martesë, shkurorëzimi, tregtia, borxhi, mandati, dorëzania, besueshmëria, testamenti, ato quhen **muamelat**. Për ata të cilët dëshirojnë ta prishin jetën shoqërore që e solli ligji islam, ka ligje penale të cilat quhen **ukubat**. Me anë të kisasit është siguruar jeta (shpirti), me dënimin për alkool është mbrojtur mendja, me dënimin për vjedhje është mbrojtur pasuria, e me dënimin për zina është mbrojtur gjeneza.

Si përfundim, çështjet e fikhut ndahen në katër pjesë:

1. Ibadat, 2. Munakehat, 3. Muamelat dhe 4. Ukubat.

Në disa libra të fikhut, duke u futur munakehati në muamelat, thuhet se ka tri pjesë.

Për shkak se në ajet thuhet se qëllimi i krijimit të njeriut është ibadeti, edhe këtu ibadeti është përdorur në fillim. Pejgamberi a.s. në një hadith të tij tregon se: **“Islami ka pesë shtylla: dëshmia se nuk ka zot tjetër veç All-llahut dhe se Muhamedi s.a. është i dërguar dhe rob i Tij, falja e namazit, agjërimi i Ramazanit, dhënia e zekatit dhe shkuarja në haxh sipas mundësive.”** Këtu në këtë hadith namazi vjen menjëherë pas besimit, që tregon se namazi është ibadeti më me vlerë. Vetëm se, pasi pastëria është kushti kryesor i namazit, librat e fikhut fillojnë së pari me kapitullin e pastërtisë. Mund të themi se librat e fikhut së pari njeriun e marrin dhe i japin abdest dhe gusul, pra së pari, kërkojnë pastërtinë e jashtme të trupit. Kurse me namaz mundësojnë

pastërtinë e brendshme të njeriut. Me temperaturën e agjërimit njeriu i djeg njollat vjetore dhe e kthen atë në origjinën e tij.

Me anë të zekatit e formon një urë në mes të zemrave dhe botës dhe xhennetit. Në fund njeriu shkon në haxh dhe përjeton një moment mahsheri (ringjalljeje). Më vonë thotë erdhi koha e martesës. Atëherë mëson rregullat e niqahut. Pas martesës e sheh se duhet siguruar ushqim, vend dhe veshje për dy persona. Kështu mëson rregullat e tregtisë dhe hap një supermarket. Jeta e tij përfundon me autorizim apo trashëgimi të pasurisë nga ana e trashëgimtarëve.

Kështu njeriu me namaz, para se ta lajnë, ta pastrojnë dhe ta falin xhenazen e tij, është larë dhe është falur vetë. Se si njeriu kur është i gjallë e lan dhe e pastron vetveten e tij, do të shohim më poshtë:

Së pari, për pastrimin tonë shpirtëror t'i mësojmë **gjashtë kushtet e imanit**. Pastaj për pastrim të jashtëm të mësojmë **abdestin, guslin dhe tejemmumin**. Dhe në fund me pesë kushtet e Islamit të ndërtojmë ndërtesën e besimit islam.

Pastërtia

Zoti ka krijuar ujin për të marrë abdest, për të pastruar xhunubllëkun, për pastrim nga hajzi dhe nifasi (menstruacioni), si dhe prej papastërtisë së vërtetë si gjak, alkool dhe urinë. Gjithashtu na ka bërë të ditur se kur uji mungon, mund të marrim tejmum me dhe.

Abdest dhe dush mund të bëhet me ujin e detit, lumit, përroit, shiut, liqenit, borës dhe me ujë burimi. Kështu pastrohen papastërtitë dhe ndytësitë.

Uji që rrjedh nuk është i papastër. Pos, nëse në ujin që rrjedh ka shumë papastërti, saqë aroma dhe shija e ujit ndryshon, atëherë me atë ujë nuk merret abdest. Pra me papastërti nuk bëhet pastrim.

Ujërat me sipërfaqe prej 100 m katrorësh, si liqenet dhe baze-nët e ndryshëm, apo edhe më të gjerë se ato, edhe me rënien në to papastërti, përsëri shërbejnë për marrjen e abdestit. Nëse është më pak se 100 m katror dhe ai ujë ndotet, nuk mund të shërbejë për abdest.

Ujërat e rrjeteve të qytetit dhe ujërat e depove që përdoren rregullisht janë sikur ujërat që rregullisht rrjedhin. Me rënien e një harabeli dhe me ngordhjen e tij aty, uji nuk bëhet i papastër. Por nëse pas ngordhjes, uji nuk lëviz një kohë të gjatë, atëherë ai ujë është i papastër, pra depoja për t'u pastruar duhet të zprazet.

Abdest mund të merret nga ena ku ka pirë ujë njeriu, kafshët shtëpiake që u hahet mishi, si delja dhe dhia, si dhe kafshët e egra, si lepuri dhe dreri, sepse uji llogaritet i pastër.

Me ujin që ka tepruar nga ena ku kanë pirë ujë kafshët mishi i të cilave është haram, si qeni, ujku dhe derri, nuk merret abdest.

Pastrimi

Pastrimi në radhë të parë bëhet me ujë. Nëse nuk ka ujë, atëherë merret tejemmum me dhé dhe kështu mënjanohet xhunubllëku.

Me materiet që rrjedhin, si uthulla, lëngjet e pemëve, koka kolae me lëng lulesh, papastërtia mënjanohet, por abdest nuk merret dhe xhunubllëku nuk lahet.

Pastrimi i papastërtisë së urinës që nuk shihet, duhet larë më pak tri herë. Kurse, për pastrimin e papastërtisë që duket, duhet zhdukur, së pari, vetë papastërtia, pastaj era dhe në fund ngjyra e saj. Nëse eventualisht era dhe ngjyra nuk hiqen, mjafton vetëm larja e vet papastërtisë.

Pastërtia në toalet

Për pastrim nga papastërtia, së pari do ta përdorim ujin. Se a do të jetë mjeti për përdorimin e ujit ibriku, çezma apo diç tjetër moderne, nuk është aspak me rëndësi. Ne duhet të përdorim një mjet që do të na mundësojë pastrim nga papastërtia.

Feja jonë, e cila në shkretëtirë ku nuk kemi ujë lejon të bëjmë pastrim edhe me gurë, në vendin ku nuk ka ujë, lejon pastrim edhe me letër.

Abdesti

Farzet e abdestit:

1. Larja e fytyrës prej ballit, ku përfundojnë flokët, e deri nën mjekër dhe prej veshit të djathtë deri te veshi i majtë.
2. Larja e krahëve deri në bërryl.
3. Dhënia mes' h një të katërtës së kokës.
4. Larja e këmbëve.

Sunnetet e abdestit:

1. Fillimi me besmele.
2. Bërja nijjet.
3. Larja e dhëmbëve me brushë.
4. Fillimi nga e djathta te organet çift.
5. Dhënia mes' h tërë kokës.
6. Dhënia mes' h veshëve dhe qafës.
7. Marrja e abdestit pandërprerë.

Prej rregullave të abdestit janë edhe kthimi kah kibla, pengimi i stërpikjes dhe fryerja e hundës me dorë të majtë.

Gjërat që e prishin abdestin

Abdestin e prishin gjërat që dalin prej trupit, si gjaku, sperma, urina, qelbi, nxjerrja e gazrave, etj. Nëse vjellja është me gojë të plotë, atëherë abdesti priset.

Abdestin e prishin edhe dehja, alivanosja, fjetja duke u mbështetur në diçka ose duke u shtrirë dikund.

Gjërat që nuk e prishin abdestin:

Abdestin nuk e prish loti që rrjedh kur njeriu qan ose kur gëzohet. Por, nëse për shkak të sëmundjes së syrit rrjedh lot, abdesti priset.

Abdestin po ashtu nuk e prishin qethja, prerja e thonjve dhe të qeshurit me zë jashtë namazit.

Gusli

Farz është larja pas xhunubllëkut, pas përfundimit të gjakut të gruas në kohën e caktuar mujore dhe pas ndërprerjes së gjakderdhjes pas lindjes.

Kurse larja e muslimanit ditën e xhumasë është sunnet.

Farzet e guslit

1. Larja e gojës. (Mazmaza)
2. Larja e hundës. (Istinshak)
3. Larja e tërë trupit, ashtu që në trup nuk do të mbetet vend pa u larë.

Gjërat që e bëjnë të nevojshëm guslin

1. Nëse del sperma në gjumë ose zgjuar.
2. Nëse përfundon gjaku i adetit mujor të gruas ose pas lindjes.
3. Nëse bashkëshortët duke luajtur, pjesa e sunnetuar e organit gjenital të mashkullit hyn në organin e femrës, gusli bëhet i domosdoshëm.

Gjërat që nuk e bëjnë të domosdoshëm guslin:

Nëse si rezultat i lojës ndërbashkëshortore, i shikimit apo i të menduarit ka rrjedhur lëng nga organi gjenital i mashkullit, rrjedhje kjo të cilën e quajmë **mezi** (e jo spermë), nuk duhet bërë gusul.

Gjendja specifike e gruas

Gjaku që rrjedh nga mitra e gruas, kur ajo e arrin moshën e pjekurisë quhet “**Hajz**” (menstruacion). Fëmijët, plakat dhe grujat me barrë nuk kanë hajz.

Gjaku i hajzit, që rrjedh çdo muaj, zgjat së paku **tri ditë**, kurse më së shumti **dhjetë ditë**. Kurse më pak se kjo nuk ka.

Ndërkaq, gjaku që rrjedh pas lindjes quhet “**Nifas**”. Nifasi zgjat më së shumti **dyzet ditë**, kurse ka raste që gjak të mos ketë aspak.

Nëse gruas jashtë kohës së hajzit dhe të nifasit i rrjedh gjak, ai është gjaku i sëmundjes dhe quhet “**Istihaza**”.

Me hajz dhe nifas namaz nuk falet dhe agjërime nuk mbahet. Agjërime më vonë bëhet kaza. Gjatë hajzit dhe nifasit marrëdhëniet intime janë të ndaluara, por bashkëshortët mund të flenë bashkë.

Në kohën kur paraqitet gjaku i sëmundjes “Istihada”, femra agjëron, falet dhe lexon Kur’an. E tillë ajo mund të ketë edhe marrëdhënie intime.

Tejmmumi

Tejmmum merret kur nuk ka ujë ose nëse uji është në largësi prej katër mijë hapave. Në situatat kur ka ujë, por mjeku e ka ndaluar përdorimin e tij, ose kur në pus ka ujë por nuk arrihet dot, ose nuk mjafton vetëm për të pirë, si dhe në raste kur ka ujë, por njeriu është i paralizuar dhe s'ka kush t'i ndihmojë atij, ai lirohet prej abdestit dhe guslit dhe i lejohet të marrë tejmmum.

Tejmmum merret me dhe, gurë, tulla, qeramikë, mermer, e jakut.

Tejmmumin e prish çdo gjë që e prish edhe abdestin. Po ashtu nëse kushti që e bën të domosdoshëm tejmmumin zhduket, atëherë prishet edhe vetë tejmmumi.

Farzet e tejmmumit

1. Nijeti

2. Pas fërkimit, për herë të parë të duarve me dhe, i bëhet mes'h fytyrës, e pastaj fërkohen duart për së dyti me dhé dhe me dorën e majtë i jepet mes'h dorës së djathtë, kurse me dorën e djathtë i jepet mes'h dorës së majtë.

Sëmundjet e vazhdueshme (arsyet)

Nëse gjërat që e prishin abdestin janë të vazhdueshme, si gjakosja e hundës, gazrat, pikosja e urinës, rrjedhja e plagës, abdesti merret pasi të hyjë koha e namazit dhe namazi falet në atë gjendje. Kur të kalojë koha, abdesti prishet. Për çdo kohë të namazit duhet marrë abdest të ri. Pra, sado që prej të sëmurit të rrjedh papastërti, nuk mund ta pengojë atë që të falë namaz.

Mes'hi mbi meste

Mes'hi i një muslimani, që vesh mest e pasi që merr abdest, i cili nuk është udhëtar, prej momentit të prishjes së abdestit dhe të marrjes abdest me mes'h, afati i përdorimit të mes'hit (pra i marrjes abdest me mes'h) zgjat 24 orë.

Nëse nis një rrugë prej 90 km, kur llogaritet mysafir, afati i marrjes mes'h është tri ditë/72 orë.

Mestet duhet të jenë ashtu që ta mbështjellin tërë këmbën, nuk duhet të jenë të çara apo të plasaritura sa të mund të depërtojnë tre gishta të vegjël si dhe meste duhet të kenë të dyja këmbët.

Kur priset abdesti priset edhe mes'hi.

Nëse mestet nxirren, priset mes'hi. Me plotësimin e afatit të mes'hit, për vendësin 24 orë, kurse për mysafirin 72 orë, mes'hi priset.

Mes'h mbi mbështjellës të plagës

Nëse vendet e thyera apo plagët janë të mbështjella dhe mjeku e ndalon shpalosjen apo larjen e saj, atëherë me dorë të lagur jepet mes'h mbi mbështjellësin e plagës.

Imani dhe Islami

Në Kur'ani Kerim fjala iman dhe Islam përdoren bashkë e ndonjëherë përdoren ndaras. Nëse në një ajet përdoret vetëm fjala iman p.sh. ajetet që fillojnë "O ju që besoni..." ato në vete e ngërthejnë edhe kuptimin islam.

Por në ajetin "Nuk ka dyshim për muslimanët dhe për muslimanet, për besimtarët e besimtare... All-llahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh" (Ahzab, 35), Islam dhe iman përdoren ndaras dhe kanë kuptime të ndryshme.

Në këtë rast islam do të thotë nderim i Zotit me formë, kurse iman do të thotë nderim me brendësi, me zemër.

Pejgamberi ynë në një hadith të tij këtë gjendje e shpreh kështu: "Islami është ana e jashtme, ana e qartë, kurse imani është në zemër." (Musned, Ahmed b. Hanbel, 3/134).

Në Kur'anin Kerim për njerëzit që besimi i tyre është vulosur në zemrat dhe të cilët vijnë te Resulullahi dhe i thonë ne kemi besuar, thuhet: "Beduinët thanë: Ne kemi besuar! Thuaj: Ju nuk keni besuar ende, por thuani: ne jemi dorëzuar, e ende nuk po hyn besimi në zemrat tuaja" (Huxhurat 14). Neve me gjuhën e tij na tregon se ka njerëz të cilët në dukje janë muslimanë kurse në zemër nuk janë muminë (besimtarë).

Sot njerëzit të cilët thonë se i besojnë Allahut dhe se e pranojnë Kuranin si fjalë të Allahut, kurse nuk i pëlqejnë disa ajete nga Kur'ani, në dukje duken muslimanë, kurse në brendi mosbesimi i tyre vlon.

Hyrje në Islam (Kelim-i shehadeti)

Omer b. Hattabi (r) transmeton se, duke qëndruar një ditë me Pejamberin a.s. pamë një njeri që u paraqit përpara tij, me tsha të bardha dhe flokë të zeza, i cili nuk kishte asnjë gjurmë udhëtari. Askush nga ne nuk e njohte atë. Ai u ul pranë Pejgamberit a.s., gjunjët e tij i mbështeti në gjunjët e Pejgamberit a.s., kurse duart i vendosi mbi duart e tij dhe i tha: “O Muhammed, më trego mua për Islamin”. Pejgamberi a.s. i tha: “Islam është dëshmia se nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut, dhe se Muhammedi është i dërguar i Tij, falja e drejtë e namazit dhënia e zekatit, agjërimi në muajin e Ramazanit dhe haxhi në Qabe nëse ke mundësi.” (Buhari, K. Iman 1/18; Muslim 1/37).

Sipas një hadithi tjetër thuhet se “Islami është i ndërtuar prej pesë shtyllave” dhe pastaj vijonë pesë kushtet, si më lart. (Buhari, K.Iman, 1/18; Muslim, K. Iman 1/45).

D.m.th. se në Islam hyhet me kelime-i shehadet. Allahu është Ai i cili Pejgamberit këto gjëra ia ka mësuar nëpërmjet ajeteve kuranore. Ai është që Pejgamberit ia dërgoi Kur'anin nëpërmjet Xhebrailit. Kështu një njeri që e thotë shehadetin, ai beson edhe në Allahun, melekët, librat, pejgamberët, në ahiret dhe në kaderin e Allahut.

Sot të rinjtë tanë naivë thonë: ”Të mësosh 6 kushtet e imanit dhe 5 kushtet e Islamit është të mos e marrësh seriozisht çështjen. Kurse iman është besimi në 6000 e më tepër ajete të Kuranit”. Po ata nuk e mendojnë kuptimin e kësaj fjale dhe se kjo fjalë e preke Pejgamberin a.s.

Besimi në libër do të thotë në atë që libri ka brenda. Dëshmia është si ka thënë Allahu të jesh mu`min i vërtetë nga e cila kuptohet se besimtari i vërtetë nuk do të digjet në xhehennem.

Ajo që pranohet si hadith mutavatir dhe transmetohet nga 34 sahabe, është me sa vijon: "Kush dëshmon se nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut, atij i bëhet vaxhib xhenneti" (Kitabu`l Ezhari-l Mutenazive fi-l- Ahbari- el- Mutevatira, Sujuti, s. 31).

Disa shokë duke thënë se "nuk është edhe aq lehtë" e mohojnë këtë hadith, sikur dëshmia në ekzistencën dhe njësinë e Allahut të ishte një gjë shumë e lehtë.

Sikur sot kryetarin e shtetit rus ta pyetnin sa zotëra ka, do të përgjigjej "aspak"!

Ndërkaq nëse pyetet kryetari amerikan, ai do të përgjigjej "tre". Pra, nuk është lehtë të thuhet se "Allahu është një" dhe ajo të veprohet në praktikë. Sikur të ishte aq lehtë (vetëm në fjalë), atëherë edhe një orientalist që meret me studime orientale, për shkak se e thotë shehadetin, duhet të hynte në xhennet.

Sikur të ëmbëlsohej goja duke thënë "mjaltë", nuk duhej mërzitur për fluturimin dhe ikjen e bletës.

Një besimtar që e thotë shehadetin, mosmarrëveshjet në lidhje me burimin e kujtimit që burojnë prej filozofive greke, da të përfundonte me një fjalë.

Frikën e ndarjes së "Kombeve të Bashkuara" Kur`ani e zhdruk duke thënë se çdokush është burim prej një mashkulli dhe një femre dhe se të gjithë njerëzit në gjenezë janë vëllezër dhe se në vend "Kombet e Bashkuara" duhet të jetë "Shoqëri e fëmijëve të Ademit". (Nisa, 1; Huxhurat, 13)

Besimtari që dëshmon, e di se Allahu është krijuesi i qiellit dhe i tokës, se është furnizuesi i yjeve, krijues i gjallesave dhe i trupave. Ai është edhe krijues edhe marrës i jetëve dhe për këtë nga frika e jetës nuk i është mirënjohës askujt.

Ai i cili dëshmon se Ai është dhënësi i rrizkut për të gjitha gjallesat e krijuara, për shkak të brengosjes për rrizkun nuk bëhet koprrac dhe për shkak të frikës së ndërprerjes së rrizkut nuk i sheh disa ajete të fuqisë së tij.

Ai e di se sundimi në botë i takon vetëm Allahut dhe nuk nderon dhe adhuron dikë tjetër përveç Tij.

Kjo kelime-i tevhid, e cila në të gjitha hadithet mutevatir e bënë vaxhip xhennetin, është një fjalë për të cilën të gjithë pejgamberët i kanë mësuar popujt e tyre: "Ne nuk kemi dërguar asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: nuk ka zot tjetër përveç Meje, pra më adhuroni!" (Enbija. 25).

Ky ajet kuranor e tregon këtë të vërtetë.

Edhe Junuz Emre këtë ajet e përkthen kështu: "Kuptimi i të katër librave është LA ILAHE ILLA LLAH

Kjo myzhde (sihariq) e këtij hadithi mutevatir është thënë edhe në këtë ajet të Rrahmanit dhe Rrahimit: "S'ka dyshim se Allahu nuk fal t'i përshkruhet Atij shok, e përveç këtij i fal kujtdo" (Nisa 116/48).

Të gjitha dhunat, torturat e disfatat burojnë prej shirkut (politeizmit). Edhe Lukmani kur e këshilloi birin e tij i tha mungon një ajet. " (Lukman, 13).

Dëshmia

Dëshmitari më i mirë i asaj se nuk ka zot tjetër, përveç Allahut, është vetë Allahu xh. sh. Ai të gjithë numrat dhe specifikat e frutave, gjetheve dhe degëve të rrapit në bërthamë, i regjistron mu sikur kompjuteri.

Ai me një kokërr grurë ka deponuar materie të vlefshme për syrin, eshtrat, flokët dhe për thonjtë tanë. Ai Ferhadës i ka dhënë ashk për t'i shpuar malet, kurse Mexhnunit për t'i kaluar shkretëtirat.

Ai prej diellit miliona luleve u ka dhënë miliona tonelata ngjyra dhe e ka zbukuruar botën tonë.

Për këtë Ai i pari dëshmon për ekzistencën dhe për njësinë e Tij. Pastaj dëshmojnë edhe melekët dhe dijetarët e drejtë.

Dijetarët duhet të jenë të drejtë. Nëse s'janë të drejtë, mund të jenë pabesimtarë. Po të jenë të drejtë, ka mundësi që dituria me të cilën ata merren, t'i çojë në besim në Allahun.

Biologun një qelizë mund ta çojë në besim. Pasi që njeriu, si krijesë më e vlefshme nuk mund të krijojë edhe një qelizë dhe nuk mund ta kuptojë thelbin e vërtetë të saj, kurse në qelizë ekzistojnë artet më të përsosura, ai bëhet adhurimi më i mirë i asaj se këtë e ka krijuar një krijes tjetër, pos njeriut.

Një besimtar, që e sheh njësinë dhe ekzistencën e Allahut në ajetet kuranore dhe ajetet natyrore, gjithë atë që e sheh, e di dhe beson se mund t'ia komunikojë njerëzimit për Të.

Ai që ka arritur në çdo vend, si në mesxhide, shtëpi, universitete, në Alpe, në Himalaje, dëshmon se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhammedi është rob dhe i dërguari i Tij.

Robi dhe i dërguari i Allahut thotë: "Unë jam urdhëruar të luftoj që njerëzit të thonë La ilahe illa allah" (Buhari 1/11; Muslim 1/38; Ebu Davud 1/234; Nesai 2/161; Tirmizi K. Iman, Hadis: 2606; Musnedi Ahmet 1/19-35-47, 2/433; Hakim 2/522; Darimi 2/218; Taberani (Kabir) 1/25; Evsad 1/24)

Ky hadithi sherif, të cilin prej Pejgamberit a.s. e kanë dëgjuar 14 sahabe dhe se ajeti kuranor prej të cilit buron ky hadith "Luf-toni ata derisa të mos mbetet idhujtari" (Enfal 39; Bekare 193), na inkujaron se një ditë toka do të mbushet në mënyrë absolute me drejtësi islame.

Ata që, përkundër këtyre ajeteve dhe haditheve, e sjellin ajetin "Në fe nuk ka dhunë" (Bekare 256), sikur dëshirojnë të tregojnë imazhin se në Kur'an ka kundërshtime dhe që tiranëve t'u duken më simpatikë.

Në këtë ajet është ndaluar që një të kushtësi në gjoks t'i vihet oushka dhe të detyrohet në dëshminë në Allahun, sepse në besim qenësore është pranimi me zemër. Kjo gjë është sikur të dashurosh diçka, bile edhe më tepër. Mirëpo, kjo nuk bëhet me frikësim dhe detyrim.

Por, besimtari duhet të përpiqet që t'i largojë të gjithë njerëzit e botës prej shirkut dhe t'u mundësojë që ta përqafojnë besimin

Islam, të jetojnë mes drejtësisë dhe mirësisë dhe, po ashtu, duhet të dijë të zhdukë pengesat që e pengojnë arritjen e Islamit te njerëzit.

Në vazhdimin e ajetit “Në fe nuk ka dhunë” shihet qartë se e drejta dhe e shtrembëta dallohen mirë”. (Bekare, 256). Luftoni derisa njerëzve, kudo që jetojnë, t’u bëhet e njohur e vërteta, përkundër të pavërtetës. Pasi të realizohet kjo, atëherë thuhet që njerëzit të mos detyrohen më në besim.

Çdo besimtar që beson në kelime-i tevhid, beson se “Sundimi i qiejve dhe i tokës i takon Allahut’ (Nur, 42) dhe e di se në sundimin e Tij nuk mund të ketë tjetër sundues përveçse me lejen e Tij, se përndryshe do të jetë një prej kundërshtarëve, tiranëve dhe okupuesve.

Zoti ynë thotë: ”O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë” (Bekare 168). Nëse një njeri punon që një pasuri ta hajë hallall, ajo pasuri është e atij ose i dhurohet atij ose i lejohet që ai ta hajë. Pasi Zoti thotë: “Hajeni si hallall”. Për ta ngrënë hallall duhet besuar se pasuria i takon Allahut dhe se ajo duhet ngrënë sipas rregullave të tij.

Ndërsa Zoti ynë besimtarëve u thotë: ”O ju që besuat, hani nga të mirat që ju kemi dhënë” (Bekare 172). Ne ushqehemi me lejen e Zotit.

Njeriu që beson në kelime-i shehadet duhet të veprojë ashtu që njerëzve të tërë botës me drejtësi t’ua përhapë nimetet e Allahut.

Në Kur’an Kerim ganimetit i thuhet Fej, që e ka kuptimin edhe ruxhm (kthim). Në suren Huxhurat-9 thuhet: “...Luftojeni atë grup që vërsulet me të padrejtë, derisa t’i bindet udhëzimit të All-llahut”.

Ganimetit i thuhet Fej, pasi që pasuria u kthehet pronarëve të vërtetë dhe me këtë mund ta pastrojnë veten vetëm katër për qind të 25 mijëve të pasurve, ndërsa në botë ka 20.000 të pasur (Hifzi Topuz, Globallesme icinde bilimsel arastirmalar, Sanat yay, 1998, s. 6).

Që të mos mbetet një shtet si trashëgimi e të pasurve duke kaluar prej dore në dorë, Zoti ynë në suren Muxhadele parasheh

që t'ua kthejë pasurinë pronarëve të vërtetë, që të pengojë tiraninë e tiranit dhe t'i ndihmojnë edhe tiranit edhe të shtypurit. Kjo gjë duhet bërë për t'u dëshmuar sjellja e shehadetit, pasi Pejgamberi a.s. thotë: "Kush dëshmon se nuk ka Zot tjetër, përveç Allahut, atij i bëhet vaxhib xhenneti" (Buhari 7/176; Muslim K. Iman. 1/25).

Shënim: Ky term më gjerë është punuar në pjesën Besimi në Allahun.

Namazi

Shartet dhe ruknet e namazit

Namazi, që është çelësi i shehadetit (Neai K. Ishratun-Nisa 7/6), drita e syve (Musned Ahmed b. Hanbel, 3/340), qetësia e shpirtit dhe trupit të muslimanëve dhe evens për qetësim (Ebu Davud K. Edeb, Hadisth no:49850, është shtylla e fesë.

Namazi që mbron prej të këqijave (Ankebut 45), është ibadet më me vlerë, në të cilin trupi dhe zemra e besimtarit janë njëra pranë tjetrës, shpatullat janë të mbështetura në njëra-tjetrën, e gjunjët takohen me njëri-tjetrin

Namazi është mi`raxhi i besimtarit dhe takim me hakun (Zotit) pesë herë në ditë. Brenda në popull, duke marrë fuqi prej kësaj të kthyherit në popull me selam, që në prezencë të Hakut të jesh me popullin.

Namazi na sjell barazi në një saf; është një ibadet që na tregon se fronti ku e kthejmë fytyrën është një. Kurse andej kah e kthejnë shpinën është kufri, i cili na i mëson ibadetet praktikisht. Pejgamberi a.s. lajmëron se ata të cilët safët i kanë të shpërndara, edhe zemrat i kanë të shpërndara.

Muslimanët, të cilët në këtë botë të rrumbullakët pesë herë në ditë kthehen kah Qabeja, renditen si lulehëne. Ata i luten Zotit për besimtarët, kurse për pabesimtarët kërkojnë udhëzim.

Aty askush nuk ka përparësi ndaj tjetrit. Edhe imani që qëndron pikërisht në krye, nuk mund të ndalojë duke “e shtrirë dorë”. Përndryshe do të vinte në pyetje sundimi i njeriut ndaj njerëz-

ve. Kur imami thotë: "Allahu Ekber" (Allahu është më i madhi), edhe ummeti thotë të njëjtën.

Pasi që namazi është mi`raxh i besimtarit, përpara Kijametit njeriu duhet të arrijë i pastër.

Zoti ynë tregon se, pasi xhenneti është i pastër dhe i bukur, atë e meritojnë vetëm të pastërtit. (Nur, 26). Takvasë, i cili anën e jashtme e pastron për popullin i thuhet i përsosur (Tefsiri Kebiri, F.Razi, Bekare 2.).

Shartet e namazit

1. Pastrimi i hadesit

Mashkulli apo femra kur falet përpara Zotit, nëse ka qenë xhunub, gruaja në fund të menstruacionit, dhe pas lehonisë duhet marrë gusul. Nëse nuk janë këto raste, atëherë për namaz së pari duhet larë duart, pastaj: tri herë gojës dhe hundës, tri herë fytyrës, tri herë krahun e djathtë deri më bërryla, tri herë krahun e majtë, mes'h $\frac{1}{4}$ së kokës, mes'h flokëve dhe në fund i lan këmbët deri në kockën e këmbës, sepse për namaz edhe fytyra, duart dhe këmbët duhet të jenë të pastërta. Në gojë me të cilën do ta përmendim Allahun nuk duhet të ketë papastërti (fjalë e ndytë); muslimani kur ta dëgjojë fjalën e Allahut duhet të jetë i pastër dhe të shndritë.

2. Pastrimi prej nexhasetit

Çdo musliman pesë herë në ditë duhet pasur kujdes për teshat dhe për vendin ku do të falet. Ato vende dhe ato gjëra duhet t'i pastrojë prej papastërtisë së njeriut dhe të kafshëve, si dhe prej alkoolit i cili ia humb njeriut mendjen.

Pejgamberi a.s. thotë: "Toka mua më është bërë mesxhid". (Buhari, Tejemmum 1; Muslim. K. Mesxhid, 3). Bota (mesxhidi) duhet të mbahet e pastër dhe e bukur. Derisa jemi në mesxhid, rrena, shpifja, përgojimi, ryshfeti, dhuna dhe plaçkitja janë haram.

Por kjo ëshë e ndaluar edhe në tërë botën. Të gjithë njerëzit duhet të jetojnë sipas Kuranit dhe Sunnetit.

3. Setru avreti (Mbulesa e trupit)

Është kulturë dhe urdhër që përpara Zotit të dilet ashtu si pororsit Ai. Për Zotin nuk ka të fshehur edhe të qartë. Çdo urdhër dhe ndalesë e Tij është mëshirë.

Është kusht që burrat të mbulohen prej barku (kërthize) deri në gjunjë, kurse gratë përveç fytyrës duarve dhe këmbëve deri në kockë, çdo gjë tjetër duhet të mbulojnë.

Kjo mbulesë është ibadet. Kjo është mbrojtje e bukurisë. Kjo është mbrojtje e shpirtit prej koprracive dhe stresit dhe është shtim i magjepsjes gjinore. Në perendim, burri i cili deri në mbrëmje sheh gra të zhveshura, kur të vijë në shtëpinë e tij, nuk ndjen nevojë për gruan e tij dhe kështu i kthehet gjinisë së vet. Rezultat i kësaj janë krizat morale (shpirtërore): vetëvrasjet, sëmundjet vrasëse dhe homoseksualizmi.

4. Kthimi kah kibleja

Ai që shpinën tij e kthen kah dielli dhe e sheh hijen e tij, fytyra e atij që kthehet kah dielli shkëlqen. Në zemrën e atij që ia kthen shpinën Zotit, hija e egoizmit rrëshqet. Ibrahim i a.s. i cili Nemrudin e sheh me zemër të mirë thotë:

“Unë me veten time i drejtohem Atij që krijoi qiejt e tokën..” (En`am 79).

Edhe ne kur i shohim ata të cilët ecin në rrugën e Nemrudit kuptojmë se çdo të thotë zemërgjërësia dhe për të pasur një zemër të pastër dhe të shkëlqyer, e cila të gjithë njerëzit do t'i shohë me sy realiteti dhe do t'i nënshtrohen ajetit të Zotit tonë: “...pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë...” (Bekare 144), andaj ne pesë herë në ditë drejtohem kah Kibleja.

Edhe Haxheru-l Esvedi në Qabe për të cilën Hz. Omeri ka thënë: “Unë e di se ti je një gur që nuk mund të sjellë as dëm as dobi, sikur Pejgamberin a.s. mos kisha parë se të puth, edhe unë

nuk do të kisha puthur asnjëherë, (Ibn ebi Shejbe. 1/190; Abdurrezak 5/ 72; Suneni Bejhaki. 5/47).

Po ashtu Hz. Omeri duke e puthur Haxheru-l Esvedin ka thënë: "Besoj në Allahun dhe mohoj tagutin" (Ibni Ebi Shejbe 1/205). Ne nuk kthehemi nga guri. Ne urdhrin e Zotit e çojmë në vend. Para se të shpërngulet për në Meke, ne ktheheshim nga Jerusalemi: me ardhjen e urdhrin të Zotit u kthyem nga Qabeja, sepse "edhe lindja edhe perendimi janë të Atij" (bekare 115)

Njeriu nuk lufton për një stof prej 500 mijë lirash (denarësh), por për flamurin që dëshmon lirinë e muslimanëve. Për mosrëniën e atij flamuri në duart e armikut derdhet gjak, jepet jeta. Kështu është edhe Qabeja.

Ata që gjenden në Mekke kthehen nga Qabeja, kurse ata që gjenden jashtë Mekkes kthehen në drejtim të Qabes. Pjesa e poshtme e Qabes deri në qendër të tokës dhe pjesa e sipërme deri në shtat kat qiell është kible. Kështu që muslimani derisa është në ruku dhe sexhde nuk ndahet prej Qabesë.

Kjo shprehje në librat tanë të fikhut tregon edhe për ligjin hapësinor që është marrë deri në shekullin XX.

5. Koha

Pejgamberi a.s. tregon se ata që nuk e dinë vlerën e shëndetit dhe të kohës janë të mashtruar dhe në humbje (Buhari K. Rikak 1).

Zemrat e ndershme të mbështjella me errësirën e natës, në agim zgjohen me ezan. Kur çdokush fle, ai është i zgjuar.

Muslimanin, i cili në kohën e drekës është zhytur në tregti, bujqësi, art dhe në politikën e tij, gjuha e kohës e zgjon. Atij i cili mbështetet në kokën e vet dhe mendon se është më i madhi, i tërhiqet vërejtja të thotë Allahu ekber (Allahu është më i madhi). Në kohën kur njeriu i beson vetvetes dhe thotë: "Unë jam më i madhi", gjuha e kohës thotë "Allahu ekber".

Ajo e then egoizmin e tij. Ai në pesë kohët e namazit e di se sa është koha dhe atë e vlerëson. Kohët e namazit Pejgamberit a.s. ia ka mësuar Xhebraili a.s. (Ebu Davudi Kitabat). Kurse sot namazi falet duke e shikuar kalendarin, kohët e namazit planifiko-

hen sipas lindjes dhe perendimit të diellit, kurse në ato vende ku dielli nuk perëndon shumë gjatë, koha e namazit caktohet sipas orës së Mekkes.

6. Nijeti

Muslimani i cili me trup kthehet kah kibleja, duhet të kthehet kah Zoti edhe me zemër. Nijeti si “vendosa që në kënaqësinë e Allahut të fal sunettet e sabahut” është mustehab. Në bazë të namazit, një ditë është sunnet, farz, vaxhib.

Ruknet e namazit

1. Iftitah tekbiri (tekbiri fillestar)

Muslimani që me shpirt kthehet kah Zoti, kurse me trup kah Kibleja duke braktisur çdo gjë që ka fituar dhe aspiruar në këtë botë dhe duke zhvlerësuar çdo gjë në syrin e tij, nëse është mashkull duart i ngre deri te veshi, e nëse është femër deri në shpatulla (Sunnet).

Zotin e lartëson me duar të hapura (sunnet) dhe me tekbir duke thënë Allahu, Ekber (Farz).

Sikur që njeriu, pasi që të ngopet në tryezë, i çon duart dhe i lutet Allahut. Atij që e furnizon dhe e falënderon pesë herë në ditë me duar dhe me kthim të shpinës, e shenjtëron Zotin dhe kështu mund të lartësohet me madhërinë e Tij.

2. Kijam

Është qëndrimi në këmbë duke i mbështetur duart në gjunj. Është paraqitje përpara Zotit e burrit duke i mbajtur duart të lidhura në kërthizë, kurse gruaja duke i mbajtur mbi krahëror. Dorra e djathtë vihet mbi dorën e majtë (sunnet). Pasuria është e Tij dhe prej Tij përsëri kthehet tek Ai. Nuk ka ku të ikë kur njeriun të dërgohet në xhehennem. Nëse ka qenë në këtë botë dhe përpara zotit i ka lidhur duart, atje nuk do t'i ketë të lidhura. Ai që përpara

zotit i lidh duart, e ka edukatën për moslidhjen e duarve përpara krijesave të tjera.

Këmbët në mes duhet të jenë larg njëra tjetrës katër gishta (sunset) dhe ato që i hapin më tepër bazohen në sunset. Leximi i Subhanes dhe i Eudhubillahi mineshejtan-it, të cilat këndohen në pjesën e komentimit të lutjes, është sunset.

3. Kiraet

Nga Kur`ani duhet lexuar sa sureja Kevther (farz). Leximi i Fatiha-së pas eudhu dhe beslemes është farz. Të thuhet Amin pas Fatihasë është sunset. Pas aminit leximi i një sureje të shkurtër është vaxhib. Sureja e shkurtër të paktën sa Kevtheri është vaxhib.

Kijam dhe kiraet është përmendja e Zotit me shpirt (zemër), trup dhe gjuhë. Ai është shkencë, aksionit dhe dhikërit, trokitje në derën e mëshirës së Zotit me fjalën e Tij, praktikim me trup ia saj që beson me zemër dhe në fund dëshmi me gjuhë.

Edukimi i mundësisë për të qenë e njëjtë fjala dhe vepra, është lëvizja për të qenë ashtu si dukesh, të dukesh ashtu si je.

4. Ruku`

Përrulje derisa duart të prekin në gjunjë (farz). Kur të përfundojë sureja imami thotë "Allahu ekber" (sunset) ashtu që edhe xhemati mund të shkojë në ruku; mashkulli mund të mbështjellë gjunjët, kurse gratë pak shtrembërohen. Mashkulli gjunjët i mban drejt. Mashkulli midisin (belin) e tij rrafshon, kurse femra e mban pak të lakuar (sunset). Mashkulli me duart e tij kapet për gjunj, kurse femra vetëm i ve duart mbi gjunj (sunset).

Në ruku` tri herë thuhet "Subhane Rabijje'l A'la". (I madhërishtëm dhe i pastër prej çdo të mete është Zoti ynë), që është më i madhi (sunset).

Pejgamberi a.s. thotë: "Ai që për All-llahun tregohet modest dhe i përkulet Atij, All-llahu atë e lartëson, kurse atë që tregohet kryelartë e poshtëron". (Ahmd b. Hanbel. Musned, 3/76). Ata që

përkulen përpara Allahut nuk përkulen përpara të tjerëve. Kurse ata që nuk i përkulen Allahut, i përkulen krijesave të Tij.

Pasi që në ruku` tri herë të thuhet "Subhane Rabijje'l A'la", thuhet Semi Allahu Limen Hamideh (Allahu e pranofte falënderimin e falënderuesit). Dhe trupi drejtohet, pastaj thuhet "Rabbena Leke'l Hamd" (Zoti im falënderimi të takon vetëm Ty) (sunnet). Pastaj thuhet Allahu Ekber (sunnet) dhe shkohet në sexhde.

5. Sexhdeja

Sexhdeja është lëshimi në tokë me dy gjunjë, me dy këmbë, me dy duar dhe me ball, gjegësisht me shtatë gjymtyrë. Pejgambëri a.s. ka thënë: "Vendet që kanë gjurmë sexhdeje All-llahu zjarrit ia ka bërë haram që t'i djegë" (Buhari, K. Ezan, Babu fadli es-suxhud). Për të shpëtuar prej pastrimit dhe prapambeturisë në këtë botë dhe për të mos u djegur në ahiret në zjarrin e xhehennemit përpara krijesave të Allahut nuk duhet të përkulemi, por duhet t'i bëjmë sexhde vetëm Allahut. Zoti ynë tregon se çdo gjë në qiell dhe në tokë, si: dielli, hena, yjet, mallet, drujtë, kafshët dhe shumica e njerëzve bëjnë sexhde (Haxh, 18). Përveç njeriut, gjallesat e tjera të gjitha bëjnë sexhde. Vetëm disa prej njerëzve i shohim duke treguar nderim dhe nuk bëjnë sexhde.

Në vazhdimin e ajetit të njëjtë Zoti ynë tregon se në një xhami me mijëra bien në sexhde, ashtu që nëse një mbetet në këmbë, në shesh do të dalë mosnderimi i tij. Ndërkaq kur e tërë bota me gjuhën e vet dhe gjendjen që ka bën sexhde, njeriu që ik prej sexhde e meriton dënimin e Zotit.

Kur`ani tregon se, para një mijë e katërqind vjetëve, ata që janë në qiell dhe në tokë si dielli, hëna, yjet, malet, drunjtë dhe kafshët bëjnë sexhde (Haxh 18). Po ashtu tregon edhe për ata të cilët tallen me ajetet e tilla dhe injorancës së tyre ia tregojnë dhëmbët e shtrigës që kafshon, kurse me lajmet si "ai e di se lulet dashurojnë dhe dashurohen" që vijnë nga Evropa mbetet gojëhapur.

Besimtari në namazin e tij me kijam, ruku dhe sexhde i përfshin të gjitha format e adhurimeve të melekve, maleve, kafshëve dhe bimëve.

Kur shkon prej kijami në sexhde së pari i lëshon gjunjët, pastaj duart e pastaj ballin dhe hundën (vaxhip). Kjo renditje është synnet. Në sexhde tri herë thotë: "Subhane Rabijje'l A'la", (Zotin e lartësuar e madhëroj dhe Ai është pa të meta.) (sunnet).

Në sexhde është sunet kur mashkulli e ndan barkun prej kofshës, bërrylat prej anëve, krahët prej tokës, kurse femra është sunnet kur këto të dyja i bashkon. Në sexhde duart duhet të qëndrojnë paralel me veshët dhe të jenë të ngjitura për toke. Këmbët mbyllen fort dhe majat e gishtave mbahen të kthyera kah kibleja. Pasi të thuhet tri herë Subhane Rabijje'l A'la thuhet Allahu E. (sunnet) dhe qëndrohet ulur sa të thuhet më pak edhe një herë Subhanallah (sunnet). Pastaj me tekbir shkohet në sexhden e dytë. Edhe sexhdeja e dytë është farz, vetëm se bërja e sexhdesë së dytë menjëherë pas së parës është vaxhib. Edhe sexhden e dytë e bën si të parën dhe me tekbir shkohet në rekatin e dytë.

Pejgamberi a.s. në namaz sexhdet i ka bërë të gjitha, por edhe jashtë namazit ka bërë sexhde për t'iu lutur Zotit.

"Vendi kur robi është më afër zotit të tij është sexhdeja" (Muslimi, K, Salat, hadith No: 482). Pejgamberi a.s. sahabiut i ka thënë: "O i dërguari i Allahut, në xhennet dua të jem fqinji yt". Ai i është përgjigjur: "Atëherë edhe ti më ndihmo ne sexhde" (Muslimi, salat, hadith no: 489).

Pengimi, rënia dhe mundja nga ana e forcave armike e njeriut në përpjekjet islame nuk e pengon atë që ai të qëndrojë në këmbë. Sikur një fëmijë të ishte frikësuar nga rënia vet, nuk do të kishte mundësi të ecë. Ai në namaz kokën e vë në dhe para Zotit, kurse koka e cila përkulet përpara Zotit meriton të lartësohet dhe të ngrihet në këmbë.

Rekati i dytë është sikur i pari. Vetëm se kur çohet në këmbë nuk thotë subhaneke eudhubillah. Pas Besmeles këndon Fatihanë dhe një sure, e pastaj e bën rukunë dhe sexhdet dhe në fund ulet.

6. Ulja e fundit

Është farz që, në namazet dyrekatëshe në mes të rekatit të dytë, në namazet trerekatëshe në fund të rekatit të tretë dhe në namazet me katër rekate në rekatën e katërt, të ulet.

Kurse në namazin tre ose katërrekatësh të ulesh në rekatën e dytë është vaxhib.

Meshkujt këmbën e majtë e mbështetin drejt së djathtës dhe mbi të ulen, kurse këmbën e djathtë e mbajnë të ngritur në gishta, kurse gishtat të drejtuar ka kibleja (sunnat).

Ndërkaq femrat të dy këmbët duke i thyer nga e djathta ulen (sunnat).

Duart vihen mbi kofsha dhe lexohet Ettehijati (vaxhib), pastaj lexohet Allahume sali ve barik (sunnat),

Në fund jepet salam në të djathtë (vaxhib) dhe në të majtë (sunnat).

Ky ishte shpjegim i namazit dyrekatësh.

Nëse namazin që e falim është 4 rekatësh dhe është farz, dy rekatet e para falen si më lart, kurse në të tretin dhe të katërtin lexohet vetëm sureja Fatiha (sunnat), ndërsa sureja tjetër nuk lexohet.

Nëse namazi 4-rekatësh është nafile (edhe sunnetet janë nafile), atëherë lexohet edhe një sure. Leximi edhe i Fatihas edhe i një sureje në çdo rekat është vaxhib.

Pas rekatit të dytë në sunnetin e ikindisë dhe të jacisë bëhet ulja e parë dhe aty pas Ettehijatit lexohen edhe salavatet. Pastaj çohemi në këmbë. Në rekatën e tretë në fillim lexohen edhe Subhaneke dhe Eudhu besmeleja.

Namazi i vitrit në dy rekatet e para falet si më lart, kurse rekatit të tretë fillon me besmele, Fatihaja dhe një sure dhe merret tekbir (vaxhib) ku duart ngrihen deri në veshë (sunnat) dhe lexohet lutja e Kunutit (vaxhib), pastaj me tekbir shkohet në ruku.

Sehvi sexhdeja (Sexhdeja e harresës)

Për të plotësuar mangësitë në namaz që paraqiten me harresë, në fund të namazit jepet selam në të djathtë dhe bëhen dy sexhde (vaxhib) dhe përsëri lexohen Etehijjati dhe salavatet.

Sehvi sexhde bëhet kur harrohet vaxhibi. Në disa libra të fikhut thuhet se sehvi sexhde bëhet si rezultat i vonesës së farzit dhe lënies së vaxhibit. Ndërsa fjala “lënia e vaxhibit” në vete ngërthen të dy fjalët e lartpërmendura, sepse edhe mosvonimi i farzit është vaxhip.

Nëse në një namaz janë bërë disa harresa të vaxhibit, ato plotësohen me një sehvi sexhde.

Mbështetja imamit

Nëse namazet farz do t'i falë me imam, nijetin e bën se i është mbështetur imamit, pas imamit qëndron më pak se një këmbë afër dhe nuk e lexon as Fatihanë e as ndonjë sure. Të gjitha lutjet e tjera i lexon me aq zë sa që t'i dëgjojë vetë.

Rekatet e kohëve të namazit:

Namazi i sabahut i ka katër rekate. Në fillim falen dy rekate sunet e pastaj dy rekate farz.

Namazi i drekës i ka dhjetë rekate. Në fillim falen katër rekate sunete më pas katër rekate farz dhe në fund dy rekate sunet,

Namazi i ikindisë i ka tetë rekate. Në fillim falen katër rekate sunet dhe pastaj katër rekate farz.

Namazi i akshamit i ka pesë rekate. Në fillim falen tre rekate farz e pastaj dy rekate sunnet.

Namazi i jacisë i ka trembëdhjetë rekate. Në fillim falen katër rekate sunnet, e pastaj katër rekate farz, pastaj dy rekat sunnet dhe në fund falen tre rekate namaz të vitrit.

Namazi i xhumasë

Namazi i xhumasë i cili falet nga ana e udhëheqësisë së muslimanëve ose nga ndonjë tjetër i emëruar nga udhëheqësi, e vërteton edhe e forcon lidhjen e shoqërisë islame me liderin e tyre.

Ky namaz në mesin e muslimanëve e zhdok dallimin klasor pa bërë dallim i pasur i varfër, udhëheqës-punëtor, komandant-ushtar. Të gjithë i sjell në një saf krah për krah dhe i siguron që të mbeten të njëjtë deri në xhumanë e ardhshme. Namazi i xhumasë është njëri prej ibadeteve më të rëndësishme, i cili sikur magneti që fërkohet në një metal që nuk ka magnet e magnetizon atë. Neve na magnetizon me njëri-tjetrin dhe e zhdok dallimin mes njerëzve. “Më i vlefshmi nga ju është ai që më tepër i frikësohet Allahut” (Huxhurat, 13), në të cilin njerëzit e shndritin shpirtin e tyre dhe bëhet ndihmës i atyre që kanë iman më të dobët. Vetëdijen e cila brenda javës humb, namazi i xhumasë e rifreskon përsëri.

Në hutben e ditës së xhuma kumtohen urdhrat e Kur'anit, i cili ka zbritur për rregullimin e jetës së njeriut dhe të sunetit dhe kërkohet zbatimi i tyre. Aty tregohet edhe për shpërblimin e atyre që i praktikojnë ato urdhra.

Po ashtu kumtohen ndalesat e Kur'anit dhe të ummetit, si dhe kërkohet largimi prej tyre dhe lajmërohet dënimi për ata që nuk largohen. Kështu feja islame i mësohet xhematit në çdo aspekt.

Edhe besimtarët i dinë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Kushtet për të qenë xhumaja farz janë: të jesh musliman, i lirë, burrë (mashkull), i rritur, i mençur dhe vendës si dhe më së paku të jenë tre persona meshkuj.

Namazi i xhumasë falet ditën e premte në kohën e namazit të drekës. Në fillim falen katër rekate sunet të xhumasë. Kurse, pas hutbes, falen edhe dy rekate farz. Më pas falen edhe katër rekate sunnet. Kurse më vonë duke bërë nijet e drekën e fundit falen katër rekate sikur falja e sunnetit dhe në fund falen dy rekate sunet të kohës.

Namazi i Bajramit

Ai që i plotëson kushtet për faljen e namazit të xhumasë e ka vaxhib edhe namazin e Bajramit.

Edhe namazi i Bajramit të Kurbanit, sikur namazi i Bajramit të Ramazanit i ka dy rekate.

Namazi i Bajramit falet ditën e Bajramit prej lindjes së diellit sa një hije njeriu e deri në kohën e zevalit (zenitit).

Për dallim nga namazet tjera, namazi i Bajramit i ka gjashtë tekbire më tepër.

Në namazin e Bajramit pasi merret tekbiri, lidhen duart dhe këndohet Subhaneke, pastaj thuhet “Allahu ekber” dhe duart ngrihen deri te veshët dhe lëshohen tri herë. Pas tekbirit të dytë përsëri lëshohen duart, kurse pas tekbirit tretë duart lidhen dhe pas “Eudhu besmeles” lexohet “Fatihaja” dhe një sure dhe shkohet në ruku. Ndërsa në rekatën e dytë pas leximit të Fatihasë dhe sures merren tre tekbire, pas të cilave duart lëshohen dhe për të katërtën herë kur thuhet “Allahu ekber”, shkohet në ruku dhe kështu përfundon namazi. Edhe namazi i Bajramit, sikur ai i xhumasë, falet me xhemat edhe nëse xhemat ka së paku tre meshkuj.

Namazi për zënien e Diellit dhe të Hënës

Zënia e Diellit dhe e Hënës është shkak për ibadet të muslimanëve ndaj Zotit të tyre.

Zënia e këtyre dy dritave dhe nxehtësive në lëvizjen e të cilave nuk kemi asnjë farë ndikimi, në ditë të caktuara të vitit, na e bën me dije (të ditur) se atë dikush e rrotullon dhe e kthen dhe se fuqia e Tij është mbi të gjitha.

Ne muslimanët për hir të Zotit tonë, i cili e ka krijuar gjithësinë dhe i cili i rrotullon ato në orbordin e tyre, tubohemi dhe duke thënë: “O Zoti ynë, Ti je më i madhi, i falim dy rekate namaz.

Ky namaz falet sikur namazet e përmendura më lart. Vetëm se në të dyja rekatet mund të këndohet edhe me zë edhe pa zë. Ai falet edhe me xhemat edhe tek.

Përveç këtyre ka edhe namaze tjera, si namazi i teravisë (20 rekate), tehijjetul mesxhidi (2 rekate) Tehexhxhut (4 rekate ose 12 rekate), Evvabin (6 rekate), Tesbih (4 rekate), Duha (para dite) (5 rekate), për të cilën në librat e ilmihaleve ka njohuri më të gjerë.

Ekrem Efendi Doganay në një vepër të tij për namazin e ka llogaritur dhikrin e një njeriu që e bën gjatë pesë kohëve të ditës (En buyuk saadet kaynagimiz Namaz, f. 245), të cilat edhe unë e pashë të arsyeshme që t’i përmend këtu:

1. - Tekbir (All-llahu Ekber) 214 herë.
2. - Teavuz (Eudhu Billahi) 15 herë.
3. - Besmele 40 herë.
4. - Sure Fatiha 40 herë.
5. - Sure Zamme ose një sure 33 herë.
6. - Subhaneke 15 herë.
7. - Kijam (Qëndrimi në këmbë) 40 herë.
8. - Ruku (përrulje) 40 herë.
9. - Tesbih (Subhane Rabbijeladhim) 120 herë.
10. - Tesmi (Semiallahu limen hamide) 40 herë.
11. - Tahmid (Rabbena leke’l hamd) 40 herë.
12. - Sexhde 80 herë.

13. - Madhërimi në sexhde (Subhane Rabbije'l A'la) 240 herë.
14. - Ka'de (Ulja) farz dhe vaxhib 21 herë.
15. - Teshehud 21 herë.
16. - Salavat (Allahumme Sali dhe Barik) 15 herë.
17. - Rabbenatina 13 herë.
18. - Rabbenagfirli 13 herë.
19. - Selam 26 herë.

Kështu përmendja ditore e një muslimani që fal pesë kohë të namazit në tërësi arrin numrin 1066.

Agjërimi i Ramazanit është lulja e imanit

Agjërimi: Pjekje (djegie) e zemrës në zjarr të etësisë dhe të urisë së Ramazanit dhe pastrim nga mbeturinat.

Prej kallamit të njomë nuk bëhet nej nëse zëri i tij nuk ndikon në zemër. Kështu edhe zemra e papjekur dhe e pazier me zërin e saj nuk mund të ndikojë në zemër.

Zërat e shqetësojnë njeriun e sotëm: grimësina e kapitastëve të cilat kanë ngrënë shumë dhe gurgullimës së strukjes së komuniteteve të cilët pa dëshirën e tyre kanë mbetur të uritur.

Muslimani i cili trupin e tij e ka ushqyer njëmbëdhjetë muaj, një muaj trupin e merr nën kontroll.

Gramësina e njeriut që nuk ka ngrënë shumë dhe gurgullina e stomakut të njeriut që ka mbetur i uritur me dëshirën e tij, njerëzit nuk i shqetëson.

Druri, i cili gjatë verës ka dhënë fruta në të mirë, kontrollohet dhe krasitet. Ashtu edhe muslimani i disiplinuar bën me dëshirat dhe aspiratat e tij. Ai i cili vetvetes së tij prej mëngjesi e deri në perëndim të diellit ia ndalon hajet, pijen dhe kontaktin seksual, i frenon dëshirat trupave të tij, kurse ai që i largohet gënjeshtëris, shpifjes dhe përgojimit, i frenon dëshirat e tij shpirtërore.

Pejgamberi a.s. thotë se agjërimi në ditët e verës është nga bukuritë dhe cilësitë e imanit dhe (Bugyet-ul insane fi Ramadan Ibnu rexhep) me këtë na e ka treguar esencën e agjërimit.

Nëse me gojë deklarojmë se jemi muslimanë dhe nuk e zbatojmë, bien në gjendjen e paditësit që s'ka argumente. Sado që Allahu xh.sh. të dijë çdo gjë që është e qartë, ajo është e fshetë. Ai

deklaron se ajo që është në zemër, duhet të dalë e të bëhet e dukshme. Ndërkaq paraqitja e asaj që është në zemër është në dobi të njeriut. Këto janë dobi e Zotit.

Zoti di edhe për ngjyrën, aromën, freskinë dhe artin madhështor që trupi i lules e fsheh në rrënjët e saj. Por, përsëri dëshiron që të gjitha këto bukuri të çelin dhe të dalin në shesh. Kur lulja çel, ne fitojmë prej aromës së saj.

Lulja nuk mund ta pretendojë të bukurën. Por ajo aromën e paraqet si një pamje të rezervuar.

Lulja tregon modesti, kurse Zoti bukurinë e lules botës ia tregon me anë të bilbilit.

Edhe besimtari nëse besimin e tij që e ka fshehur në zemër e paraqet pa zë me anë të agjërimit, do të merret përpara melekëve nga ana e Zotit dhe nuk do të detyrohet që të shëtisë nëpër shtete të ndryshme dhe ta shtrijë dorën për të lypur.

Dhuratat mes shokëve janë janë dëshmitarë të dashurisë në zemër edhe agjërimi është lulja e besimit. Pejgamberi a.s. thotë: “Era e gojës së agjeruesit tek Allahu xh.sh. është më e mirë dhe më e këndshme se era e miskut (karanfilit, manushaqes, vaj trëndafil, jorgovanit)”. (Buhari, K. Sijam, hadith no: 1775).

Agjërimi është muaji ku trupi dhe shpirti janë pastruar prej ndytësirave të marra gjatë njëmbëdhjetë muajve dhe i cili çel lule dhe mban fruta edhe njëmbëdhjetë muaj.

Pejgamberi a.s. thotë: ”Agjërimi i Ramazanit i mbulon mëkatet e vogla mes muajve të Ramazanit” (Muslim, K, Taharet).

Agjërimi që mundëson bashkimin tonë

Kur nga lart të shihet fshati ose qyteti i muslimanëve, të cilët në syfyr zgjohen me top ose me daulle me dritat e tyre që reflektojnë nëpër dritare, duket si një livadh kamomilësh.

Drita që shndrit nga dritarja, është reflektim i dritës së zemrës. Njeriu që jeton në shtëpinë që nuk ka dritë është sikur sytë e verbër. Ai edhe pse ekziston në shtëpi vetëm, aty ka jetë varri, pra drita që ndizet është manifestim i asaj në zemër.

Daullet e syfyrit janë sikur daullet që shpallin udhëtim. Ajo është thyerje e sundimit të njeriut mbi disa dëshira legjitime të njeriut si të ngrënët, të pirët dhe të disa dëshirave epshore dhe gjithashtu është përrulje shpirtërore dhe fizike e autoritetit të Zotit (Hakut).

Pas ngrënies së syfyrit të bësh nijet dhe të përtypësh gurin e sabrit është identifikim me sabrin. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Agjërimi është gjysma e sabrit” (Tirmidhiu. K. Davut. 86)

Kurse trupi dhe daullet që bien në mbrëmje sihariqojnë fitim kundër ushqimit dhe pijes për të cilat janë shpikur anë vrasëse, janë shitur ndere dhe janë flijuar personalitete

Kështu armiqve u shpallim se në mesin tonë nuk mund të gjeni tradhëtarë dhe spiunë. Ne jemi ata që kemi kaluar nëpër edukim për të mos e ngrënë ushqimin që e kishim hallal, për të mos pasur marrëdhënie intime me gratë tona. Ne jemi muslimanë të cilët nuk tolerojnë që dikush të zgjatë dorë me pasurinë e tyre dhe në mesin e tyre nuk mund të gjesh njërin që mund të mashtrohet me ryshfet, me premtim posti ose me ndonjë para.

“Agjërimi është mburojë” thotë Pejgamberi a.s. (Buhari. K. Sijam. Hadith No.1775). Agjërimi është mburoja më e mirë ndaj mëkateve, shejtanit dhe njerëzve të shenjtanizuar.

Si trupi, ashtu edhe shpirti ka mburojën e tij. Ky është agjërimi.

Muslimani e di se çdo gjë është krijuar për njeriun dhe krijesa më e fortë e krijuar në mesin e krijesave të tjera është vetë njeriu. Por, kjo dituri nuk e detyron atë në kryelartësi. Ai kur është duke agjëruar edhe përpara një gote me ujë edhe përpara një cope buke, e kupton se është i pafuqishëm që të realizojë një gjë të tillë dhe në atë moment kur dëgjon thirrjen “All-llahu Ekber“. (Allahu është më i madhi) thyerjen e tij fillon ta drejtojë, po me ushqimet që Ai i ka dhuruar.

Asnjë shoqatë, organizatë apo themelet politike nuk mund të sigurojnë një popull përnjëherë që të vërë lugën në çorbë.

Asnjë organizatë nuk mund të detyrojë me miliona njerëz që të qëndrojnë. Nëse do të provonte që t'i detyronte me armë të agjërojnë, atëherë njerëzit në shtëpitë e tyre kur të mbeten të vetmuar përsëri nuk agjëronin.

Kurse agjërimi me dëshirë dhe besim të miliona njerëzve tregon se urdhri për agjërim është prej Zotit dhe se shpirtitrat e paprishur ndjejnë kënaqësi dhe respekt ndaj Tij.

Ardhja e Ramazanit është e sikur ardhja e pranverës. Në fillim fryn një erë, një erë e cila e rrethon dhe u jep lëvizje.

Kështu fillojnë të vijnë materiet ushqimore prej fshatrave, kopshteve dhe arave në qytete. Paratë prej arkave të të pasurve në mesin e të varfërve rrjedhin nëpërmjet zekatit dhe sadakasë. Kështu fillon një lëvizje në çarshi dhe në pazar. Gjuhët fillojnë me tekbire dhe përshendetjet.

“Në Islam nuk ka asketizëm. Asketizmi në Islam bëhet me xhihad” (Musned Ahmed b. Hanbel, 3/82.266).

Muslimani nuk përgatitet sikur ai që në manastire përgatitet për të mos dashuruar gra, për të mos nuhatur erën e bukur dhe për t'u bërë dru djegës për xhehennem.

Muslimani shfrytëzon çdo dhunti legjitime. Ai është ai që nuk ha shumë sa të pëlcasë ose s'ha aspak dhe sëmuret. Ushqimet nuk e kontrollojnë atë, por ai i kontrollon ushqimet. Muslimani kontrollon madje edhe gjakun nëpër enët e gjakut.

Sikur baticat dhe zbaticat në det, që realizohen me ndihmën e hënës, edhe në gjakun tonë ka batica dhe zbatica. Në ditën e parë të Ramazanit që është muaji i tetë hënor, në të cilën shihet hëna e plotë pas 29 apo 30 ditëve, përfundon Ramazani, i cili ka kuptimin e baticës dhe të zbaticës së gjakut tonë. Pejgamberi a.s. thotë: “Agjëroni që të jeni të shëndetshëm” (Mexhmua-t-tevaïd, 3/170)

Ibadeti universal i fesë universale

Të agjëruarit, sipas kalendarit hënor, në muajin e Ramazanit është një shenjë se feja jonë nuk është lokale, por është një fe universale. Sikur çdo vit, sipas kalendarit hënor, të argohej në muajin dhjetor, për ne do të ishte shumë lehtë.

Ndërkaq në një vend të botës agjërohet në dhjetor, e në disa vende në gusht dhe në ditët më të gjata dhe të nxehta, kështu që edhe një herë do të agjërojmë në ditët e freskëta e të shkurtra e një herë do të agjërojmë në ditët e nxehta dhe të gjata.

Pasi që agjërojmë sipas kalendarit hënor, disa herë ne agjërojmë në dimër e të tjerët e disa herë në verë, e të tjerët dimrit, në disa raste në pranverë e në disa raste në vjeshtë dhe kështu me këtë mundësohet drejtësia.

Ummeti i Pejgamberit, i cili është dërguar mëshirë për botët, është mëshirë dhe aty ku bie nuk bën dallim as lokal e as nacional.

Fuqitë kapitaliste pabesimtare garojnë njëra me tjetrën në të ushqyer ose vdesin nga grykësia, kurse muslimani atyre u jep nashat se duke mos ngrënë dhe duke mos e përdorur ushqimin për të cilin ata garojnë, ushqimin dhe pijen e ndan dhe u ndihmon të varfërve.

Kur thuhet agjërim, disa mendojnë se kjo do të thotë të qëndruarit një kohë të caktuar i uritur. Pejgamberi a.s. thotë:” Allahu nuk ka nevojë për agjërimin e atij që nuk e braktisë rrenën” (Buhari, k, Sijam, hadithi no: 1783). Me këtë hadith tregohet se agjërimi nuk është vetëm largim fizik nga ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime, por ai shpreh largimin nga rrena, shpifja, përgojimi, pabesia dhe fjalë nga nënçmuse.

Pejgamberi a.s. agjërimin e porositi si një prej përgatitjeve për pengimin e amoralitetit në shoqëri (Buhari, K. Sijam . hadith No: 1786). Është lajmëruar se shejtani qarkullon nëpër gjakun e njeriut, se njeriun mund ta çojë në të këqijat dhe se me agjërim rrugët e tij mund të ngushtohen. (Ajn-ul-ilm Alijful Kari 1/170).

Individët e shoqërisë islame, që janë për të urdhëruar njerëzit në të mirë dhe për të ndaluar nga e keqja, kalojnë nëpër edukimin e largimit nga llokma haram dhe për të mos zgjatur madje edhe dorën llokmës hallall. Agjërimi i pengon të gjitha të këqijat që vijnë në trup dhe në tru nëpërmjet enëve të gjakut.

Ai vetëm e përgatit veten që të mos pëlqejë zinanë, por edhe bashkëshorten e vet ta përdorë në kohë të caktuar.

Ai është edukuar që me të mbrapshtën e dorës të shtyjë propozimet magjepsëse të cilat mund ta largojnë njeriun nga rruga e vërtetë.

Guri themeltar i sabrit është agjërimi

Ai ka gëlltitur gurin e sabrit kundër dhunës, fatëkeqësisë dhe brengave që mund t'i ngjajnë. Pejgamberi a.s. thotë: "Agjërimi është gjysma e sabrit" (Tirmidhi, K. Davud. 86), kurse për komandantin e caktuar për kontroll thotë: "Ky nuk është më i miri nga ju, por është më sabërlu nga ju" (Musned Ahmed b. Hanbel, 1/178).

Musliman është njeri që agjëron, që e gëlltit gurin e sabrit dhe atë e ka vendosur në të gjitha qelizat.

Muslimani me agjërim pastron edhe mëkatet që ndodhen në shpirtin e tij, si edhe sëmundjet dhe tepricat në trup. Pejgamberi a.s. thotë: "Çdo gjë ka zekat, e zekati i trupit është agjërimi" (Mehmeh-t tevail, 3/183).

Kushtet e agjërimit të Ramazanit

Kushtet e obligueshmërisë së agjërimit

Që një njeri ta ketë farz agjërimit, duhet t'i plotësojë këto tre kushte:

1. Të jetë musliman; ai që nuk është musliman nuk e ka farz agjërimit.

2. Të jetë i mençur; i çmenduri nuk e ka farz agjërimit.

3. Të jetë i ritur; fëmijët nuk e kanë farz.

Fëmijët të cilët dëshirojnë vetëm të agjërojnë, marrin sevabe si agjërimit nafile dhe kjo llogaritet si përgatitje për të ardhmen.

Kushtet e vlefshmërisë së agjërimit

1. Shëndeti fizik - të sëmurët, të cilëve doktori i besueshëm u thotë se ju nuk mund të agjëroni, pasi që të shërohen agjërimit e kaluar e bëjnë kaza. Nëse është tepër plak sa më nuk mund të agjërojë, atëherë paguan fitër (një ushqim ditor). Njeriu i shëndoshë i cili nuk agjëron sikur edhe me tonelata ar të paguaj, nuk mund ta paguajë borxhin e agjërimit.

2. Të jetë banor i rregullt. Njeriu që është në vend të tij ose është mysafir dhe ka vendosur që të qëndrojë 15 ditë ose më tepër.

Kur shohim një njeri që nuk agjëron, së pari mendojmë se ai është mysafir. Nëse nuk është mysafir do të themi se është i sëmurë. Nëse nuk është i sëmurë, atëherë do të shprehim qëllimin e mirë dhe do të themi se është i sëmurë dhe nuk do të themi se nuk është musliman.

Nuk është argument i mençurisë nëse një njeri që udhëheq ndonjë organizatë nuk duhet të agjërojë. Sepse, edhe robotët e

programuar nuk e bëjnë atë që është e nevojshme. Kurse mendje është ajo që e njih Krjuesin e saj.

Kushtet e kryerjes së agjërimit

1. Si kusht për agjërimitin e Ramazanit është nijeti. Edhe për agjërimitin e premtuar për kohë të caktuar dhe për agjërimitin nafile duhet bërë nijet, i cili mund të bëhet prej kur perëndon dielli deri në drekë. Nijeti për agjërimitin kaza dhe agjërimitin e premtuar në një kohë të pacaktuar, bëhet prej perëndimit të diellit e deri në imsak.

Në nijet qëllimi kryesor është nijeti me zemër, kurse shprehja me gojë është mustehab. Edhe ngritja në syfyr llogaritet nijet.

2. Pastrimi i gruas nga menstruacioni (hajzi dhe nifasi). Gratë në këto gjendje as falen as agjërojnë. Kurse, pas pastrimit, agjërimitin e tyre e bëjnë kaza, ndërkaq namazin jo.

Llojet e agjërimit

1. Agjërimiti farz: Kush i plotëson kushtet e obligueshmërisë që i përmendëm më lart për agjërimit, ai e ka farz agjërimitin në muajin e Ramazanit.

2. Agjërimiti vaxhib është agjërimiti i premtuar për shembull: “Nëse dikush premtton se nëse kjo punë e hajrit më realizohet do të agjëroj tri ditë”, në qoftë se agjërimit të premtuar i caktohet koha ai quhet premtim i caktuar (Muajjen Nedhir) dhe agjërimiti i saj është vaxhib. Nëse koha nuk është e caktuar, quhet premtimi i pacaktuar (Mutlak Nedhir).

3. Agjërimiti nafile është ai agjërimit që agjërohet në çdo kohë të vitit me përjashtim të ditëve të Bajramit. Gjithashtu është agjërimit,

sipas kalendarit hënor, dita e 13, 14 dhe 15 e çdo muaji, dita e ashures bashkë me një ditë pas ose para saj, agjërim i Davudit a.s., i cili një ditë ka agjëruar e një ditë jo. Ose agjërimi i rregullt i ditës së hënë dhe të enjtes, si dhe agjërimi i 6 ditëve të muajit sheval.

4. Agjërimi mekruh është agjërim i ditës së parë të Bajramit të Ramazanit dhe katër ditëve të Bajramit të Kurbanit, i cili është mekruh tahrir.

Agjërimi vetëm një ditë të ashures në mujin muharrem, vetëm ditën e premte ose ditën e shtunë, agjërimi ditën e parë të pranverës, Nevruz, e cila është një prej ditëve të shenjta të adhuruesve të zjarrit dhe agjërimi i ditë së vjeshtës, Mihrixhan, është mekruh tenzihen.

Vetëm agjërimi i agjëruarit që agjëron rregullisht nuk llogaritet mekruh.

Savmi Visal, pra është mekruh bashkimi i ditës së parë me të dytën pa prishur, pa bërë iftar.

5. Agjërimi Kefaret: Një musliman i mençur dhe i rritur që pa ndonjë arsye udhëtimi, sëmundje, detyrimi, harrese apo ndonjë arsye tjetër e prish agjërimin me vetëdie, si kefaret duhet të lëshojë një rob. Nëse nuk ka rob, duhet të agjërojë dy muaj pandërprerë. Nëse agjëron 55 ditë dhe një ditë e prish, duhet të agjërojë prej fillimit. Kurse gratë në kohën e menstruacioneve e ndërpret edhe e vazhdon kur t'i kalojë.

Në agjërimet e tjera, përveç agjërimin të Ramazanit, prishja e agjërimin nuk kërkon kefaret. Nëse njeriu duke bërë kaza agjërimin e Ramazanit e prish, nuk ka kefaret. Njeriu që është i obliguar me kefaret nëse përsëri ha, nuk obligohet me kefaret të ri. Ai që s`mund të bëjë kefaret për shkak të sëmundjes dhe moshës, obligohet t'i ushqejë mëngjes e mbrëmje 60 të varfër ose një të varfër 60 ditë.

Zekati

Kuptimi i fjalës zekat është shtim dhe pastrim i pasurisë së atij që jep. Trëndafili po të mos jepte aromë me bujari, nuk do të kishte mundur ta vazhdonte dhe ta shtonte gjenezën e vet dhe njerëzit nuk do t'i merrnin lulet për stoli nëpër kopshtet e tyre. Sikur lulja të mos i jepte bletës mjaltë me dëshirë, ajo nuk do të bëhej e plleshme dhe nuk do të vazhdonte gjenezën e saj.

Sikur nëna thelbin e saj të mos e shndërronte në qumësht të bardhë dhe t'i jepte fëmijës së saj, nuk do të shumëzohej.

Sikur druri i kumbullës lulen e tij me aromë dhe frutin e tij të mos e jepte, do të digjej në xhaqe dhe në një moment do të zhdukej.

Kur lulet japin aromë të mirë, dielli jep dritë dhe nxehtësi, fytyrat buzëqeshin, e në të kundërtën mërroleshin.

Të japësh për të mos u nxirë, tharë apo harxhuar, të japësh prej diturisë, dashurisë, përvojës, pasurisë dhe trupit tënd.

Një lule që vdes në vjeshtë dhe gjetet e drurit i bën qefin për vete në pranverë, bënë mijëra lule të reja. Në dhënie të shpirtit ka një vdekje e një ringjallje.

Çdo pjesë e trupit tonë i jep pjesës tjetër diçka, dora gjuhës, gjuha lugëthit, lugëthi thoit, thoi flokëve, flokët eshtrave edhe palcës, e palca trurit dhe nervit. Duke dhënë kështu, mundësohet vazhdueshmëria e ekzistimit.

Pejgamberi a.s. thotë: "Besimtarët me dashuri, mësim dhe merhamet janë një trup. Nëse në atë trup diçka është e sëmurë, pjesët e tjera shpejtojnë në ndihmë dhe i bashkangjiten pagjumësisë së trupit". (Buhari Edeb 27; Muslim, Birr, Hadith, 66; Musnedi Ahmed, 4/270-276).

Një dhembje në këmbë e shqetëson tërë tupin. Përsëri, për të qenë i rehatshëm i tërë trupi shpejton në ndihmën e këmbës, e ndan temperaturën nga dhembja.

Kjo ndarje është për rehatinë e atyre pjesëve. Në fakt ai që jep, jep për vete.

Ai që i jep para farmacistit, merr barna dhe me te e zbut ashpërsinë e venëve.

Edhe ai që jep zekat ose sadaka, shpërblehet që në këtë botë.

Pejgamberi a.s. njërit që e pyeti për ngushtësinë në zemër i thotë: "Lëmoje kokën e jetimit dhe ushqeje të varfërin" (Mez-xhen-ttevahidve men beal fevahid 8 160).

Pra ata që japim, nuk mbetet pa shpërblim. Por, shpërblim jep vetëm Allahu xh. sh.

Shpërblim për atë që jep janë edhe të gëzuarit dhe të kënaqurit.

Kur farmacistit i jep para dhe merr barna, atë nuk mund ta detyrosh të të falënderojë, pra njeriut të nevojshëm i jepni dhe i merrni shpërblimin dhe nuk ka më vend për falënderim.

Zoti thotë: "O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja duke u krenuar e duke ofenduar..." (Bekare 264).

Në fakt kur japim, nuk japim prej pasurisë sonë. Edhe gjërat për të cilat pretendojmë se janë tonat si: dora, këmba, syri, zemra nuk i kemi komplet. Ato plaken dhe sëmuren pa dëshirën tonë. Sikur t'i kisha komplet, nuk do t'i lija të plaken dhe të sëmuren. Të gjitha këto trgojnë se ato janë nën sundimin e dikujt tjetër.

Pasi që plotësisht nuk mund t'i kemi as në dorën e as në trurin tonë, atëherë për pasurinë që e fitojmë me to, si mund të pretendojmë se e kemi? Për këtë Zoti duke i përkufizuar besimtarët thotë: "Ata japin prej rrizkut që u kemi dhënë Ne" (Bekare 4). Pra treguam se pronësinë që e kemi na e ka dhënë Zoti dhe se nga ajo duhet të ndajmë diçka.

Ai është Allahu që baltën e shndërron në drith, tokës së zezë i jep mijëra ngjyra, natyrën e stolis me lule të ngjyrave të ndryshme. Njeriu që gruas së tij i jep një tufë lule, ai i jep një rob të Allahut, kështu ai edhe në dynja fiton lumturi edhe në ahiret xhe-

nnet. Allahu, hakun e Tij me hakun e njerëzve i përmend një pas një: “Fale namazin dhe jepe zekatin” (Bekare, 43).

Urdhri “jepe zekatin” sinjalizon që çdonjëri të punojë për pasuri dhe të japë zekat.

Juristët islamë, të cilët mendimet i nxjerrin prej Kur'anit dhe sunnetit, i kanë përcaktuar vendet ku duhet të jepet zekati, rregullat e grumbullimit dhe llojet e pasurisë për zekat prej 2,5 % e deri në 20%.

Zekati është një ibadet që është njëri prej pesë themeleve të islamit. Namazi është ibadet që bëhet me trup, kurse zekati bëhet me pasuri.

Zekati e thyen idhujtarinë e pasurisë, e cila e ka mbyllyr rrugën që çon te Zoti. E gris perden mes tij dhe Zotit dhe perden e zezë që pengon afrimin e njerëzve dhe afrimin e tij te njerëzit.

Zekati është shembulli më i mirë për bashkimin e shtetit me popullin.

Juristët islamë pasurinë për zekat e ndajnë në dy grupe: pasuri të qartë dhe të fshehtë. Zekati (pasuria e qartë) (prodhimet bujqësore dhe kafshët) duhet t'i jepen shtetit, kurse pasuria e fshehtë (pasuria e parave, tregtive dhe prodhimit) duhet t'u jepet njerëzve të denjë.

Kështu shteti do të arrijë atje ku nuk arrin dot populli, kurse atje ku nuk arrin shteti do të arrijë populli. Njeriu duke filluar prej më të afërmit të vet, fqinjit më të afër e deri te muslimani më i largët i botës do ta shtrijë dorën e ndihmës.

Zekati që është edhe tatim edhe ibadet, ka specifika që dalin nga ligjet e fitimeve botërore.

Së pari, ky është nderi i Allahut e jo i njeriut. Njeriu që beson në tatimin e zekatit është besimtar, kurse mohimi i tij është pabesim (kufr).

Ne i shohim njerëzit që shfrytëzojnë zprazëtitë e ligjeve të njerëzve dhe nuk ndejnë përgjegjësi për tatimet që i kanë, sepse ajo s'ka të bëjë me imanin. Edhe pse është caktuar për kontrollimin e kontrabandës, ai është njeri dhe fsheh me miliona raste ryshfeti.

Besimi islam me anë të edukimit, njeriun e përgatit mirë dhe atij i beson, saqë dhënien e zekatit për pasurinë e fshehtë ia lë atij.

Sot edhe muslimanët të cilët nuk e kanë orgjinalitetin e Islamit, por e ndjejnë veten në emrin dhe pamjen e tyre, e japin zekatin nga dashuria për islam.

Kushtet e zekatit

1. Musliman, 2. I lirë. 3. I mençur, 4. I rritur dhe 5. Sasi e nisabit (ajo është diçka më tepër se ushqimi, pija, vendbanimi, teshat verore dhe ditore, orenditë shtëpiake, transporti, mjetet profesionale, librat dhe armët), 6. Pasuri që shtohet, 7. Pasuri që ka qëndruar një vjet. Në këto raste zekati bëhet farz.

Sipas jurisprudencës islame njeriu nuk e ka borxh të japë zekat për shtëpinë që e ka, për rrogën mujore që e merr si punëtor apo nëpunës, për librat që i lexon, për armët dhe për makinën që e përdor. Edhe libri edhe arma që e mbrojnë shtetin prej armikut nuk kanë zekat.

Nisabi është shkaku i zekatit

Një njeri musliman, i mençur, i lirë dhe i ritur e ka për borxh që, përveç nevojës së domosdoshme për argjend, të japë zekat dyqind dirhem ose për njëzet mithkal ar apo dyzet dele ose dhi ose për pesë deve ose për tridhjetë lopë ose buaj.

Zekati është farz edhe për gjërat tregtare me vlerë prej njëzet mithkalë ar (92 gram), për pasurinë që prodhohet po në atë sasi në fabrikë, për të ardhurat e pasurisë së patundshme (apartamenti me qira, dyqani, hoteli apo moteli i dhënë me qira), për xehet e

nxjerra prej toke ose deti (hekur, ar, argjend, gaz), për senetin, çekun, ndryshimet (transfromimet).

Zekati i pasurisë tregtare me vlerë prej njëzet mithkal ar (92 gram), i senetit, çekut dhe pasurisë së prodhuar është $\frac{1}{4}$.

Kur kjo llogaritet, mblidhet edhe vlera e pasurisë tok dhe nga e tëra nxirret ajo që jepet, kurse nga ajo që mbetet jepet një e dyzeta.

Zekati i deleve dhe i dhive

Delet ose dhitë duhet të jenë dyzet. Nëse janë më pak se dyzet ose tridhjetë e nëntë zekati nuk u takon.

Në 40 deri në 120 dele ose dhi jepet 1 dele ose një dhi

Në 120 deri në 200 dele ose dhi jepen 2 dele ose dy dhi

Në 200 deri në 399 dele ose dhi jepen 3 dele ose tre dhi

Në 400 dele ose dhi jepen 4 dele ose katër dhi.

Pas kësaj në çdo njëqind jepet një dele ose një dhi.

Zekati i llojeve të gjedheve (kafshëve)

Në llojin e gjedheve bën pjesë edhe bualli. Nëse janë më pak se 30 copë gjedhesh, nuk ka zekat.

Në 30 deri në 40 jepet një viç njëvjeçar.

Në 40 deri në 59 jepet një viç dyvjeçar.

Në 60 deri në 69 jepen dy viça njëvjeçar.

Në 70 deri në 79 jepet një viç dyvjeçar dhe një njëvjeçar.

Pas kësaj llogaritet në çdo tridhjetë një viç njëvjeçar ose në çdo dyzet një viç dy-vjeçar. P.sh. në 120 copë, sipas llogarisë nga tridhjetë, jepen 4 nga njëvjeçar ose në dyzet jepet 3 nga dyvjeçarë.

Zekati i deveve

Në më pak se pesë deve nuk ka zekat. Prej 5 deri në 24 deve, në çdo 5 deve zekat jepet një deve apo një dhi.

Prej 25 deri 35 deve jepet një deve dyvjeçare.

Prej 35 deri 45 deve jepet një deve që ka hyrë në moshën 3 vjeçare.

Prej 61 deri 75 deve një deve që ka hyrë në moshën 5 vjeçare.

Prej 76 deri 90 deve jepet dy deve që kanë hyrë në moshën 3 vjeçare.

Prej 91 deri 120 jepet dy deve 4 vjeçare.

Prej 120 e më lart bashkë me dy deve 4-vjeçare, pas 120 deri në çdo 5 deve jepet një deve ose një dhi.

Kurse edhe në zekatin e devës është regull që të jepet në një në dyzet, por kjo regull si nisab vlen nëse devetë janë me vlerë. Kur thuhet se në 200 deve jepet 5 deve që kanë hyrë në moshën 3-vjeçare, kuptohet se në dyzet jepet një.

Zekati në para, senet, çek dhe në transformim

A ka zekat paraja që jepet me kamatë? Nuk është e thënë. Harami është diçka tjetër. Kurse hallalli diçka tjetër. Kamata është haram. Ndërkaq paraja bazë, për të cilën jepet kamatë, është hallall. Prandaj zekat duhet të jepet për paranë bazë.

Për paranë për të cilën nuk ka shpresë për kthim, nuk ka zekat.

Zekati i gjërave tregtare

Shteti dhënie e zekatit të gjërave tregtare ia ka lënë pronarit të pasurisë. Pronari jep në emër të shtetit. Që një magazinë këpucësh, një manufakturë apo një firmë ndërtimi të japë zekat, duhet të llogaritë gjërat në dyqan ose investimin për ndërtimtari. Llogarinë e bën sipas vlerës së asaj dite (date) që e ka blerë e jo me vlerën e asaj dite që e shet.

Investimi 10.000.000

Paratë 5.000.000

Ajo që mund të merret 5.000.000, shuma 20.000.000. Ky musliman që ka kapital prej 20.000.000 nëse 10.000.000 i ka borxh, pra pasuria është 20.000.000., kurse borxhi 10.000.000. atëherë zekati jepet për 10.000.000. Nga kjo zekati është “ $10.000.000 \times 2.5/100 = 250.000$ ”.

Vendet ku duhet të jepet zekati

Allahu xh.sh. caktimin e zekatit ia ka lënë Pejgamberit a.s., kurse vendin se ku duhet të jepet e ka caktuar në Kur'anit Kerim: ”All-llahu caktoi obligim që lëmosha t'u takojë vetëm: të varfërve, të ngratëve, punonjësve, atyre që duhet përfituar zemrat, e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe. Në rrugën e All-llahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. All-llahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së vet” (Tevbe, 9/60).

Sigurimi social në Islam është i mundur me anë të organizatës së zekatit. Fitreja, sadakaja dhe për kefarete. Sadakaja i përket vullnetit të njeriut. Por, me të bëhet farzi i zekatit, pra siguria shoqërore nuk është lënë në ndërgjegjen e muslimanëve, por është themeluar nga ana e shtetit.

Ata të cilët edhe pse kanë mundësi të punojnë, nuk mund të gjejnë punë, ata të cilët nuk kanë fuqi për punë, si pleqtë, fëmijët dhe njerëzit që kanë nevojë për përkujdesje futen në grupin e gjërave dhe të të varfërve, kurse sigurimin për një jetë normale në shoqëri e marrin prej argumentit jetësor të zekatit.

Edhe nëpunësit në organizatën e zekatit e marrin pagesën prej parave të zekatit.

Me zekat duhet ndihmuar të dobët, me qëllim që të forcohen më shumë zemrat. Atyre që u bie zekati janë: ata që sapo kanë hyrë në Islam, ata që shpresojnë në Islam, ata që në marrëdhëniet ndërkombëtare i përmbajnë muslimanët ose dëshirojnë t'i përmbajnë, prej zekatit ndihmohen edhe ata që ofrohen në Islam ose ata për të cilët shpresohet se do ta ndihmojnë Islamin. Këta edhe nëse janë të pasur, nuk është pengesë që t'u jepet zekat.

Ndërprerja e këtij institucioni, pra pagesa nga zekati për këta njerëz, në periudhën e Hz. Omerit është bërë për shkak se muslimanët kanë qenë të fortë dhe nuk kanë pasur nevojë për ta. (Suneni Bejhaki, 7/20).

Sot zekati mund të jepet edhe për ata që u bëjnë dhunë muslimanëve, me qëllim që dhuna të marrë fund. Mund të jepet edhe për të penguar botimin e lajmeve kundër muslimanëve nga ana e agjencive ndërkombëtare botuese dhe për të fituar mbështetje prej tyre.

Sklevërit

Sot koncepti romak për sklevërinë është shndërruar në skllavëri moderne. Pejgamberi a.s. i cili ka treguar për sevabet që fitohen me rastin e lirimit të skllavëve dhe në momentin e vdekjes ka kërkuar që ndaj skllavëve të sillemi mirë, i ka liruuar me mijëra njerëz në Meke dhe Medine.

Fondi i sotëm për lirimin e sklevërve mund të pëdoret edhe për blerjen e robërve të luftës dhe për kthimin e tyre ne familje.

Borxhlinjtë

Në një shoqëri islame garancia nuk i takon vetëm bankave dhe shoqatave të caktuara, por edhe individëve. Çdo individ ka garancinë e shtetit. Edhe borxhliu edhe ai që ka marrë para është i garantuar nga shteti.

Populli që do të bëjë tregti, do të hyjë në borxh. Atij do të jepet borxh, ose do të bëjë tregti me hua.

Ndërkaq, shteti është garantues i tyre, ashtu që nëse njeriu devalvon, e mbulon inflacioni, borxhi i tij paguhet nga fondi shtetëror i zekatit. Njeriu i sotëm këtë mund ta kundërshtojë. Mund të thuhet se ka shumë që fitojnë miliona dhe miliarda me inflacione mashtruese.

Në një shoqëri e cila është e zhvilluar sipas sistemit amerikan, sistemi islam nuk mund të praktikohet. Së pari asaj shoqërie i bëhet i ditur Islami. Ai që e di Zotin, e do edhe sistemin e Tij dhe ndaj robërve të Tij sillet ashtu si do Zoti.

Ata që kanë mbetur në rrugë

Feja islame ata të cilët kanë mbetur në rrugë, që nuk kanë para për të shkuar në vendin e tyre, nuk i detyron të lypin lëmoshë përpara stacioneve, garazhave, xhamive nëpër rrugë etj.

Islami për ata ndërton hotele për banim. Nuk dëshiron që të ndershmit e vendit të tyre të përbuzen në vende të huaja. Çdo anë e shtetit është vend i tij. Në çdo anë ka shtet. Ai askund nuk do ta shtrijë dorën. Ai zekatin që e ka dhënë në vendin e vet, në kurbet

nëse detyrohet, do ta marrë. Për këtë përbuzja e njeriut nuk vjen parasysh.

Pejgamberi a.s. ka thënë: "Zekati është ura e Islamit" (Keshfu-l Hafa, 1/439, taberiden naklen). Një urë që është ndërtuar prej xhepi në xhep. Një urë e ndërtuar prej bote në xhennet.

Feja islame sasinë e nisabit të zekatit dhe të sadakasë e ka caktuar në gjërat me vlerë dhe jo në gjërat që humbin vlerën.

Ari, argjendi, lopa, delja, dhia dhe deveja janë gjëra që gjithkund e mbajnë vlerën e tyre. Edhe rrushi, hurma, drithërat (gruri dhe elbi) që janë caktuar për sadakatul fitër, vlerën e tyre e mbrojnë gjithmonë dhe sasia që do të jepet duhet të jenë gjëra që do ta ngopin të varfërin një ditë. Një sadakatul fitër është ushqim ditor i të varfërit. Shoqëria islame, e cila nuk di për grurin, rrushin, elbin dhe për hurmën, sadakatul fitrin do ta paguajë prej materieve me të cilat ushqehet vetë, kështu që me kalimin e kohës jurisprudenca islame nuk mund të tejkalohet.

Sadakatul fitri

Siç që u përmend në pjesën e zekatit, një njeri që ka pasuri prej njëzet mithkalë ar (92 gram), që është jashtë nevojës ditore, e ka vaxhib të japë sadaka. Njeriu që e ka vaxhib sadakanë, vaxhib e ka që sadakatul fitër të japë edhe për fëmijët e parritur.

Njeriu zekat ose sadekatul fitër nuk mund t'i japë gruas, burrit, nënës, babait, gjyshit dhe më lart, djalit, vajzës dhe më poshtë. Të tjerëve mund t'u japë.

Koha që është vaxhib për sadakatul fitrin është mëngjesi i ditës së Bajramit të Ramazanit. Por sadakatul fitri mund të jepet edhe në Ramazan edhe pas tij. Megjithatë më mirë është që të jepet për nevojat e tvarfërve për Bajram.

Haxhi

Kushtet e obligueshmërisë (farzet) së haxhit

Muslimani që thotë se jam musliman, por nuk fal namaz, nuk mba agjërime dhe nuk shkon në haxh është sikur njeriu që thotë se i dua shokët e mi, kurse në ditët e vështira jep mend e nuk jep para.

Ummeti i mëshirës i Pejgamberit a.s. i cili është dërguar në realitet për njerëzit, i ka pranuar si fëmijë të një babai dhe të një nëne.

Toka e cila është pronë e Krijuesit është një vend për shfrytëzim të përkohshëm dhe lavër e ahiretit. Ai që e ndërton dynjanë beson se do ta ndërtojë edhe ahiretin.

Ata besojnë në nderimin, në bazë të rregullave të Zotit, të fëmijëve të Ademit a.s. dhe të Hava r.a. dhe se duke nderuar Zotin dhe popullin, bota do të bëhet xhennet.

Në mesin e njerëzve, të cilët mëshirën e Zotit e kanë bartur prej bregdetit të Fildishtë e deri te ishujt Fixhi, prej Japonisë e deri në Laponja, nuk kanë dallim mes japonezitet, kinezitet, romitet, turkut të ziut, amerikanitet, rusitet, arabitet, bullgaritet, shqiptaritet. Muslimani i mençur i rritur dhe i lirë, nëse ka mundësi të shkojë deri në Mekke, të sigurojë ushqim për rrugë dhe mjet për udhëtim, e ka farz që një herë në jetë ta kryejë haxhin, kështu që besimin që e shpreh me gojë, e vërteton me zemër, e argumenton edhe me trup dhe me pasuri.

Kushtet për kryerjen e haxhit

Gjërat që e pengojnë obligueshmërinë e Haxhit:

1. Verbëria dhe sëmundjet, si paraliza
2. Burgimi dhe gjërat e ngjashme me të
3. Siguria në rrugë.

Ndërkaq për gratë:

4. Afër tyre duhet të kenë bashkëshortët e tyre ose ata me të cilët gjithmonë e ka haram të marrohet.

5. Gruaja e cila burrin e ka të vdekur ose është e lëshuar dhe e ka përfunduar kohën e pritjes (iddet).

Një musliman që i ka këto kushte në vetveten e tij, së pari e bën llogari vetveten.

Unë fitova një trup të shëndoshë, fëmijë me aromë xhenneti, një grua të mirë që shtëpinë e saj e ka bërë xhennet, kam fituar para dhe pasuri që mund të shpërndahet rreth e përçark, në praninë e Zotit tonë janë gjërat që unë i kam mbledhur me fuqinë e fituar nga ana e Tij.

Mirë pra çfarë kam bërë unë me pasurinë e tij dhe për fenë e Tij? Sa zemra dhe balle të njerëzve kam drejtuar kah Qabeja ku do të bëj tavafin.

Duke u rrotulluar në rreth Qabes me fjalët Allahu ekber (Allahu është më i madhi), shteteve superiore që krenohen me madhësinë e tyre, aspak nuk u shkon ndër mend se në mesin e miliona njerëzve sa njerëz ka që jam bërë shkak i udhëzimit të tyre.

Mirë nëse unë shkoj në haxh dhe deri sa të kthehem, kush është ai që do të vazhdojë shërbimin islam? Muslimanët për lëvizjet nga vende të ndryshme, kur do të tregojnë për lëvizjet islame në vendet e tyre, unë çfarë levizjesh të shpjegoj? Me çfarë shërbimi mund të dal përpara Pejgamberit a.s.?

Unë, që vij prej vendeve ku ka shkelur këmba e sahabëve, si nga Stambolli, Kairoja, Siria, Bagdati, Kufeja, Atje duhet treguar për gjendjen e muslimanëve që jetojnë në vendet e nderuara me

Islam dhe se te Allahu duhet shkuar me zemër të hapur dhe ballë-lartë.

Pastaj të ulemi me familjen dhe t'u flasim për se jemi krijuar, se fëmijët janë një tufë me lule dhe me kohë ujiten, se një kohë në këto vende kanë qenë paraardhësit tanë, kurse tash ata janë të detyruar të shpërngulen tjetërkund, se edhe ne një ditë do të shpërngulemi, se përveç qefinit asgjë nga kjo botë nuk do të mund të marrim me vete, pos besimit dhe punës së mirë (amelun salihun) që nuk do të ndahen nga ne.

Edhe haxhi është njëra prej punëve të mira dhe se atë duhet t'ua tregoni edhe bashkëshortes edhe fëmijëve tuaj. E përkujtoni se ai është edhe dhënës i pasurisë edhe udhëzues i haxhit,

Pastaj takohesh me të afërmit e familjes. Aty përfitohet zemra e tyre dhe kërkohet duaja për ta. Nëse ka ndonjë hak (borxh), atë e kthen edhe merr hallallëk.

Pastaj shihesh me fëmijët dhe të njohurit, ashtuqë pas kthimit të borxheve dhe pas hallallëkut fillon rruga vetë ose bashkë me karavanin.

Sikur që gjatë tërë jetës nuk ke qenë barrë e dikujt, edhe rrugën për në haxh mos iu bën barrë askujt. Kurse, sa të kesh mundësi mundohu që barrën e bashkudhëtarëve ti ta marrësh mbi vete.

Brengën që mund të lindë prej lodhjes në rrugë shokët mund ta kthejnë në zënkë. Asnjë fjalë të keqe mos ndëgjo dhe një lëvizje të papëlqyeshme mos shiko. Mos e prish zemrën, mos e demoralizo askë dhe gjithmonë thuaju unë kamë faj, e tjetri s'ka faj.

Gabimet që bëhen në çështjet fetare pranoji me buzëqeshje dhe me gjuhë të ëmbël. Gjatë rrugës në qytete të ndryshme vizitoj banorët e tij, e sidomos vizitoi dhe takohu me dijetarët, të cilët nuk flenë edhe natën. Me njerëzit e vendeve ku do të banoni, silluni mirë, që e mira juaj nëpër gojat e tyre të përtypet sikur sheqeri.

Mikati

Kur të arrihet në vendin e quajtur mikat, i cili është vendi ku është haram të kalohet pa ihrame, priten thonjtë (sunnet), shkurtohen flokët (sunnet), hidhen teshat dhe shenjat që simbolizojnë pozitë, karrierë apo ndonjë dallim tjetër social. Haxhiu bën banjo (sunnet), ose merr abdest (sunnet) dhe e vesh ihramin (farz). Kurse veshja e ihramit në mikat është vaxhib.

Ai i cili e kalon mikatin pa ihram, për të ka dënim të therrë një dele ose një dhi. Nëse kthehet dhe në mikat e vesh ihramin, nuk ka dënim.

Me veshjen e ihramit bëhet nijeti dhe duaja: Allahumme inni uridu-l haxhxhe fe jessirhu li ve tekabbelhu minni (O Allahu, im unë dua ta bëj haxhin. Ma lehtëso mua dhe pranoje atë prej meje). Ata që dëshirojnë të bëjnë vetëm umre, thonë: "O Allahu, im dua të bëjë umre".

Ata të cilët dëshirojnë të bëjnë haxh Temettu`, nijetin e bëjnë për umre, sepse ata për haxh ihramin e veshin përsëri.

Kurse ata që dëshirojnë ta bëjnë haxhin kiran, nijetin dhe lutjen e bëjnë kështu: "O Allahu im, unë dua të bëj umre dhe haxh, këto mi lehtëso mua dhe pranoji prej meje".

Pas nijetit, nëse nuk ka kohë keraheti, falen dy rekate namaz. Ne rekatin e parë pas Fatihasë lexohet sureja Kafirun, kurse në rekatin e dytë pas Fatihasë lexohet sureja Ihlas. (sunet).

Muslimani, i cili me qethjen dhe banjon (abdestin) që bën, me teshat që i nxjerr dhe e vesh ihramin, nga vetja e largon dallimin shoqëror, me namazin që e fal me suren Kafirun dhe ihlas, me gojë, zemër dhe me trup vërteton se me sistemin e kafirit nuk ka asnjë marrëveshje dhe se asnjëherë ajo nuk mund edhe të ndodhë dhe se ai bazohet vetëm në Allahun, fenë e të cilit do ta jetojë.

Si pëgjigje urdhërit të Allahut që ia bën Ibrahimit a.s.: "Njerëzit thirrni për në haxh" (Haxh, 27), dhe thirrjes së Ibrahimit a.s., i cili prej kohës së Ebu Kubajs ua thotë haxhinjve që kur të fillojnë nga mikati të thonë: "Lebbejke Allahumme lebejke, Lebbejke La

sherike Leke Lebbejk inne-l hamde v-nnimete ve-l Mulk La Sjeri-he leke”.

O Allah, thirrjes sate përsëri dhe përsëri i përgjigjem. Edhe para Teje për të zbatuar çdo urdhër Tëndin. O zoti im, e kam për borxh që t’i përgjigjem çdo thirrjeje Tënd. Ti në autoritetin Tënd nuk ke as shok, as ortak. O Allahum im, me tërë qenien time të jam drejtuar Ty, falënderimi të takon vetëm Ty. Nimeti është Yti, dhe pasuria është e Jotja, në të gjitha këto shok dhe ortak nuk ke). Haxhilerët këtë telbije gjatë rrugës e thonë shumë herë.

Gjatë udhëtimit mundësisht duhet ndalur në vendet ku ka qenë Pejgamberi a.s. Kështu duke menduar se në çfarë kushtesh të vështira Pejgamberi a.s. e ka kryer misionin e tij dhe ka bërë çlirime, se nëpër ato shkretëtira që vështirë është udhëtimi edhe me autobus, sa ka qenë vështirë për ata që kanë ecur në këmbë ose me deve dhe në fund hyhet në Mekke.

Në Mekke, pas lënies të teshave në vendin e caktuar për banim, merret gusul ose abdest (sunnat) dhe menjëherë shkohet në Qabe.

Kur hyn në haremi sherif, ndërpritet telbija. Kur e sheh haremin për herë të parë, thuhet kjo dua “O Allahu im, pranoji nga unë lutjet e hajrit që i kam deri tash dhe ato që do t’i bëj në të ardhmen”.

Nga frika e adhurimit të Qabes ndërpritet telbija dhe vazhdon tekberi: “Allahu Ekber, Allahu Ekber (Allahu është më i madhi).

Përkujtohet se Qabja është shtëpia e parë e ndërtuar në tokë, se ndërtuesit e saj janë Ademi a.s. dhe Ibrahim i a.s. me të birin e tij, Ismailin a.s.

Qabja dallon nga monumentet e piramidave të cilat për tridhjetë vjet i ndërtojnë një qind mijë robër, sepse ajo nuk është ndërtuar me gjakun dhe djersën e të shtypurve, por është ndërtuar me duart e bekuara të dy pejgamberëve. Nga të katër anët e botës vijnë njerëz drejt saj, rreth saj rrotullohen si flutura, kurse njeriun e zhyt në detin e saj shpirtëror.

Aty fshihet praktika e të jetuarit me Hakun brenda në popull, kurse me popullin përpara Hakut.

Tavafi kudumi (sunnat)

Tavafi Kudumu fillon prej Haxher`ul Esvedit (vaxhib). Në tri rrotullimet e para bëhet Remel (sunnat) (ecje me krenari dhe shpejt). Në këtë tavaf bëhet izdiba (sunnat). (Pjesa e sipërme e ihamit e krahut të djathtë hidhet mbi krahun e majtë, kurse krahu i djathtë mbetet i zhveshur). Nëse në Tavafi Kudum bëhet Izdiba, në tavafet tjera nuk ka nevojë.

Nëse këta mijëra njerëz të ndryshëm të popujve dhe të gjuhëve të ndryshme mësojnë t'i përmbahen një vendi të caktuar (Haxher`ul Esvedi) dhe të rrotullohen rreth një qëllimi, kur të kthehen në vendlindje, muslimanët e vendeve të ndryshme fillojnë t'i realizojnë qëllimet e njëjta.

Pas tavafi kudumit në një vend të përshtatshëm pas Mekami Ibrahimit falen dy rekate namaz (vaxhib).

Pastaj shkojnë te vendi ku është Zemzemi, të cilën Zoti e ka nxjerrë nga toka me mundimet dhe dëshirën e Ismailit a.s. Nëse kanë mundësi, derdhin ujë edhe mbi kokën e tyre.

Njeriu sheh se prej Ismailit a.s. sot ka mbetur si bunar uji i vetëm. Gjithashtu ady përkujton se deri më sot janë bërë shumë gropa që janë tharë, por Zemzemi nuk është tharë dhe kështu haxhiu e falënderon pronarin e ujit.

Nëna jonë, Haxherja, e cila është përgatitur për djalin e saj, vrapon dhe del në kodrën Safa, kurse drejt Merves bën saj` (vaxhib), mes dy shtyllave të gjelbërta bën hervele (ecje të shpejtë) (sunnat).

Me njerëzit që vijnë prej vendeve të ndryshme të botës mësojnë të vrapojnë drejt një caku. Nëse dëshirojmë Safanë dhe Mervenë, mund ta bëjmë pas cilit tavaf dëshirojmë.

Deri në ditën e tetë të dhulhixhes mbeten në Mekke dhe mundohen që pesë kohët e namazit t'i falin në Qabe dhe të bëjnë tavaf sa të duan.

Pasi të lindë dielli i ditës së tetë, shkojnë në Mina (sunnet), duke u vendosur afër Mesxhidi Hajfit (sunnet) dhe atë natë e kalojnë në Mina.

Ditën e nëntë të dhulhixhes, pasi të lindë dielli, nisen për në Arefat (sunet), shkojnë në Mesxhidin Nemira, aty dëgjojnë hutbenë për atë se ç'duhet bërë gjithë kohën haxhilerët e botës dhe kështu mësojnë se qëllimi dhe pikësynimi i të gjithë muslimanëve të botës është arritja bashkë dhe me qëllime të njëjta. Me njerëzit me të cilët nuk mund të bisedojnë, kuptohen me gjendjen e tyre.

Këtu namazi i drekës dhe i ikindisë falen në kohën e drekës me një ezan dhe me dy ikamete. Deri në perëndimin e diellit qëndrojnë në Arefat dhe gjithnjë bëjnë dua. Nga ky qëndrim (sunnet) mësohet se vetëm përpara Allahut mund të qëndrohet dhe, përveç Tij, përpara asnjë krijuesi tjetër nuk mund të qëndrohet.

Pas perëndimit të diellit fillon rruga për në muzdelife (sunnet) dhe vendosen afër Mesh`ari Haramit (sunnet). Pas namazit të jacisë, falet akshami dhe jacia bashkë me një ezan dhe dy ikamete (vaxhip), natën e kalojnë në muzdelife (sunnet) dhe nesër në mëngjes çohen herët. Në Mina i mbledhin gurët që do t'i hedhin kundër shejtanit. E falin namazin e sabahut dhe aty qëndrojnë deri në agim (vaxhib).

Ditën e dhjetë të dhulhixhes para lindjes së diellit fillojnë rrugën për në Mina dhe vendosen në anën e Mesxhidi Hajfit. Në këtë ditë gjuajnë në Xhemrei Akabe (shejtani i madh) 7 gurë (vaxhib).

Hedhja e gurit në një vend nga ana e miliona muslimanëve na mëson se armiku ynë është një, se fisheku duhet të hidhet jo njëri-tjetrit, por dhunës dhe atyre që krijojnë dhunë.

Nëse bëhet haxhi temettu ose kiran, theret Kurban (vaxhib). Ky është vendi ku tuboheshin armiqtë e Pejgamberit a.s. dhe merrnin vendime kundër tij. Haxhiu këtu ndalet, pra qëndron sikur pi sherbetin e falënderimit për fitore. Mendon se aty është

ndalur për të përhapur drejtësinë në vendet ku rrijnë ata të cilët marrin vendime kundër muslimanëve në çdo skaj të botës.

Prej aty kalon në Mekke ku e bën tavafi Zijaretin (farz), pastaj kalon në Mina ku rri tri net. Çdo ditë pas dite hedh nga 21 gurë dhe kështu derisa t'i hedhë 70 gurë dhe pastaj kthehet në Mekke.

Ndalesat duke qenë me ihram

Kur je me ihram ndalohen:

1. Marrëdhëniet intime me bashkëshorten ose fjalët dhe sjelljet që nxisin marrëdhënie intime.
2. Grindja me njerëzit rreth e për qark.
3. Shkurtimi i flokëve, mjekrës dhe mustaqeve.
4. Prerja e thonjve.
5. Mbulimi i kokës me çfarëdoqoftë mbulese.

Umre

Pas përgatitjes së kushteve të nevojshme në Mikat, ashtu si përmendëm më lart, bëhet nijëti për Umre. Pastaj shkohet në Harem Sherif dhe pas tavafit për Umre falen dy rekate namaz, e pas sajit mes Safa dhe Mervesë, haxhiu qethet dhe del prej ihrameve.

Për atë se ç`duhet bërë në Mikat deri në plotësimin e sajit, lexo në pjesën për haxhi ifradin.

Haxhi Temettu

Kur hy në ihram në Mikat bën nijet për umre. Pas umres, qethesh dhe del prej ihramit.

Ditën e shtatë ose më herët të dhilhixhes përsëri e vesh ihramin dhe e kryen detyrën për në haxhi ifrat, sikur që u përmend më lart.

Vetëm se ai që bën haxh Temettu` kur ta gurëzojë shejtanin e mandej të ther kurban, qethet dhe lirohet prej ihramit.

Haxhi kiran

Siç u shpjegua në Haxhi Ifrad, në Mikat bëhen ato që janë të nevojshme dhe nijeti bëhet për umre dhe haxh. Së pari bëhet umreja, pas së cilës nuk dilet prej ihramit. Ditën e tretë të dhilhixhes kalohet në Mina, kurse në vazhdim vepron në haxhin ifrad, vetëm se pas gurëzimit të shejtanit të madh therrë kurban, qethet dhe lirohet prej ihramit.

Vizita Pejgamberit a.s.

Pas haxhit vjen në Medine Munevvere dhe e viziton Pejgamberin, Muhammedin a.s. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që më viziton mua pas vdekjes sime, është sikur të më vizitojë në të gjallë”, ”Për atë që e viziton varrin tim, shefaati im bëhet vaxhib”, ”Ai që bën haxh dhe mua nuk më viziton, më ka lënë në vuajtje”, (Shevkani, Nejlul Evtar, 5/95), por të kërkosh shefaatin e Pejgamberit a.s. bëhet banjo ose merret abdest, vishen tesha të bukura, përdoren erëra të bukura dhe ashtu i pastër nga pisllëqet fizike e shpir-

tërore shkohet te xhamia e Pejgamberit a.s. Hyhet në derën e quajtur Babu-s Selam. Nëse nuk është kohë keraeti falen dy rekate namaz Tahijat`ul Mesxhid” (përshendetje e mesxhidit), mundësisht ky namaz falet ndërmjet varrit të Pejgamberit a.s. dhe minberit, pastaj ndalen në vendin ku ka ecur këmba e Pejgamberit a.s. prej ku Pejgamberit a.s. i çohet shumë salavate dhe selame.

Prej aty kalohet te varri i Ebu Bekrit (r.a), i cili gjendet në anën e djathtë të Pejgamberit a.s. dhe bëhet dua për vete dhe për të. Aty lutet edhe për fitimin e sinqeritetit, bujarisë dhe besnikërisë. Në anën e djathtë të tij qëndron Omeri (r.a). Këtu haxhiu lutet për t’iu dhënë cilësitë e Omerit si përhapës i Islamit, thyes i idhujve, i trishtueshëm kundër armiqve dhe i mëshirshëm karshi besimtarëve. Gjithashtu i lutet Zotit edhe për Ebu Bekrin dhe Omerin, për fqinjët e Pejgamberit a.s.

Gjatë kohës kur qëndron në Medine namazet i fal në Mesxhidi Nebi, sepse një namaz që falet aty, sipas asaj që tregon Pejgamberi a.s., përveç në Mesxhidi Haram, është më i vlefshëm se një mijë namaze. (Buhari, 1/57).

Në Medine e vizitojnë Mesxhidi Kuban, Xhennetu`l Bakin dhe dëshmorët e Uhudit.

Redaktor gjuhësor: dr. **Zihni Osmani**

Redaktor artistik: **Azem Zaimi**

Redaktor teknik: **Naser Fera**

Mbikëqyrës gjatë procesit të shtypit: **Imer Gogjufi**

Përgatitja kompjuterike: **Focus Pro - Shkup**

Shtypi: **Focus – Prishtinë**

Boton:

Muftinia e BI – Shkup

rr. Çairska 52

Shkup, 1000



PARIMET E BESIMIT DHE ILMIHALI ISLAM / Mahmut Toplash

ISBN 998957180-5



9 789989 571800